

Neshat  
Tozaj

novelë

BLIOTER  
SHITETIT

14-32

795

**NE GJURME  
TE TE TRETIT**

854-32  
T95

NESHAT TOZAJ

# NË GJURMË TË TË TRETIT

NOVELË



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

# I

Fjala përhapet sikur e shtyn era dhe ashtu si nuk mund të përcaktosh se pikërisht ku filloi të fryjë era, ashtu është vështirë të gjesh edhe burimin e fjalëve që përhapen. Ashtu ndodhi edhe atë mëngjez të ftohtë janari. Nëpër fshat u përhap fjala «Qazimi u arratis». Dhe, siç ndodh me jehonën e një të shtene, që e përcjellin grykat e maleve, ashtu ndodhi edhe me këtë lajm. Shumë nuk besonin. Atyre u dukte çudi se si qe e mundur që ai, të cilin e mbanin në gojë si një komunist të mirë, të kishte tradhëtuar atdheun. Të tjerë, që e kishin pasur smirë, ose që dikur i kishte qortuar e kritikuar, hidhnin baltë mbi emrin e tij. Për disa ditë rrjesht, fshati i tij dhe fshatrat përreth zien nga këto fjalë, pastaj ai filloi të zihet në gojë rrallë e më rrallë. Njerëzit vazhdonin të punonin si më parë e të shihnin hallet e tyre, kështu që Qazimin, edhe kur e kujtonin, e zinin në gojë me neveri të madhe, ashtu siç mund të flitet për një tradhëtar. Familjes së tij as që i flisnin më. E shoqja kalonte rrugës si hije dhe nuk e kishte më atë krye-

lartësinë e dikurshme, nuk dilte më nëpër mbledhjet. Fëmijët nuk dilnin më të loznin me shokët e tyre dhe në shkollë filluan të bëjnë mungesa e të venë keq me mësimet. Me një fjalë ndodhi si atëhere në kohën e luftës, kur edhe çezmat e një fshati u ndanë më dysh: në njërin mbushnin ujë familjet e partizanëve e në tjetrën ato të ballistëve. Ky ligj i luftës së klavsave kishte zënë rrënjë të thella në popull, prandaj fshatarët nuk mund ta harronin kurrë Qazimin, atë ngjarje do ta merrnin trashëgim dhe brezat. Për disa dukej vërtet sikur kjo çështje u vyshk, por për të tjerët, për punonjësit e Sigurimit të Shtetit, ajo qëndronte gjithnjë e freskët dhe pyetja «Ç'ndodhi me këtë njeri?» ishte gjithnjë në rend të ditës. U desh një kohë e gjatë që të zgjidhej plotësisht kjo pyetje, që gjithshka të vendosej plotësisht në vend. Përgjegjja ishte e saktë, shkencore, por, për të arritur deri atje, nuk ishte një punë e lehtë, u desh shumë mund, u derdh shumë djersë.

\*  
\*   \*

Ishte mesnatë. Oficeri i rojes i degës së punëve të brendshme ishte shtrirë me gjithë rroba, pa e pri-shur krevatin. Telefonin e kishte afruar mbi një karrige tek krevati. Mbi karrige ishte gjithashtu bloku i shënimeve, paketa me cigare dhe tavlla e mbushur me bishta cigaresh. Edhe i veshur, ai dukej se bënte gjumë të qetë. Nënoficeri i rojes mendohej të mos lëvizte e të mos bënte zhurmë. Ai lexonte gazetën. Por zilja e telefonit, që nuk do të dijë për dë-

shirat e njerëzve, tringëlloi me atë zërin e saj të hollë e të zgjatur. Oficeri i rojes, pa i hapur sytë, kapi instinktivisht dorezën, më parë se shoku i tij të arrinte aty.

— Ju dëgjoj, — shqiptoi ai dhe u ngrit nga krevati. — Si, keni një sinjal?

Për dy minuta rrjesht ai dëgjuan me një rrudhë të thellë, që iu formua në ballë, dhe me buzët të bashkuara fort, sqarimet e komandantit të postës ku-fitare. Pastaj me atë zërin e tij të lehtë, por të prerë, i dha porosi që të bënte përforsime dhe të siguronte vendin. Mbylli telefonin dhe formoi një numër tjetër. Iu përgjegjën pa vonesë, thuase njerëzit, edhe kur flinin, nuk harronin detyrën e tyre.

— Shoku kryetar, posta «N» e krahut të majtë ka një sinjal. — Ai nisi t'i shpjegonte kryetarit shkurt dhe qartë situatën që i dha komandanti i postës, dhe e vuri në dijeni për urdhërat që kishte dhënë. Pastaj dëgjuan për një kohë të gjatë porositë dhe udhëzimet e kryetarit. E afroi dorezën e telefonit tek supi dhe çliroi dorën tjetër, për të mbajtur shënime. Më në fund kryetari mbaroi. Oficeri i rojes thirri korrierët dhe ata u nisën për të lajmëruar shokët e grupit që do të shkonte në vendin e ngjarjes.

\*  
\* \* \*

Në zyrën e kryetarit të degës kishte qetësi. Oficerët ishin ulur rreth tavolinës dhe prisnin. Dhoma ishte e mbushur me tym duhani. Kryetari hyri brenda dhe ata u ngritën. Ai u bëri shenjë me dorë të

uleshin, u afrua tek dritarja dhe, në vend të fjalëve të zakonshme «fillojmë shokë», tha:

— Kur do të shpëtojmë më në fund nga duhanxhinitë?

Oficerët vunë buzën në gaz me këtë shaka, sepse e dinin që edhe kryetari e pinte duhanin, por siç duket ata e kishin tepruar shumë, sepse dhoma ishte mbushur plot. Ata ishin mbledhur për të raportuar lidhur me ngjarjen që kishte ndodhur në kufi. U ngrit oficeri që drejtonte grupin. Ai kaloi dorën mbi flokët e zinj dhe nisi të fliste:

— Në brezin e butë, kufitarët konstatuan tri gjurmë këmbësh, që u përkisnin njerëzve të ndryshëm. Drejtimi i tyre ishte nga brenda jashtë. Pra, ata kanë mundur të kalojnë. Ne organizuam ndjekjen e gjurmëve për në thellësi të kufirit tonë. I ndoqëm ato rreth pesë kilometra. Por në fshatin «N» u zhdukën. Megjithëse na ndihmuan mjaft edhe gjurmëtarët popullorë, ne nuk mundëm të binim prapë në to. Këtë veprim e bëmë që të mund të zbulonim nëse i kishte shoqëruar njeri shkelësit për në kufi, apo e njihnin terrenin, dhe që të mund të zbulonim ndonjë gjë tjetër lidhur me ta. Ne i identifikuam në rrugë të tjera që të tre të arratisurit. — Ai përmendi emrat e tyre. Për dy të parët asnjëri nuk bëri zë, por, kur oficeri shqiptoi emrin e personit të tretë, ata lëvizën nga vendi. Shumë prej tyre e njihnin Qazim Belulin dhe e njihnin si komunist të mirë e njeri luftarak.

— Po ju, e verifikuat mirë këtë? — pyeti kryetari.

— Siurdhëron. Gjurmët i muarëm me allçi dhe në afërsi të shtëpisë së Qazimit u gjet një gjurmë e

tij, që ishte e njëlojtë me njerën nga gjurmët e gjetura në brezin kufitar.

Kryetari shikoi nga eksperti kriminalist në mënyrë pyetëse. Ai lëvizi kokën në shenjë pohimi.

— Çfarë veprimesh të tjera keni kryer?

— Ne bëmë kontrollin në banesat e të arratisurve. Asgjë me rëndësi nuk u gjet. Në familjet e tyre nuk dinin gjë.

— Si është e mundur! — ndërhyri kryetari.

— Natyrisht, ne nuk prisnim që njerëzit e tyre të pranënin se kishin dijeni që njerëzit e tyre ishin arratisur, por ne do të hetojmë, — u përgjegj shefi i seksionit.

Kryetari ra në mendime. Po, ai e njihte Qazimin. I kujtohej fare mirë ai njeri. Kishin qenë partizanë në të njëjtën brigadë. Megjithëse në batalione të ndryshme, ata ishin njohur në disa rrethana, që nuk mund të harroheshin lehtë. Batalioni ku bënte pjesë kryetari, ishte rrethuar nga forcat gjermano-balliste dhe, në kohën kur dara e rrethimit sa vinte e shtrëngohej, ai dëgjoi zërin e dashur të shokëve «para partizanë». Lufta, që në fillim dukej si në të shuar (partizanët e rrethuar kursenin fishekët), u ndez përsëri e ashpër. Batalioni u hodh në sulm. Gjermano-ballistët, që nuk e prisnin këtë situatë, të vënë në mes dy zjarresh, u bënë si të tërbuar, tamam si ajo bisha e plagosur. Lufta u ndez trup më trup. Pas betejës, ai kishte parë pikërisht Qazimin mbi një vig. Ishte i zbetë nga gjaku që kishte humbur, dhe rënkonte. Partizanët që mbanin vigun, u ndalën dhe ai i vuri dorën në ballin, që i ishte mbushur me bulëza djersë. I plagosuri i hapi sytë dhe tha me zë të ulët: «Ama, mirë ua punuam maskarenjve, ë?» Pastaj i

bandave të diversantëve, duke rrezikuar dhe jetën, nuk mund ta bënte këtë sa për sy e faqe. Unë kam qëndruar me të net të tëra në pritë. Ai ishte i armatosur me guximin dhe gjakftohtësinë e trimit. Veç kësaj, si komunist ai nuk ka pasur asnjë njollë.

Kryetari shikonte me vëmendje thinjat në flokët e Gëzimit, që dukej se përparonin me shpejtësi për moshën e tij, dhe për të njëqindtën herë solli ndër mend përsëri Qazimin. I ishte fiksuar ai momenti në vig dhe nuk i shqitej nga sytë.

— Po çfarë propozon ti?

Gëzimi hezitoi për një çast, pastaj buzëqeshi lehtë, si për të zbutur efektin që do të bënin fjalët e tij:

— Unë mendoj se duhen ngritur dy versione për çështjen e tij: natyrisht, versioni i parë, që ka prioritet, mbetet ai i arratisjes së tij, megjithëse motivet që e kanë shtyrë të ndërmarrë një veprim të tillë nuk i dimë. Ndërsa versioni i dytë duhet të jetë ai i vrasjes. Këtë e them, sepse një njeri që armiku e ka ferrë nëpër këmbë, përpiqet në fillim ta bëjë për vete; kur nuk ia arrin qëllimit, ai përpiqet ta neutralizojë e ta izolojë; kur e kupton se nuk mund të bëjë as njërin e as tjetrin, atëhere mundohet ta zhdukë fare. Kjo është rruga më e mirë për të.

Shoku që i kundërshtoi Gëzimit u ngrit përsëri:

— Natyrisht, Gëzimi e shtron drejt problemin dhe s'ka si të mos merret para sysh, por unë dëshiroj të bëj një vërejtje të vogël. Këtë e them, se praktika ka provuar që edhe njerëz të tjerë me merita, që kanë gëzuar respekt, bile kanë pasur edhe poste të larta, kanë tradhëtuar atdheun. Prandaj kam frikë



se mos harxhojmë forcat kot për verifikimin e këtij versioni.

— Përse kot, mua për vete ky version më duket i drejtë, — tha Pirroja, që deri tani kishte ndjekur me admirim mendimin që kishte shfaqur Gëzimi. Ai u skuq pak kur i tha këto fjalë. Ishte më i riu në grup dhe i dukej se, për të, më e udhës ishte të dëgjonte mendimet e shokëve. — Vërtet që rastet e tjera të praktikës duhet t'i studjojmë, por secili rast konkret duhet studjuar me individualitetin e tij. Ngandongëherë analogjia është e dëmshme.

— Tjetër mendim ka? — pyeti kryetari dhe, si e pa se shumica ishin dakord me propozimin e Gëzimit, mendim të cilin e përkrahte edhe ai vetë, tha: — Pra, është e qartë. Për këtë çështje do të ngrihen dy versione. Tani mendoj se duhet të përgatitet plani dhe pastaj të mblidhemi përsëri e ta diskutojmë.

\*

\* \* \*

Gëzimi kishte mbështetur bërrylet në tavolinë dhe mendohej. Përpara mbante vetëm një fletë letre të shkruar përgjysmë. E kishte lexuar disa herë dhe donte të depërtonte tej rrjeshtave të shkruar me një shkrim të imët, pak të lexueshëm. Ishte me të vërtetë interesante përmbajtja e asaj të dhëne.

Para tetë muajsh, çobanit të fshatit i ishte shkëputur një lopë nga tufa. Ai e kishte kërkuar atë tërë ditën e nuk e kishte gjetur dot. E kishte kërkuar edhe të nesërmen. Atij i kishte tërhequr vëmendjen

një tufë korbash, që vërtiteshin mbi një pyll të dendur dhe, duke e ditur që korbat vërtiten rreth ndonjë kërme, ishte nisur për atje. Bora sapo kishte shkërrë dhe ujërat gurgullonin, duke gërryer tokën e duke marrë çdo gjë përpara. Çobani kishte arritur me vështirësi deri atje dhe, gjatë gjithë rrugës, mendonte se lopa e tij ishte bërë pre e ndonjë kopeje ujqish. Por ç'të shikonte: në një gropë, buzë përroit, dukeshin mbeturinat e një skeleti njeriu, mbuluar pjesërisht me gurë e trungje. Përzier me eshtrat dukeshin mbeturinat e një bruci të zi prej shajaku, nga ata që mbajnë çobënjtë. Ai kishte ndenjur i çuditur përpara atij varri gjysmë të zbuluar dhe kishte hedhur mbi të edhe disa gurë të tjerë. Shumë mendime i kishin lindur atë kohë çobanit plak tek po kthehej rrugës. Në darkë ai qe kthyer tek Saliu, shi-tësi i dyqanit të fshatit, dhe i kishte folur për ato që kishte parë. Saliu e kishte dëgjuar fare i qetë dhe më në fund, kur e kishte parë se çobani kërkonte një mendim prej tij, i kishte thënë: «Mund të jenë eshtrat e ndonjë ushtari të huaj, ose të ndonjë diversanti të vrarë. Por ti mos bëj zë, unë do të zbres nesër në qytet dhe fundja kthehem dhe një herë nga dega e u them atyre».

Kishte kaluar gjithë ajo kohë që nga ajo ditë dhe Saliu nuk e kishte zënë asnjëherë në gojë këtë çështje përpara çobanit. Edhe një herë që e kishte pyetur ky, Saliu i kishte thënë se kishte shkuar në degën e punëve të brendshme e ata e kishin marrë në shënim denoncimin. Por nuk treguan ndonjë interesim për të. Kur çobani i kishte thënë Saliut se ai bruci i zi ishte ashtu siç mbante edhe Qazim Beluli,

Saliu e kishte parë me buzë në gaz dhe i kishte dhënë një këshillë: «Përse kërkon ta nxjerrësh nga varri Qazimin, kur edhe qeveria e ka vërtetuar se ai është arratisur?!» Megjithatë, çobanit nuk i mbushej mendja se kjo çështje ishte pa rëndësi për degën dhe, pasi e kishte pleqëruar mirë këtë punë, ia tregoi një personi tjetër, i cili e vlerësoi këtë të dhënë dhe ajo mbërriti deri në tavolinën e Gëzimit. Ky kishte disa arësye që ta lidhte këtë ngjarje me ngjarjen që i interesonte. Koha e groposjes së kësaj kufome koinçidente me atë të datës së arratisjes. Veç kësaj, nga të dhënat ishte vërtetuar se Qazimi kishte bruc të zi. Pra, edhe kjo ishte një shenjë tjetër.

Gëzimit i duhej të verifikonte përse i ishte bërë barrikadë Saliu çobanit, përse nuk e kishte denoncuar këtë të dhënë. Mos vallë kishte në këtë mes ndonjë interes? Apo ishte thjesht një qëndrim prej njeriu indiferent. Gëzimi analizoi të gjitha anët pro e kundra të këtij qëndrimi dhe arriti në përfundimin se, po të mos kishte interes, Saliu do të kishte ardhur ta bënte patjetër denoncimin.

«Po çfarë interesi të ketë pasur?» vriste mendjen të gjente ai.

Disa ditë më vonë, ai kishte mundur të grumbulloste të dhëna rreth Saliut. Nga e kaluara e tij, e vetmja gjë pozitive ishte dezertimi nga Lufta italo-greke. Pas kësaj nuk kishte pasur asnjë aktivitet. Kishte shikuar vetëm hallin e tij dhe nuk qe përzier as me njërin as me tjetrën palë. Të dy palëve, veç e veç, u shprehte — natyrisht me fjalë shumë të matura — simpatinë e tij. Por, siç dukej, as me një-

rën e as me tjetrën nuk ishte lidhur përfundimisht. Pas çlirimit ishte aktivizuar ca kohë, pastaj ishte tërhequr dhe merrej vetëm me punët e dyqanit. Para disa vjetësh, kur bënte shtëpi të re, kishte pasur një deficiet të madh dhe gati sa s'e kishin nxjerrë nga ajo punë, por ai i kishte zëvendësuar lekët të gjitha dhe kishte mbetur përsëri në dyqan. Këtu Gëzimi vuri një pikëpyetje për të sqaruar se ku i kishte gjetur ai tërë ata lekë.

Kohët e fundit kishte edhe një të dhënë tjetër. Dyqani i tij kishte marrë flakë. Vetëm kishte shpëtuar, se e kishin parë shpejt fshatarët, që bënë një mbledhje aty afër, në godinën e shkollës. Atë natë që iu dogj dyqani, Saliu nuk ishte aty, por tek një miku i tij në një fshat tjetër. Kjo ishte e provuar. A ishte kjo me të vërtetë një koinçidencë e rastit? Apo një alibi e pregatitur me mjeshtëri nga Saliu dhe e pavërtetuar nga hetimet. Pas zjarrit u bë inventarizimi dhe pati mungesa të mëdha. Gëzimi bisedoi me hetuesin e prokurorisë dhe mësoi se ata do ta arrestonin për vjedhje dhe për dyshimet që kishin për djegjen e dyqanit. Kjo e dhënë e detyroi Gëzimin të shpejtonte dhe ta shfrytëzonte arrestimin e Saliut në interes të çështjes që ndiqte. Ishte pikërisht ky qëllim që i vuri vetes Gëzimi, kur mori pjesë në kontrollin e banesës së Saliut. Ata ishin gjithsej tre veta: hetuesi, eksperti kriminalist dhe Gëzimi. Kontrollin e bënë të imët, por nuk gjetën ndonjë gjë të rëndësishme. Aty nga fundi i kontrollit, hetuesi preku dy shishe të vogla ngjyrë kafe, që ishin në një dollap të futur në mur. Ishin ilaçe për ngjyrosjen e flokëve.

— Ti, Sali, flokët bojatis, apo mustaqet? — e qe-  
sëndisi hetuesi dhe i ktheu shpinën.

— Epo, do plakemi e do bojatisemi, — u për-  
gjegj Saliu pas pak.

Gëzimit i tërhoqi vëmendjen kjo bisedë. Ai për-  
fundoi këqyrjen e një grumbulli dokumentash, që  
kishin nxjerrë nga një sirtar, dhe u afrua tek shi-  
shet. Etiketa e tyre nuk ishte e farmacisë, por e shty-  
pur në maqinë shkrimi. Ai i mori shishet dhe i shë-  
noi në proces-verbal. Në degë, eksperti e provoi so-  
lucionin në flokët e një shoku të tij, por, megjithëse  
udhëzimin e kishte zbatuar mirë, nuk pati rezultat.  
E përsëriti edhe një herë provën dhe përsëri s'pati  
efekt. Pas një muaji u kthye përgjegjja e analizës  
nga sektori i kimisë. Solucionet ishin njëri për shkrim  
sekret, tjetri për ta deshifruar tekstin e shkruar me  
solucionin e parë.



## II

Polici i shërbimit hapi derën e dhomës dhe të dy të paraburgosurit u ngritën në këmbë. Ata e kuptuan se në këtë kohë njëri prej tyre duhej të ventë në hetuesi. Polici thirri Saliun, i cili e shikoi një herë me kujdes, si të donte t'i thoshte se hetimet për të kishin përfunduar, por polici i tha se fjala ishte pikërisht për atë. Saliu shkëmbeu një shikim të shpejtë me shokun e dhomës dhe doli. Dhoma e hetuesisë nuk ishte larg dhe ai u drejtua për andej, sepse atje kishte shkuar një muaj rrjesht, por polici i tha se e kërkonin në një zyrë tjetër. E futën në një nga dhomat e katit të dytë. Ishte një dhomë e mobiluar thjesht. Në krye të tavolinës kishte zënë vend një burrë i shkurtër, me kokë të madhe e me duar topolake, rreth të dyzetepesave. Në një karrige tjetër ishte ulur një djalë i ri, i veshur mjaft mirë, me flokë të zinj e të ndarë anash. Në këtë çast djaloshi e kishte tretur shikimin në një pikë të caktuar, thuajse përtej Saliut, ndërsa burri në krye të tavolinës e shikonte Saliun drejt e në sy dhe, si e pa kështu një

copë herë të mirë, i tha të ulej në një karrige, që siç dukej ishte nxjerrë qysh më parë aty.

Në këto çaste, zemra e Saliut rrihte me shpejtësi, thuase do të pushonte fare. Kështu i ndodhte atij gjithnjë kur ndodhej përpara ndonjë të panjohure. I dukej vetja si në ndonjë vend të errët, ku nuk kishte qenë kurrë e nuk dinte të orientohej. I dukej sikur, po të lëvizte pak përpara, do të rrëzohej në ndonjë humnerë. Përse e kishin thirrur? Ai ishte mësuar ta bënte hetuesinë me njërin nga ndihmësprokurorët, një djalë i ri, që dukej se e dinte mjaft mirë zanatin e tij. Megjithëse Saliu ishte mjaft i shkathët në manovrime, ai gjithnjë ia zinte shtigjet me ndonjë provë. Më në fund Saliut iu desh të bindej se atij nuk i hidhte hi syve dhe kishte filluar të fliste drejt, në mënyrë që të mbaronin shpejt hetimet. Dhe vërtet, hetimet kishin përfunduar, Saliu ishte njohur me materialet e çështjes dhe priste të dilte në gjyq. Por përse ta thërrisnin këta? Kjo pyetje e mundonte shumë.

— Mos keni gjë për të na thënë? — e pyeti ai burri që ishte ulur në krye të tavolinës. Ai i tha këto fjalë me zë të qetë, sikur ata kishin kohë që vazhdonin bisedën dhe kishte ndodhur vetëm një pauzë e vogël.

— Jo, hetimet përfunduan. Unë pranova gjithshka që kishte të bënte me akuzën, — tha Saliu në një mënyrë të tillë, që t'i jepte të kuptonte tjetrit se kjo pyetje ishte krejt pa vend.

Vazhdoi një periudhë qetësie. Ai burri në krye të tavolinës ndezi një cigare, ndërsa djaloshi lëvizi pak në karrige. Saliu ia qepi sytë tymit të kaltër të duhanit. Ia kishte zilinë atij tymi, që ngjitej lart dhe

dilte lirisht nga dritarja gjysmë e hapur, që ndodhej pas kurrizit të djaloshit.

— Po, ashtu është, — e mori fjalën burri që ishte në krye të tavolinës, — me ju përfunduan hetimet për vjedhje të pasurisë socialiste dhe, natyrisht, ne nuk ju kemi thirrur për atë, por për diçka tjetër. — Ai pushoi pak, si për të zgjedhur fjalët që do të thoshte, ose për t'u përqëndruar më mirë në vëzhgimin e tij se si do t'i priste fjalët Saliu dhe vazhdoi: — Pra, ne nuk merremi me hetimin e krimeve që kanë të bëjnë me vjedhjet, neve na interesojnë krimet kundër shtetit.

Saliu lëvizi pak në karrige. Ai e kuptoi se ku do ta nxirrte fjalën tjetri. «Domethënë këta duan që të më shtrydhin mirë për gjëra të tjera. Po çfarë dinë në të vërtetë këta? Nuk më besohet që të dinë ndonjë gjë të sigurt. Shum -shumë mund të kenë ndonjë dyshim, ose ndoshta këtë pyetje ia drejtojnë kujtdo që e kanë të arrestuar». Sidoqoftë, atij i duhej, meqenëse kjo bisedë u hap, ta përballonte deri në fund dhe të mos u linte këtyre të kuptonin se kishte diçka, që të ndaleshin e të thelloreshin në hetime.

— Unë nuk di të kem kryer ndonjë krim kundër shtetit, veç atij që kam pranuar. — Këto fjalë ai i tha pa iu dridhur aspak zëri. Bile në zërin e tij, një vesh i stërvitur mirë, duhej të dallonte patjetër nuanca të një revoltimi të ligjshëm.

— Po ju sikur të mendoheshit pak, pastaj të përgjigjeshit, — e këshilloi ai që i drejtoi pyetjen. — Ne nuk mund të thërresim këdo nga rruga e t'i bëjmë një pyetje të tillë.

— Jo, ju keni të drejtë të pyesni, por unë them se, në rastin tim, nuk ka vend për t'u bërë një pyetje



e tillë. Të paktën unë nuk di gjë. Në qoftë se ju keni ndonjë gjë konkrete, ma thoni dhe unë jam sinqerisht gati që të jap shpjegimet e duhura.

Djaloshi lëvizi edhe një herë në karrige dhe nxori një dosje nga sirtari, të cilën ia afroi me respekt shokut të tij. Tjetri e hapi në një faqe, vuri gjyzlykët dhe, si lexoi një copë herë vazhdoi:

— E njihni ju Qazim Belulin?

— E kam njohur, por nuk më ka lidhur asgjë me atë tradhëtar. Unë vërtet që kam vjedhur, por nuk kam rënë aq poshtë, sa të më drejtoni pyetje të tilla.

— Shoku kryetar, — tha djaloshi, — më lejoni t'i drejtoj një pyetje të pandehurit.

— Po, — aprovoi kryetari.

— Ju thoni se nuk ju lidh gjë me atë tradhëtar. Përse e interpretoni kështu pyetjen që ju bëhet? Në mos gaboj, pyetja ishte kështu: e njihni ju Qazim Belulin?

Saliu e kuptoi që ishte nxituar në përgjegjen e tij. Ajo që tha ai, duhej thënë më vonë, ndërsa pyetjes duhej t'i përgjigjej me po, ose jo. Megjithatë, ai iu përgjegj djaloshtit:

— Ndoshta unë u nxitova nga urrejtja që kam për të.

— Unë di se marrëdhënjet tuaja me Qazimin kanë qenë të mira, ju e keni thirrur disa herë në shtëpi.

— Kjo është e vërtetë, — tha Saliu me zë të lartë, ndërsa me vete mendoi: «Këta paskan shkuar shumë thellë me sa duket». — Po, kur tjetri tradhëton atdheun, miqësia s'ka si të mbetet më.

— Ju jeni i sigurt se Qazim Beluli është tradhëtar? — e pyeti kryetari.

Saliu dalloi në zërin e tij vrazhdësi dhe ndosh-ta për herë të parë gjatë gjithë kohës që dinte diçka për Qazimin, e kuptoi se kjo pyetje nuk bëhej kot.

— Një njeri që arratiset, s'mund të jetë veçse tradhëtar, — u përgjegj ai me bindje të plotë.

— Ne kemi bindje se ju, lidhur me këtë çështje, nuk tregoheni i sinqertë. Për t'ju ndihmuar, unë po ju bëj një pyetje. Disa muaj pasi u hap fjala për arratisjen e Qazimit, juve ju polli një lopë. Personi që ju solli viçin në shtëpi, diçka bisedoi me ju. Çfarë biseduat?

Saliu u ngrit me rrëmbim nga karrigja, sikur ta kishte përshkuar rryma elektrike. Ai u bind që pyetja s'ishte në tym dhe, ashtu si ai udhëtari kur i hidhet papritur një qen në grykë, ndjeu nevojën të diskutonte për këtë çështje, por vetëm për këtë, se, po të thellohej më tej, e merrte lumi.

— Ju keni të drejtë që më pyesni. Unë kam mbajtur të fshehur një gjë, që ju duket se e dini, por të jeni të bindur se këtë nuk e kam bërë me qëllim të keq, bile më është dukur budallallëk të njoftoja për këtë. — Ai ndali pak dhe u ul në karrige. Kërkoi një cigare, e ndezi dhe vazhdoi: — Është pikërisht ashtu siç thoni ju. Viçin ma ka prurë në shtëpi çobani i fshatit. Ai më tha dhe një gjë, që më çudit. Më tha se në një vend, afër livadhit ku kulloste lopët, kishte parë një tufë korbash dhe, pasi ishte afruar ca, kishte gjetur një skelet njeriu. Afër skeletit dukeshin mbeturinat e një bruci, që i ishte dukur si ai i Qazimit. T'ju them të drejtën, unë nuk e besova megjithatë i thashë çobanit të mos bisedonte me njeri tjetër, sepse do të lajmëroja atje ku duhej. Dhe vërtet, do të vija të tregoja, por pas ndo-

një jave kalova andej dhe nuk gjeta gjë. Mendova se çobani, duke qenë pak si torollak, kishte trilluar ndonjë gjë, ose i kishin bërë sytë, ndaj nuk erdha t'ju shqetësoj.

Ai i tha këto me një frymë, sikur deshi të shkar-kohej nga një barrë tmerrësisht e rëndë, dhe në një mënyrë të tillë, sikur të desh t'u thoshte atyre që e pyesnin: «Ja, kjo qe e gjitha, e kuptoni sa e thjeshtë është? Ndërsa ju desh më morët në qafë me pyetjen tuaj. Ja si mund të bjerë viktimë i shkreti njeri».

Kryetari e ndoqi me kujdes dhe pothuajse e admiroi mënyrën që përdori ai për të dalë nga rreziku. Ai mbante shënime në një copë letër. Ai gjeti pika të dyshimta në tregimin e të pandehurit. Pse kishte kaluar pas një jave ai andej? Pse qenkej torollak ai çobani, kur në të vërtetë ishte një plak i urtë. Kryetari e dinte tashmë nga të dhënat se çobani ia kishte thënë këtë jo vetëm Saliut, por edhe një personi tjetër. Por kryetarit i mjaftonin tani për tani ato që tha Saliu. Duheshin verifikuar akoma disa gjëra, pastaj ta thërrisnin edhe një herë. Për sot mjaftonte.

— Mirë, shkoni dhe mendohuni. Do të bisedojmë përsëri rreth këtyre gjërave, e jo vetëm rreth këtyre. Unë shpresoj se ju e kuptoni gjendjen në të cilën ndodheni, dhe, të them të drejtën, jeni në një gjendje, që nuk është për ta pasur zili. Po mos pandehni se nuk ka rrugëdalje; mjafton që ta kërkoni dhe keni për ta gjetur.

Saliu i zbriti shkallët shumë i mërzitur. Tani i dukej vetja si ai zogu që i kanë prerë krahët e mund të bëjnë gjithshka me të. Ai hyri në dhomë dhe Bajrami, shoku i tij i dhomës, u ngrit në këmbë. Ishin pothuajse moshatarë dhe kishin gati një muaj që që-

ndronin bashkë. Qenë njohur, miqësuar e i qanin hallin njëri-tjetrit. Kur u mbyll dera, Saliu u përplas përdhe. Fjalët e fundit të kryetarit e kishin çarmatosur. Bajrami i vuri dorën në shpatulla dhe i zgjati gotën me ujë. Ai ia shtyu dorën dhe e shikoi drejt në sy si me dyshim dhe me frikë. Ai tani ruhej nga çdo njeri, por, si ndeshi në fytyrën e qetë dhe në shikimin dashamirës të tjetrit, u pendua në çast dhe i erdhi turp nga vetja.

— Tani më duket se u bëmë shokë, o Bajram.

— Përse tani, — tha i çuditur Bajrami, — ne shokë kemi qenë!

— S'ta kam aty fjalën.

— Po ku e ke, përse je kaq i shqetësuar?

— Nuk u takova më me hetuesin tim, më thirri kryetari i degës dhe më kërkoi ca gjëra, për të cilat unë jam betuar t'i marr me vete në varr.

Bajrami e shikoi Saliun me kujdes dhe iu duk si një fatkeq i mjerë.

— Edhe unë ashtu mendoja. Por, përveç tentativës së arratisjes, m'u desh të tregoja edhe dy shokë të tjerë, të cilët më duket se i kanë rrasur brenda. Këtyre ua lumsha, se dinë të punojnë mirë. I ngjajnë asaj turjelës, që e fillon shpimin në një pikë fare të vogël, dhe, si i hap rrugën vetes, e gërryen drurin tejprtej. Unë nuk munda të rezistoj, ndërsa ty të uroj t'ia dalësh mbanë.

Fjalët e fundit Saliut iu dukën se u thanë me ironi, por nuk ia vuri re. Fundja, edhe ai ishte i mërzitur. Ata biseduan bashkë deri natën vonë, me zë të ulët, gati me të pëshpëritur. Pastaj ranë për të fjetur. Por Saliun nuk e zinte gjumi. Atij i duhej të mendohej mirë për takimin tjetër. Mendoj edhe një

herë për gjithshka kishte thënë, në mënyrë që t'i përsëriste të nesërmen. Është mirë kur nuk i ngatëron gjërat, se ashtu të besojnë më shumë. Në rastin e tij, Saliut i duhej t'i përsëriste dhe t'u qëndronte besnik atyre që kishte thënë sot, sepse mund t'i harronte, ashtu siç harrohet çdo gënjeshtër, të cilën, sa më tepër ta përsëritësh, aq më e vërtetë të duket, edhe kur e ke fabrikuar vetë.

\*  
\* \* \*

Çobani ishte ulur në karrigen para Pirros. Ishte një burrë rreth të shtatëdhjetave, pak i kërrusur dhe me fytyrë tërë rrudha. Po dridhte cigaren nga një kuti alumini me ato duart e zeshkëta, tërë damarë. Në karrige dukej që nuk e ndjente veten mirë. Emocionet, të përziëra me një ndjenjë frike, e bënë të pasigurt shikimin e tij. Po aq i emocionuar ndjehej edhe Pirroja. Ishte çështja e tij e parë, që hetonte në mënyrë të pavarur. Kryetari, duke u mbështetur në cilësitë e Pirros, në këmbënguljen dhe në inteligjencën e tij, kishte insistuar që ai të futej në grupin operativ për ndjekjen e këtij problemi. Dikur Pirroja kishte qenë një djalë me të vërtetë çapkën. Nuk ishte nisur në shkollë për t'u bërë jurist, por inxhinier elektrik. Por çapkënlleqet dhe mungesa e seriozitetit në studim i kishin pregatitur atij një surprizë të hidhur: ngeljen në dy provime. Kjo i kishte ardhur kaq papritur, sa që vonë e kishte kuptuar gjendjen në të cilën ndodhej. Në shtëpi kishte vendosur të mos u tregonte, por, megjithë përpjekjet në pushimet e verës, ai nuk mundi të familjarizohej

me matematikën, në të cilën kishte shumë boshllëqe. Ja kishin prerë bursën. Pikërisht atëhere Pirroja kishte dashur ta lante atë turp. Ai qe futur në punë dhe ndoqi studimet në degën juridike. Punonte në turnin e dytë, studjonte natën dhe paraditeve vente në leksione. Në fund të vitit të parë nuk kishte notë tjetër përveç dhjetës. Në vitin e dytë i doli bursa. Si mbaroi shkollën shkëlqyeshëm, e caktuan hetues në Organet e Sigurimit të Shtetit dhe, pas një viti stazh në qendër, ai filloi punën në këtë degë rrethi.

Pirroja i hodhi një sy xhaxhos që kishte përpara, dhe filloi pyetjen.

— Bashkë do të bisedojmë për një çështje të vjetër, mundohuni të kujtoheni dhe të jeni sa më i saktë.

Plaku pushoi së menduari me vete dhe nisi të dëgjonte çfarë i thoshte djaloshi që kishte përpara.

— Unë do mundohem të përgjigjem drejt, megjithëse jam plak njeri e s'para mbaj mend.

— E keni njohur Qazim Belulin?

— Po, e kam njohur, — tha plaku duke i zvarritur pak fjalët.

— Mos keni dëgjuar ku ndodhet ai tani?

— Jo, nuk kam dëgjuar asgjë për të, që kur u hap fjala se u arratis.

— Pse thoni «që kur u hap fjala»? — u kap menjëherë pas kësaj Pirroja. — Mos keni dyshuar ndonjëherë për fjalët që u hapën për të.

Plaku filloi të mendohej. E vërteta ishte se ai kishte dyshuar për këto fjalë, që kur kishte parë atë kufomën afër livadhit, por kjo nuk kishte dalë gjë. Saliu i kishte thënë se qeveria e kishte vërtetuar mirë që Qazimi qe arratisur, prandaj të mos i hynte

kësaj pune. T'i thoshte, apo të mos i thoshte për këtë hetuesit? Po ja, ta zëmë se do t'i thoshte, çfarë do të ndodhte me të? Mos vallë do ta dënonin, ashtu siç i kishte lenë të kuptonte Saliu? Po përse të mos e thoshte, kur ai e kishte parë me sytë e tij një gjë të tillë? Ai nuk mund të gënjente e të turpërohej tani në pleqëri.

Edhe Pirroja ishte në tension. Ai e kuptoi se me pyetjen e tij kishte ndezur në tërë qenjen e plakut një luftë të madhe dhe priste rezultatin e saj, jo me gjakftohtësinë që i duhej aq shumë në punën e tij.

Më në fund plaku e theu heshtjen:

— Po, unë e kam vënë një herë në dyshim këtë.

— Kur ka ndodhur kjo? — e pyeti Pirroja, i çli-ruar nga mendimet që e mundonin.

— Para shumë kohësh. Një ditë, kur isha me bagëti, pashë një tufë korbash që vërtiteshin në një vend, dhe shkova të shikoj. Aty gjeta eshtra njeriu dhe një bruc të zi. M'u duk si ai që mbante Qazimi.

— Ke biseduar me njeri për këtë? — ndërhyri Pirroja.

— Po, mbaj mend që ia thashë Saliut, shitësti të fshatit Gurrë.

— Po ai, çfarë të tha?

— Në fillim më tha të mos u hyja këtyre punëve, se qeveria e kishte vërtetuar mirë që Qazimi ishte arratisur. Më vonë më tha se do bisedonte atje ku duhej për ato që i thashë.

— Po përse nuk erdhe vetë të na thoshe?

— Jam plak njeri e nuk zbrisja dot në qytet, kështu që i thashë atij, se ai zbriste gjithnjë në qytet për furnizim. Pastaj, të them të drejtën, nuk e dija se ishte aq me axhele kjo punë. Po ai, Saliu, ma

bëri punë të mbaruar, pa dhe vetë do kisha ardhur.

— Po më vonë, a e pyete Saliun nëse kishte lajmëruar në degë?

— E pyeta dhe ai më tha se kishte ardhur tek ju, por nuk kishit treguar ndonjë interes për këtë çështje.

— Keni biseduar me njeri tjetër për këtë çështje, — e pyeti Pirroja, megjithëse këtë e dinte, por më tepër për të përcaktuar më mirë sinjeritetin e dëshmitarit.

— E kam biseduar me Ramiun, — u përgjegj plaku pa hezituat.

Pirroja ra në mendime. Kryetari e kishte porositur që ta individualizonte mirë vendin ku ishte gjetur skeleti, por e kishte ndaluar t'i kërkonte çobanit ta shoqëronte për atje. Në fillim Pirroja ishte çuditur, por kryetari arësjetonte kështu: në qoftë se jemi përpara një vrasjeje për motive politike, sapo të interesohemi ne për të marrë eshtrat, ata do të marrin masa dhe puna jonë për zbulimin e tyre do të bëhet njëqind herë më e vështirë.

Pirroja filloi të mendonte për plakun. Përse të mos vinte menjëherë në degë ky njeri, ose të bisedonte me njerëzit tanë atje, por vete e zgjedh pikërisht Saliun dhe e lejon ta tërheqë për hunde? Por nuk i tha asgjë plakut nga ato që mendonte. Fundja, tregimi i tij ishte bindës, të paktën tani për tani, sepse në të ardhmen ata do t'i verifikonin çështjet.





Saliu qëndronte përpara kryetarit, ulur në karrige, me duart plotësisht të lidhura e të shtrira përmbi gjunjë, si për të ndaluar dridhjet e tyre. Qafën e trashë tërë damarë e kishte zgjatur përpara dhe priste, i përqëndruar mirë, raundin e dytë.

Kryetari rrinte ulur në karrige dhe dukej sikur nuk e kishte mendjen aty, sikur asgjë nuk e interesonte. Këtë përshtypje kishte Saliu, që nuk e njihte mirë, ndërsa Pirroja e ndjente që ai, me tërë qenjen e tij, mendonte për Saliun. Faza e parë e hetuesisë kishte kaluar mirë. Saliut i ishte prishur qetësia. Gjithë këto ditë ai kishte qenë në ankth. Priste ta thërrisnin, dëshironte të takohej sa më shpejt me të panjohurën. Pritja për të ishte torturuese, por kjo ndodhte kur ishte në dhomë, ndërsa tani që ishte aty, i trembej ballafaqimit, ashtu siç kishte frikë nga çdo e panjohur, që rëndonte mbi të.

— U menduat për ato që biseduam së bashku kohë më parë? — e theu heshtjen kryetari.

— Siurdhëron, **u mendova**, — **u përgjegj** Saliu, duke i dhënë fytyrës një shprehje sinqeriteti fallso. — Po unë nuk gjeta ndonjë gjë të re, veç atyre që ju thashë atë ditë.

Kryetari hapi dosjen, nxori proces-verbalin e pyetjes së çobanit dhe lexoi ato çka kishte nënvizuar.

— Siç e shihni, pretendimet tuaja vijnë në kundërshtim me ato që thotë dëshmitari. Ju nuk mund ta mohoni këtë.

— Ai plak është e ndoshta nuk mban mend, kështu i është fiksuar. Po unë ju them sinqerisht se

nuk kam pasur asnjë qëllim të keq, desha t'u largohesha telasheve.

— Një telashi aq të vogël, që është detyrë e çdo qytetari, deshët t'i largoheshit, ndërsa për të vjedhur pasurinë socialiste s'keni pasur frikë nga telashtet, — e ngriti pak zërin kryetari. — Nuk ju duket pak e çuditshme kjo logjikë?

I pandehuri uli kokën.

Kryetari nxori dy shisheet me solucion mbi tavolinë dhe nisi të shikonte me ngulm se ç'përshtypje do t'i bënin të pandehurit.

Saliu e kishte harruar që atë ditë atë ngjarje aspak të këndshme. Ai edhe në dhomën e paraburgimit as që kishte menduar fare për to. E kujt do t'i shkonte në mendje se ato mund të përdroreshin për ndërlidhje? Ndërsa tani që i pa mbi tavolinë, i erdhi t'i binte kokës fort me grushte për ato mendime prej budallai.

— Ç'donin këto dy shishe në shtëpinë tuaj, përse i përdornit dhe kush jua ka dhënë? — pyeti kryetari.

— Nuk di asgjë, nuk ndjehem mirë; ju lutem, më dërgoni në dhomë. — Këto fjalë Saliu i tha me një zë të këputur dhe me forca të prera. Duke u ngritur nga karrigja, ai hoqi dregzën e një plage që kishte në gisht, dhe iu drejtua kryetarit me fytyrën të shtrembëruar nga dhëmbja:

— Ju lutem, më siguroni një copë pambuk me jod. Kam katër ditë që e kam vrrarë dorën.

— Nuk ju kanë mjekuar? — pyeti kryetari, duke shikuar herë Pirron, herë Saliun.

— Jo, më kanë mjekuar, po, sa ma lyejnë dorën dhe s'më lënë ta lidh me fashë e me pambuk.

— Kjo s'është plagë aq e rëndë, — ndërhyri Pirroja. — Mjeku ia pastroi dhe nuk këshilloi gjë tjetër.

— Mirë atëhere, shkoni merrni pambuk e jod dhe hajdeni ta mjekoni këtu, — tha kryetari duke shikuar nga Pirroja.

Ata dolën. Kryetari buzëqeshi dhe u shtriq. Qëkur morën përgjegjen nga sektori i kimisë, ata kontrollonin me kujdes çdo pako që i vinte Saliut nga shtëpia. Tri ditë më parë, e shoqja i kishte prurë Saliut, midis sendeve të tjera, edhe disa byrekë të blerë në pazar e të mbështjellë me një letër të bardhë.

Pirroja që merrej vetë me kontrollin e sendeve që i vinin Saliut, e pyeti të shoqen:

— Po këto, nga kush i ka?

— Byrekët ia bleva këtu, në pazar, — u përgjegj ajo me sy ulur.

Pirroja e bashkoi pakon me sendet e tjera dhe urdhëroi t'i jepeshin Saliut. Në darkën e ditës që mori pakon, Saliu vrau dorën dhe kërkoi t'ia mjekonin. E pa mjeku i degës dhe ia mjekoi plagën. Pirroja asistoi në mjekim. Në fund Saliu i tha doktorit ta mbante pambukun me jod që ta pinte mirë dora, por mjeku i tha se nuk ishte nevoja. Ditën tjetër prap Saliu e kishte gishtin të gjakosur, dukej sikur plaga nuk donte të zinte kore. Ja, dhe sot, gjatë pyetjes, ai kërkoi përsëri pambuk.

Kryetari i solli të gjitha këto në mend dhe i vinte për të qeshur. Hyri Pirroja me të pandehurin. Në dorë Pirroja kishte një shishe jod, pambuk, një pecetë dhe disa letra ambalazhi. Ata u ulën.

— Fillo nga mjekimi, — i tha Pirros kryetari.

Saliu afroi karrigen dhe shtriu përpara dorën, po Pirroja dukej sikur nuk e kishte mendjen tek dora e Saliut. Ai e futi pambukun në shishe dhe filloi ta kalonte në fillim mbi letrën, me të cilën ishin mbështjellë byrekët. Saliu e shikonte këtë skenë me dorë të shtrirë pak përpara, me sy të çakëritur dhe me fytyrën të zgërdheshur. Pështyma në gojë ishte tharë.

Pas pak nga letra filluan të dalin germa në një ngjyrë të verdhë. Por Saliu nuk mundi të lexonte përmbajtjen. Atij iu errën sytë dhe iu duk sikur një afsh i ngrohtë filloi t'i ngjitej nga stomaku lart, që i zuri grykën, i pushtoi gjithë kokën dhe ai u përplas përdhe.

Si erdhi në vete e zuri përsëri vendin e tij në karrige, kryetari i tha:

— Mesazhin e keni nga «Skifteri», por tani shkonin e qetësohuni. Nesër kemi kohë dhe bisedojmë.

— Jo, — kundërshtoi Saliu, — ç'kemi për të bërë, ta bëjmë tani. Unë e ndjej veten mirë, — tha ai dhe e mbështeti shpinën e lodhur mbi karrige.

— Në qoftë se e ndjeni veten me të vërtetë mirë, atëhere unë nuk kam asnjë kundërshtim. Por, në qoftë se do të vazhdoni të hidheni tel më tel, do të ishte mirë të shkonit e të mendoheshit një herë seriozisht e pastaj të bisedonim.

— Jo, unë ato që kam do t'jua them, — tha Saliu shpejt e shpejt, duke treguar gatishmërinë për të vazhduar bisedën. Ai e ndjente se, në qoftë se do të qëndronte qoftë edhe një orë pa biseduar për këtë çështje, do të çmendej.

— Ç'keni për të thënë? Po ju dëgjojmë, — tha

kryetari dhe u mbështet pak si i mërzhitur në karrige.

— Ju interesoheni për Qazim Belulin. Ai nuk është arratisur, por e vranë diversantët në bashkëpunim me ata që u arratisën. — Ai i tha me shpejtësi këto fjalë dhe heshti. Dukej sikur e futi gjuhën pas dhëmbëve për të mos e nxjerrë më kurrë.

— Ne po e shënojmë, meqenëse ky na duket fillimi i kthesës suaj. Veçse ne nuk kërkojmë këtë nga ti. Ne duam të dimë se në ç'shikallë je implikuar ti në marrëdhënjet me diversantët, kush të ka lidhur me ta dhe me kë i mban lidhjet.

— Unë nuk e di emrin e atij që na udhëheq, di vetëm që e quajnë «Skifter». Sa për takimet me diversantë, ato kanë ndodhur kohë më parë. Me ta nuk kam pasur lidhje të tjera.

— Mos vallë i keni vendosur lidhjet me diversantët qysh nga koha që ndërtoje shtëpinë e re? — e pyeti Pirroja dhe përpara syve i doli pikëpyetja, që kishte shënuar Gëzimi në informatën për Saliun.

Saliu uli kokën. Ai tashmë u mësua me këto të papritura. Tani problemin nuk e shtronte më për të ruajtur punët e tij të fshehta, sepse ato ai i krahasonte me një gur, që kishte filluar të rrukullisej në greminë, por ai mendonte më tepër për veten e tij. Natyrisht, ai do të mendohej që t'u jepte informata sa më pak dhe sa më rrallë, në mënyrë që ta ngrinte sa më shumë vlerën e tij në sytë e tyre.

— Me kë i mbanit lidhjet dhe cila ishte detyra juaj? — e pyeti kryetari.

— Ne kishim një vend sekret. Unë nuk kam takuar kurrë asnjëri. I merrja letrat nga ai vend, merrja detyrën time, e kryeja atë dhe i lija letrat e mia

në një vend tjetër, ku, siç dukej, i merrte tjetri. Tjetër s'di ç't'ju therr.

— E kuptoj shumë mirë gjendjen tuaj. Ju kërkoni të mënjaroni të tjerët. Dhe me të vërtetë, kjo është një gjë e mirë, por unë trembem se ata nuk do të tregoheshin kaq heronj për të mbajtur të fshehtë emrin tuaj. Mos pandehni se ne këto i fabrikua vetë, jo, këto kanë dalë nga radhët tuaja. Për sot mjaft, — përfundoi kryetari.

Saliu u gëzoi. Fjalët e fundit ndezën në mendjen e tij të lodhur nga kjo luftë një shkëndijë të re. «Mos vallë ata kanë arrestuar ndonjë tjetër? Ja, ata, për shembull, në sytë e mi deshifruan letrën që më dërgonte «Skifteri» dhe më duket se nuk u interesuan për të. Mos vallë e kanë arrestuar? Apo kanë arrestuar ndonjë tjetër». Ai filloi t'i kalonte nëpër mend shokët që njihete. Ata të gjithë mund ta shinin Saliun për një premtim të vogël, për një koskë. Donte të vazhdonte të thellohej në këtë arësyetim, por mendja i dukej si ai sahati që ngec dhe, sado të përpiqesh ta kurdisësh e ta tundësh, nuk punon më. Ai hyri në dhomë dhe u shtri i këputur. Tëmthat i punonin si çekiçë të mëdhenj dhe ai e dëgjonte oshëtimën e goditjes së tyre si të mbytur. Ashtu e zuri gjumi.



Saliu i kishte takimet të shpeshta me Pirron. Kur nuk kishte mundësi të asistonte kryetari, e merrte në pyetje së bashku me Gëzimin. Bisedimet kishin

ngecur në një pikë të vdekur. Saliu pretendonte se vendi ku vendoste informatat ishte i sigurt, ndërsa Pirroja, megjithëse kishte qenë dy herë atje, nuk kishte gjetur asgjë. Sot përsëri pikërisht aty ngeci diskutimi.

— Përse ngulni këmbë kaq fort në këtë pikë, a s'e kuptoni që kjo ju rëndon? — i tha Pirroja, që po e mbante me vështirësi veten.

— Por, ama, e kuptoj që edhe nuk më lehtëson, — u përgjegj Saliu, duke lëpirë buzët e thara, dhe sytë i morën një shkëlqim të veçantë.

— Ku e dini që nuk ju lehtëson? — ndërhyri Gëzimi.

— E di, se ju nuk po më jepni asnjë garanci, — vazhdoi ta thellonte diskutimin Saliu.

— Mos doni t'ju lëshojmë ndonjë deklaratë, — i tha Pirroja duke qeshur. — Ne nuk bëjmë pazarllëqe. Detyra jonë është të zbulojmë gjithshka keni bërë ju. Ne nuk kemi ç't'ju premtojmë, se nuk jemi sharlatanë. Vendimin për krimin tuaj e jep populli, jo ne. Më kuptoni?

Saliu u përtyp ca. Vërtet, drejt foli ky djalë, bile i foli fare hapur. «Dhe unë me kë dua të hyj në allishverishe!» — mallëkoi ai veten.

— Mirë, po e tregoj vendin. Le të gjykojnë si të duan për mua, — tha ai dhe zgjati dorën. mori një fletë letre, lapsin dhe bëri një skicë, që Pirroja me Gëzimin e admiruan nga pikëpamja e saktësisë.

— Po vendin rezervë? — pyeti Pirroja, pasi e futi skicën në dosje.

— Nuk ka pasur vend rezervë.

— As për korrierin rezervë nuk ka pasur vend rezervë?

— Nuk e di.

— Vërtet s'e dini?!

— Më besoni, po ta dija se kush është korrieri rezervë dhe çfarë vendi rezervë ka, do t'jua thosha, se, në fund të fundit, e kuptoj që unë nuk kam asnjë fitim në këtë mes, — tha Saliu dhe në këtë kohë iu kujtua fjala e Bajramit për atë punën e turjelës. «Tani ajo turjela ia ka hapur plotësisht vendin vetes dhe po më gërryen mirë», — mendoi ai.

Pirroja i tha policit që priste jashtë, ta shoqëronte të pandehurin dhe u nis për te kryetari.



### III

Familjeve të të arratisurve në fshat thuajse nuk u afrohej asnjëri, sikur ata të ishin mbështjellë me një shtresë të ftohtë, të hollë e të padepërtueshme. Ata mendonin se asnjëri nuk interesohet për ta, por kjo ishte përshtypja e jashtme. Në të vërtetë, ata rrethoheshin nga sy vigjilentë që, po t'i shikonin në një vend të papërshtatshëm, lajmëronin atje ku duhej. Xhevoja nuk po mësohej dot me këtë jetë. Asaj i dukej sikur vështrimet e njerëzve e tejshikonin, se, në sytë e njerëzve, urretja për gjestin e të shokit nuk do të shuhej kurrë e se atë vetë, gjatë gjithë jetës, do ta ndiqte i njëjti shikim. Dikur ajo kishte qenë e nderuar. Në shtëpinë e saj kishte pritur me dhjetëra të deleguar të partisë, atje ishin bërë mjaft diskutime edhe për ngritjen e kooperativës bujqësore, në të cilën Qazimi kishte hyrë i pari e kishte punuar edhe me të tjerët. Asokohe ai rrinte gjer nën vonë, rrinte dhe lexonte disa libra, që dukej se i kuptonte me vështirësi; kjo dukej ngaqë ai e bente ballin tërë pika me një laps kopjativ, me të cilin

nënvizonte. Ai nxirrte shënime me një shkrim të vogël e të imët në ca fletore, që i pëlqente t'i mban-te pastër, si ata nxënësit e vegjël të shkollës. Ajo rrinte e thellohej shpeshherë në mendime, përpiqej të gjente qoftë edhe një të çarë të vogël në jetën e Qazimit, një shkëndijë të vogël në mendimet dhe veprimet e tij, që e kishin çuar në atë gjëmë të madhe. Por, sado që e lodhte kokën, nuk gjente asgjë të tillë. E në ato çaste asaj i vinte inat me vetëveten, i dukej se ishte krejt e paaftë për të menduar e gjykuar, i dukej vetja si një fëmijë që kishin mundur ta mashtronin, e këtë ja kishte bërë njeriu i saj më i dashur. Shpesh këto mendime e mundonin në arë, nënë rrezet e diellit kur ishte duke punuar, në shtëpi kur merrej me fëmijët. Shpesh ato i nxirrnin nga gjendja e hutimit dhe fjalët e tyre dukej sikur i kthenin përsëri gëzimin dhe besimin për jetën.

Me të tjerët ajo thujse nuk afrohej fare, nuk e bashkonte asgjë me ta. Kështu që e ndjente veten mjaft të vetmuar. I dukej se gjendja në të cilën ndodhej, vetmia dhe mendimet që e mundonin, ishin armiq, që do t'i kishte bashkudhëtarë për gjithë jetën.

Por dalëngadalë ajo filloi të mësohej me gjendjen, donte sikur ta thyente pak monotoninë. Njëra nga gratë e të arratisurve, Bukuria, që ishte nja tridhjetë vjeçe e që rridhte nga një familje e mirë, shkëmbente ndonjë fjalë me Xhevon. Edhe ajo e ndjente veten disi të vetmuar e të huaj në atë ambient, megjithëse kishte një natyrë më të gëzuar. Qëkur ishin afruar me njëra-tjetrën, Xhevoja kishte konstatuar se Bukuria diçka kishte që tregohej aq e përzemërt me të. Por Xhevoja nuk tregonte interesim të veçantë, priste që t'i hapej ajo vetë. Dhe rasti erdhi: një

ditë ato mbetën më pas nga shoqet e tjera, pasi kishin lenë punën.

— Xhevo, të shoh gjithnjë të mërzitur, — e nisi bisedën Bukuria. Zëri i doli i ngjirur nga emocioni.

— Me këtë hall që më ka zënë, s'ka si të jem e gëzuar, — u përgjegj Xhevoja ftohtë dhe si e mërzitur.

— Po mirë ne që e kemi hak të izolohemi, po me ty ç'kanë, pse të mbajnë kot kështu? — tha ajo duke parë me kujdes përçark.

— Pse thua kot, nuk më mbajnë kot kështu, po sepse im shoq është arratisur, si dhe burrat tuaj. Po nuk më thua, përse e nise këtë bisedë? — tha ajo duke e kapur pak për mënge. Në atë çast sytë e Xhevos kishin marrë një shkëlqim të çuditshëm, ata dukeshin sikur luteshin me përunjësi për diçka.

Bukuria e kapi këtë shikim dhe, si pa edhe një herë përçark me kujdes e si me frikë, i tha:

— Mua më ka thënë një njeri i sigurt, para se të arratisesh, se diversantët donin ta bënë për vete Qazimin. Po nuk ia arritën qëllimit, ata kanë për ta zhdukur, më tha mua ai personi.

Bukuria heshti dhe priti se ç'përshtypje do t'i bënin këto fjalë Xhevos. I dukej se lajmi që i dha, ishte vërtet i rëndësishëm, shpresëdhënës. Edhe për vete Bukuria u çlirua nga një barrë e rëndë, që e kishte munduar për një kohë të gjatë. Ato minuta që ndenjën në heshtje, përballë njëra-tjetrës, Bukuries iu dukën shumë të gjata. Në fillim Xhevoja u zverdh, bebëzat e syve iu hapën jashtë masës dhe trupi filloi t'i dridhej. Ajo ndjeu nevojë të ulej dhe u ul në anë të rrugës, në pluhur. Pastaj vari kokën

dhe Bukuria pa shpatullat e saj të uleshin e të ngriheshin në mënyrë ritmike. Xhevoja qante pa zë. Mendja e saj, përgjithësisht e topitur, tani nisi papritur të punonte, e nxitur nga fjalët që i tha Bukuria. Domethënë Qazimi nuk kishte qenë tradhëtar. Atë donin ta bënë me vete diversantët. Tani ajo ishte plotësisht e bindur se ata nuk ia kishin arritur qëllimit. Jo, Qazimi nuk jepej aq kollaj. Ajo qante sepse, thellë në shpirtin e saj, ishte plotësisht e bindur që ai nuk ishte dhënë dhe për këtë ishte krenare. Po në të njëjtën kohë ajo qante, sepse ishte po aq e bindur se ata e kishin vrarë. Ajo ngriti sytë dhe e shikoi nëpërmjet lotve Bukurien për një copë herë të madhe. Në fytyrë nuk i lozte asnjë muskul.

— A është e vërtetë kjo që më thua, a është fjalë e sigurt?

— Po, kjo është e sigurt. Unë nuk kam pse të nxjerr nga mendja, — i tha Bukuria me një zë të ëmbël për ta qetësuar dhe për t'i dhënë zërit sigurinë e duhur, në mënyrë që tjetra të mos dyshonte më për fjalët e saj.

Xhevoja u ngrit dhe ato e bënë pjesën tjetër të rrugës pa folur. Si u ndanë, Xhevoja nxitoi për në shtëpi, nxori laps e letër dhe i shkroi ato që tha Bukuria. Letrën e mbylli në një zarf, në të cilin shkroi adresën e degës së punëve të brendshme dhe e postoi që atë ditë.

Për çudinë e saj, tri ditë pasi kishte nisur letrën, Xhevon e kërkonin për takim dy veta. Ajo la punën në arë dhe u nis për në qendër të fshatit. Hyri në zyrën e këshillit dhe u zgjati dorën si me ndruajtje të dy burrave.

— Si jeni? — e hapi bisedën ai që dukej më i madh në moshë.

— E si të jem, — ngriti supet ajo dhe hapi pak duart e saj të ashpra. — Siç më shihni. Po ju kush jeni?

— Ne jemi dy shokë të degës së punëve të brendshme, kemi ardhur për të biseduar me ju.

— E muarët letrën time? — u interesua ajo pak e çuditur që ata kishin ardhur aq shpejt. Po për çudinë e saj ata shikuan njëri-tjetrin në sy si të habitur.

— Për çfarë letre e keni fjalën?

— Para tri ditësh ju kam shkruar një letër, ku ju thosha disa gjëra, që mbase do t'ju ndihmojnë për punën tuaj. — Pastaj ajo filloi t'u shpjegonte bisedën e saj me Bukurien.

Gëzimi me Pirron e dëgjonin me vëmendje. Si mbaroi ajo, Gëzimi i tha diçka me zë të ulët Pirros dhe ai u largua.

— Pa uluni të bisedojmë pak më shtruar, — i tha Gëzimi dhe u ul edhe vetë në karrige.

— Pa kujtohuni, mos pati ndonjë shkak Qazimi që e la taserën e partisë në shtëpi, dhe a e bënte shpesh këtë veprim? Po vetëm mendohuni mirë.

— Ai, sa herë që e lajmëronin për ndonjë punë, e linte taserën e partisë në shtëpi, merrte pushkën,

fishekët dhe bukën me vete. Kështu bëri dhe atë ditë.

— Ju kujtohet se kush e lajmëroi atë ditë për shërbim?

Xhevoja u mendua gjatë.

— Jo, nuk më kujtohet.

— Po herë të tjera, kur e thërrisnin, zakonisht kush e thërriste, qoftë edhe për mbledhje.

— E thërriste korrieri i lokalitetit. Ai vinte shpesh tek ne, sepse rruga për në shtëpinë e tij kalon afër shtëpisë sonë.

— Si e quajnë korrierin, — e pyeti Gëzimi dhe nxori blokun e shënimeve.

— Selman, — u përgjegj Xhevoja.

Gëzimi nënvizoi një emër në blok me dy vija të kuqe dhe e futi përsëri në xhep. Pastaj ai filloi t'i binte lehtë tavolinës me gishta dhe i përqëndroi sytë në një pikë. Mendonte.

— Mirë, — tha ai më në fund. — Shkoni. Shokët këtu kanë marrë porosi që t'ju ndihmojnë për t'u shpërngulur. Ne do të shihemi përsëri bashkë. Çdo gjë të re që të keni, ja, si ky rasti i Bukuries. na lajmëroni.

Si doli Xhevoja, Gëzimi ra prapë në mendime.

— Po, tip interesant ky Selmani, — tha ai dhe nxori blokun e shënimeve: — Duhet parë mirë puna e tij. Tani ai punon në kooperativë. — Gëzimi shënoi bri emrit të tij «të thirret» dhe e futi blokun përsëri në xhep.

Hyri Pirroja. Dukej i gëzuar.

— Na doli një person mjaft interesant kjo Bukuria dhe më duket se do të ishte mjaft e përshtatshme për të mbajtur disa lidhje me të. Ajo rrjedh

nga një familje e mirë dhe, siç duket, është e predispozuar të na informojë për gjithshka di.

— Pa më thuaj, ç'të tha ajo? — e ndërpreu Gëzimi.

Pirroja u ul dhe ndezi cigaren që i zgjati shoku.

— Dy net përpara se të arratisesh Fetahu, i shoqi i Bukuries, ajo e kishte vënë re që ishte si në ethe. Të tëra punët që fillonte, i linte përgjysmë. I shikonte fëmijët dhe Bukurien me aq mall, thuase do t'i fuste të gjithë në gji e do t'i bluante duke i shtrënguar. Ajo mendonte se mos i shoqi ishte sëmurë dhe ia kishte hedhur fjalën që të shkonte e të vizitohej tek ndonjë mjek, por ai nuk kishte pranuar. Një natë para se të arratisesh, i kishte thënë se ai do të ikte për ca kohë dhe e porositi që të kishte kujdes fëmijët. Tërë natën s'e kishte zënë gjumi. Edhe kur dremiste ndonjë çikë, hidhej përpjetë. Bukuria ia kishte kujtuar përsëri atë punën e doktorit, por ai e kishte parë me inat. Pastaj kishte ndenjtur ulur në krevat dhe i kishte thënë së shoqes: «Ja kam shitur shpirtin shejtanit para se të martoheshim bashkë e të lindim fëmijët».

— «Po përse do ikësh?» e kishte pyetur Bukuria me ndruajtje. Ai kishte heshtur pak, pastaj i kishte thënë: «Në qoftë se Qazimi pranon të bëhet me ne, atëhere do të qëndroj, po nuk pranoi s'kam se ç'të bëj këtu dhe atë do ta qërojmë. Po sakën se i thua njeriu, se edhe nga varri do të ngrihem», e kishte kërcënuar ai. Ajo ishte tmerruar nga shikimi i tij. Po tani që ai ishte mjaft larg e nuk ia kishte më frikën, Bukuria ia kishte thënë Xhevos të fshehtë e saj. Këtë ma tha dhe mua. Ajo e mallëkon të shoqin, që i nxiu jetën, që u hoqi fëmijëve të drejtën të thonë

se kanë baba, dhe i vjen inat që është treguar aq bu-  
dallaqe, — përfundoi Pirroja.

Gëzimi filloi të mendonte për ato që i tha Pirroja. Ai i lidhte të tëra ngjarjet me njëra-tjetrën dhe i vinte të besonte se po i afroreshin shumë së vërtetës lidhur me çështjen e Qazim Belulit. Po aty për aty i erdhi edhe një mendim, që e bëri të djersijë. Mos vallë ky ishte një variant rezervë, i përgatitur me kujdes nga zbulimi i huaj, në mënyrë që ata të kapeshin pas gjërave boshe, të shpenzonin forcat, ndërsa armiku të vepronte më lirisht? Pse, nuk mund ta kurdisnin ata nëpërmjet Fetahut atë Bukuriën, ose nuk mund të kurdisin po kështu atë çobanin? Mendimet iu ngatërruan dhe nuk ishte në gjendje të orientohej më. Ai i largoi këto mendime nga koka dhe s'e kuptoi as vetë se si iu kujtua një ngjarje nga e kaluara. Kur kishte vajtur në shkollë për t'u bërë oficer sigurimi, ai kishte marrë pjesë në një bisedë që kishte bërë komandanti i shkollës me një kursant nga Kukësi, i cili ishte i veshur me rrobat karakteristike të asaj krahine. Komandanti ishte një burrë i shkurtër, me gradën e kolonelit, kishte një zë metalik, kokën e kishte pak tullace. Ishte një njeri energjik dhe futej midis kursantëve e bisedonte me ta. Atë ditë i ishte afruar kuksianit:

«Nga je, mor djalë?»

«Nga Kukësi, shoku komandant». Komandanti e kishte parë për një kohë të gjatë dhe i kishte thënë: «Kur të dalësh oficer, do të kesh kostume të bukura, këpucë, çizme. Por këtë kostumin e këto opingat e lopës ruaji dhe vuri në gardërobë. Sa herë që të ndjesh vështirësi në kryerjen e detyrës, hape gardë-



robën dhe mendo se ku ishte e ç'të bëri partia dhe me siguri do të gjesh forca të zgjidhësh nyjen».

Disa vjet më vonë, Gëzimi e kishte takuar atë djalin, tashmë oficer, dhe e kishte pyetur në e kishte ruajtur atë kostumin. Djaloshi i ishte përgjegjur: «Kostumin nuk e ruajta, por, ama, ato fjalët e komandantit s'kam për t'i harruar kurrë». Edhe gëzimi i ruante ato fjalë si diçka të shtrenjtë. Tani ai e ndjente veten më të qetë, u ngrit, i futi krahun Pirros, që deri atë çast kishte ndenjur në heshtje, dhe u drejtuan për nga maqina.

\*  
\* \* \*

Selmani i ngjiti me ngadalë shkallët, pas policit. Që të djeshmen, kur e kishin lajmëruar të paraqitej në degë, mendimet s'e linin të qetë. S'kishte vënë gjumë në sy e as kishte vënë gjë në gojë. Vetëm duhanin nuk e ndante nga buzët dhe goja i ishte bërë helm. «Përse më duan?» Kjo pyetje i kishte hyrë në çdo qelizë të trupit dhe nuk e linte asnjë sekondë të qetë. Ai ishte i sigurt se gjuhën e kishte mbajtur të kyçur. Qëkur e kishte lenë punën si korrier e punonte në bujqësi, ai bënte një jetë të mbyllur dhe nuk i pëlqenin bisedat me të tjerët. Ai e dinte që Saliu ishte arrestuar, por ishte i sigurt se ai nuk dinte gjë për të. Hyri brenda dhe ndenji në karrigen që i treguan. Gëzimi e priste.

— Cfarë pune keni bërë para se të punonit në kooperativë? — e pyeti ai duke e shikuar drejt në sy.

— Kam qenë ca kohë nënoficer në ushtri. Si u

lirova andej, punova korrier në lokalitet dhe tani punoj në kooperativë.

— Përse u liruat nga ushtria?

— U ngatërrova në ca llogari, se isha magazinier, kështu që më liruam.

— E keni njohur Qazim Belulin?

— Po, e kam njohur, ka qenë i zgjedhur edhe në këshillë.

— Ju kujtohet ta keni lajmëruar ndonjëherë për mbledhje?

— Po, e kam lajmëruar shpesh. Veç detyrës sime, unë e kisha rrugën nga shtëpia e tij dhe e lajmëroja.

— Po para se të arratisesh, i ke çuar ndonjë copë lajmërim?

Selmani ra në mendime. Ai donte t'i krijonte përshtypjen Gëzimit se po mendohej mirë, në mënyrë që përgjegjes së tij t'i jepej vlerë e plotë.

— Jo, nuk më kujtohet ta kem lajmëruar ato ditë. Nuk ka pasur ndonjë mbledhje, sepse mbledhja e organizatës u bë pasi ai u arratis. Aty edhe u përjashtua nga partia, pas arratisjes.

— Pa mendohuni mirë, unë nuk ju pyes kot, — tha Gëzimi dhe e ngriti pak zërin.

Selmani filloi të mendohej, por jo për atë që e pyeti Gëzimi. Ai mendonte si të dilte prej këtej pa i hyrë asnjë gjemb në këmbë; e dinte ai pastaj se ç'duhej bërë. Më në fund u përgjegj:

— Jo, nuk më kujtohet gjë, ka kaluar gjithë ajo kohë.

— Si, nuk ju kujtohet? Ka akoma njerëz të gja-

llë që mbajnë mend se ju keni shkuar tek Qazimi ato ditë.

— Jo, mua nuk më bie ndër mend. Do të mendoj një herë, fundja do të shikoj edhe ca shënime që kam në shtëpi për mbledhjet e lokalitetit, se mos gjej ndonjë gjë atje.

— Mirë, — vendosi Gëzimi, — mendoni dhe eja-ni nesër po në këtë orë.

Selmani doli. Shkallët i zbriti si i dehur. U end një copë herë nëpër qytet dhe pastaj u fut në restorant. Hëngri bukë dhe u nis për në fshat.

Në mëngjez, pa u gdhirë mirë, Gëzimin e kërkuan në degë. U paraqit tek kryetari.

— Si u ndave dje me Selmanin, — e pyeti ai, pa e lenë të ulet fare në karrige.

— E kemi lenë të takohemi sot në ora dhjetë edhe një herë. Ai donte të saktësonte disa gjëra, — u përgjegj Gëzimi, duke menduar të shpjegonte pse e kishte thirrur dhe këtë qëndrim të kryetarit.

— Ashtu, ë, po përse e latë për sot në orën dhjetë, nuk mund ta bënit atë punë që dje?

Gëzimi dyshoi se diçka kishte ndodhur në këtë mes. Mos vallë ishte arratisur Selmani? Do të ishte një gjë për t'u çuditur, se Gëzimi i kishte marrë të gjitha masat. Po kryetari nuk e la ta vriste mendjen shumë.

— Ai është gjetur i vdekur në shtëpinë e tij, pa asnjë plagë në trup. Shko dhe ti në vendin e ngjarjes dhe shikoje me kujdes këtë çështje.

Gëzimi u mbështet në karrige dhe uli kokën; dukej shumë i mërzhitur. Ai e ndjente veten fajtor që ishte treguar i pafuqishëm për të konkluduar që

më parë lidhur me shkallën e implikimit të Selmanit në këtë çështje.

Kryetari e kuptoi gjendjen e tij. Iu afrua, i vuri dorën në shpatulla dhe i tha:

— Mos e humb kështu. Luftë është kjo. Kryesorja është të zbulojmë shkaqet e vërteta të këtyre fenomeneve. Kam kërkuar të vijnë specialistët. Ndihej që të kuptojnë rëndësinë e problemit dhe të bëjnë ç'është e mundur që të arrijnë në konkluzione sa më të drejta. Shko tani.

Gëzimi u ngrit. Në maqinë e prisnin shokët. Ai hipi dhe shoferi, një djalë i ri, që ankohej gjithnjë për gjumë, nisi maqinën, duke ngritur prapa një re të dendur pluhuri.

Kur arritën në vend, doktori sapo kishte mbaruar autopsinë. Gëzimi e mori pak mënjane.

— Doktor, ç'keni konstatuar, cili është shkaku i vdekjes?

— Hëpërhë mund të them se vdekja nuk ka ardhur nga ndonjë sëmundje. Dyshime të forta kam për helmim. I mora organet për një analizë toksikologjike.

— Pra nuk është vdekje natyrale, — tha Gëzimi pak i menduar.

— Jo, natyrale nuk është.

Gëzimi u takua me punëtorin operativ të ndjekjes së krimeve.

— Një vdekje e menjëhershme, e çuditshme, —

e filloi bisedën ai. — Dje më duket se këtë fytyrë e pashë në degë, në mos gabohem ishte tek ti.

— Po e kisha thirrur për një çështje, — i tha Gëzimi dhe filloi t'i shpjegonte gjithshka.

— Unë u interesova dhe nga një burim mësova se ka ngrënë darkë së bashku me mullixhiun në mulli. Me ta ka qenë edhe një person tjetër, — ai hapi blokun e shënimeve, — që quhet Bexhet Alushi, i cili punon në qytet. Prej andej Selmani është kthyer në shtëpi dhe, siç thotë e shoqja, i kanë filluar të vjellat e është ankuar për dhëmbje të forta në stomak.

— Ç'ke menduar të bësh, — e pyeti Gëzimi.

— Do të verifikoj marrëdhënjet me mullixhiun dhe me atë tjetrin, do të bëj një kontroll në mulli, se mos gjej ndonjë gjë që të na interesojë.

— Përse nuk bën edhe një kontroll në banesën e viktimës? — i sugjeroi Gëzimi. — Atje mund të gjesh ndonjë gjë që të na ndihmojë. Ti tashmë e di se ne interesoheshim për këtë njeri.

— Po, — pranoi ai, — do ta bisedojmë me hentesin.

Gëzimi u kthye në zyrë. Pas dhjetë ditësh erdhi përgjegjja nga laboratorit. Në organet e Selmanit ishte gjetur një sasi e konsiderueshme arseniku. Tani përpara grupit operativ shtrohej pyetja: ishte vetëhelminim, apo helmin kriminal? Për secilin u ngritën versionet dhe nisi puna për verifikimin e plotë të tyre.



Gëzimi iu vu punës për verifikimin e versioneve. Për versionin e parë ai arësytonte më me lehtësi. Vetë personaliteti i Selmanit ia lejonte një gjë të tillë. Jeta e tij ishte e mbarsur me gabime, të cilat e kishin detyruar të zbriste shkallët njëra pas tjetrës, derisa kishte përfunduar në një kufomë. Jo, ai nuk mund të gjente rrugëdaljen në vetëvrasje. Njerëz të tillë e duan jetën me një dashuri të pashoqe dhe janë gati të bëjnë ç't'u vijë dore që ta ruajnë atë. Po cila mund të ishte rrugëdalja më e përshtatshme për Selmanin? Në qoftë se ai ishte implikuar në veprimtarinë armiqësore, rrugëdalja më e mirë do të ishte arratisja, sepse ajo i siguronte jetën. Këtë ai mund ta bënte pa hezitim, por ekzistonte një rrezik serioz: kalimi i kufirit nuk varej prej tij. Dhe, në qoftë se e kapnin në tentativën për t'u arratisur, atëhere çenoheshin jo vetëm interesat e tij, por edhe të të tjerëve. Po kush mund të dëmtohej, Dalip mullixhiu, apo ai tjetri, Bexheti? Të dy këta duheshin verifikuar mirë. Njëri nga këta, ose të dy bashkë, ishin të interesuar që Selmanit t'i mbyllej goja, sepse siç dukej ishte vënë në shënjestër.

Papritmas trokiti dera dhe Gëzimit iu prish filli i mendimeve. Brenda hyri Luani, punëtori operativ i ndjekjes së krimeve. Ai mbante në dorë një send të mbështjellë.

— Besoj se do të të interesojë kjo që të kam sjellë, — i tha ai duke shpështjellë letrën, prej nga nxori një pistoletë TT.

— Ku e gjete? — e pyeti pa shumë interesim Gëzimi.

— Nuk të kujtohet? Ti vetë më porosite ta kontrolloja shtëpinë e Selmanit, — tha Luani pak si i fyer.

— Më fal, Luan, unë gati harrova fare. Po ulu, se unë pikërisht për këtë Selmanin po mendoj.

— Dikur ku ka qenë në ushtri, — vazhdoi Luani, — dhe është liruar, veç të tjerash, edhe për humbjen e një arme. Veçse kësaj i është lëmuar numri dhe nuk duket, e unë nuk jam i sigurt në është pikërisht ajo që ka humbur, apo ndonjë tjetër.

Gëzimi filloi të interesohej shumë për këtë armë. Ai e mori në dorë dhe e shikoi me vëmendje. Ishte mbajtur mjaft mirë dhe kishte edhe një kuti me 50 fishekë.

— Po numrin si do t'ia gjejmë, — i tha ai Luanit.

— Ta dërgojmë në laborator. Numri rivendoset me ndihmën e elektrolizës.

— Mirë, dërgoje sa më shpejt.

— Tani edhe një gjë tjetër. Kryetari më urdhëroi që ta ndjekim bashkë çështjen e Selmanit.

— Epo kjo është një gjë mjaft e mirë, sepse, të them të drejtën, unë nuk kam dhe aq eksperiencë në ndjekjen e këtyre lloj krimeve.

Ata ishin takuar shumë herë me njëri-tjetrin dhe Gëzimit i pëlqente shumë ky djalë. Një herë, kur diskutonin për ata të rinj që nuk janë seriozë e jepen pas modës e vagabondllëqeve e që shkasin në rrugë të keqe, Luani i kishte thënë: «Ë keqja më e madhe, për mendimin tim, është se ata harrojnë të

kaluarën e tyre. Ja, merrmë, për shembull, mua. Babai dhe nëna ime, kur u martuan, kishin një kasolle sa për të futur kokën. Me mundime gati mbinjerëzore ndërtuan një shtëpi. Kur nëna mbeti me barrë, babai punonte nëntë muaj rrjesht për të shpyllëzuar e për të hapur një copë tokë, sepse familjes do t'i shtohet dhe një gojë. E ara merrte emrin e fëmijës që lindte. Këtë babai im e përsëriti shtatë herë. Në fshat është edhe sot një copë arë që mban emrin tim. Jo, vëlla, unë nuk kam për ta harruar këtë, se, po e harrova, do të më marrë lumi». Gëzimi e solli ndër mend këtë bisedë dhe u rrëqeth. Atij do t'i dukej i çuditshëm ky veprim. Për një gjë Gëzimi ishte i sigurt: ishte mjaft i kënaqur që do të punonin bashkë.

Ata filluan të bëjnë planin për realizimin e detyrës. Menduan gjatë për ta ndërtuar punën në mënyrë të tillë, që mendimet dhe veprimet e Bexhetit e të Dalip mullixhiut t'i shikonin si në pasqyrë. Punuan deri natën vonë dhe Luani shkoi në zyrën e tij për të bërë një sy gjumë. Edhe Gëzimi u shtri në krevat. Ashtu si disa shoferë, edhe ata e kanë vendin e punës si fjetore ambulante. — Shprehje kjo që përdorej dendur nga një shok i tyre.

\*  
\* \*

Maqina ndaloi dhe prej andej zbriti një mesoburrë, që çalonte nga njëra këmbë. Njëri nga pasagjerët i zbriti një valixhe të vogël dërrase dhe ai u



nis duke çaluar në drejtim të qytetit të vogël të minatorëve. Zuri vend në hotel dhe të nesërmen shkoi në zyrën e punës. E priti një burrë i gjatë, që kishte mbathur një palë çizme llastiku.

— Përse jeni munduar?

Isai, kështu quhej njeriu që çalonte, i zgjati një copë letër. Tjetri lexoi dhe ngriti sytë.

— Uluni. Ju jeni plagosur duke punuar në ndërtime e hidrocentralit?

— Po, punoja minator dhe m'u këput litari me të cilin isha lidhur. Punonim të varur në shkëmbinj.

— Mirë, ne kemi një vend për ju në llogari, merreni këtë letër dhe nesër filloni.

Isai u ngrit, i dha dorën tjetrit dhe doli jashtë. Qyteti ishte i vogël. Ai ishte ndërtuar pas çlirimit. Isai kishte qenë dikur këtej dhe kishte parë vetëm disa baraka, ndërsa tani qyteti kishte marrë një pamje të bukur. Të nesërmen ai filloi punën. Pas disa ditësh, kur u paguante rrogat punëtorëve, ai ngriti sytë dhe e shikoi me vëmendje punëtorin që po nënshkruante listëpagesën.

— More Bexhet, ti qenke, apo më bëjnë sytë?

Bexheti e shikoi me kujdes. Nuk i kujtohej se ku e kishte parë atë fytyrë të njohur.

— Ç'më shikon ashtu, jam Isai, nuk më mban mend, or hutaq?

Bexhetit iu kujtua. Baballarët e tyre, edhe pse i kishin fshatrat mjaft larg njëri-tjetrit, kishin pasur shoqëri. Bexheti me Isain kishin dëgjuar shpesh nga prindërit fjalë të mira për njëri-tjetrin, por ishin takuar vetëm kur qenë të vegjël.

Bexheti i zgjati dorën dhe ata u përqaftuan.

Punëtorët po vonoheshin nga ky takim i për-  
zemërt e njëri prej tyre tha me shaka:

— Ore, na mallëngjyet dhe ne të tjerëve, po  
mjaf, se na presin në shtëpi.

— Takohemi më vonë, — i tha Bexheti Isait  
dhe doli jashtë.

Jashtë ishte ftohtë dhe Bexheti u nis me hapa  
të shpejtë në drejtim të dhomës ku flinte. Ai kishte  
disa vjet që ishte sistemuar me punë në minierë. Pu-  
nonte si furnitor. Zanatit ia kishte marrë mirë anën  
dhe në punë ishin të kënaqur me të. Sa për shoqëri,  
Bexhetit s'ia kishte parë njeri hajrin. Ai ishte si një  
automat. I thoshin se kishte mbledhje, shkonte; kur  
lajmëronin për punë vullnetare, prapë shkonte. Me  
njeri s'para shoqërohej dhe bisedonte vetëm për pro-  
blemet e punës.

Bexheti s'kishte qenë gjithnjë i tillë. Më  
parë ai ishte marrë me aktivitete shoqërore e me  
punë drejtuese. Mirëpo në marrëdhënjet me të tje-  
rët dhe në punën e tij ishin vënë re të meta serioze  
dhe, megjithë kritikën e vërejtjet, ai kishte vazhduar  
në rrugën e tij. Më në fund, si e mbushë kupën, e  
përgjashtuan nga partia për zbutje të luftës së kla-  
save dhe e hoqën edhe nga detyra e kryetarit të kë-  
shillit. Domosdo, Bexheti e konsideronte këtë një pa-  
drejtësi dhe qëndrimi që mbante tani ndaj proble-  
meve, donte të thoshte: ja, unë s'po përziej fare,  
le të shohim tani si do venë punët.

Bexheti hyri në dhomë, hapi komodinën, nxori  
një shishe raki dhe hoqi nja dy herë sa për t'u ngro-  
hur. Pastaj u shtri në shtrat ashtu siç ishte dhe nxori  
një libër për ta lexuar. Pas një ore u ngrit dhe doli  
nga klubi. Atje, në një tavolinë, rrinte Isai dhe Be-

xheti u drejtua për tek ai. Atë natë ata pinë dhe biseduan me njëri-tjetrin. Kjo ishte më shumë se një njohje e thjeshtë. Ajo u ngjante atyre njohjeve të dy dashnorëve, që në ditët e para të takimeve të tyre u duket sikur i perceptojnë njëlloj të gjitha fenomenet dhe për gjithshka që ndodh kanë pikëpamje absolutisht të përbashkëta. Isai ishte fjalëmbël. Ai e tërhiqte gjithnjë e më tepër Bexhetin, i cili atë natë bisedoi aq shumë, thuase do të kompensonte atë kohë që e kishte kaluar në një gjendje apatie. Që prej asaj nate takimet e tyre u bënë më të shpeshta. Një ditë, kur ata ishin duke bërë shetitje e qenë larguar nga rruga kryesore, Bexheti i futi kravatën Isait e i tha:

— Ti ke dëgjuar për amnistinë që ka bërë shteti ynë para disa vjetësh, apo jo?

— E kam dëgjuar, si nuk e paskam dëgjuar, — tha Isai me vetullat pak të vrejtura, sikur u fye nga kjo pyetje që iu bë. — Po ç'ke ti që interesohesh për amnistinë? Me sa di unë, ti nuk je jashtë shtetit.

Bexheti qeshi me zë të lartë.

— Jo se jam jashtë shtetit, por kam një shok që është atje. Ishte një djalë deli djalë, por se kush u bë shkak e i mbushi mendjen, nuk e di. Kështu që një ditë të bukur u arratis.

— E zë amnistia atë, — u bë kurioz Isai.

— E zë, nuk e kishte emrin në listë.

— Po ç'mendon të bësh.

— Mendoj t'i shkruaj të kthehet.

— Po mirë, shkruaji, veçse, a lejohet një gjë e tillë?

— Si s'u lejuaka! Sa më shumë njerëz të gënjyer të kthehen, aq më mirë është. Megjithatë, ty

të vajti mirë në mendje dhe unë po pyes një herë punëtorin operativ, atë djalin e ri që vjen ngando-njëherë këtej.

Si u kthye në dhomë, ai mori një laps dhe i shkroi një letër të thjeshtë Fetahut. Si mbaroi, e palosi dhe e vuri në portofol. Pas disa ditësh ai u takua me punëtorin operativ.

— Desha të bisedoj pak me ju, — i tha ai.

— Urdhëroni, — tha djaloshi dhe, si e thithi edhe një herë cigaren, e flaku tutje.

— Unë njoh një djalë, që ka qenë shumë i mirë, por nuk di se kush e hoqi për hunde dhe u arratis. Kam vendosur t'i shkruaj një letër që të kthehet.

— Për kë e ke fjalën, — i tha pak i çuditur djaloshi.

— Për Fetah Malin. Ja ku e kam dhe letrën.

— Po nuk është nevoja të ma lexosh, — deshi t'i shmangej djaloshi.

— Jo, dua t'jua lexoj, se ju jeni më me shkollë se unë, u përgjegj Bexheti dhe e lexoi letrën gati pa marrë frymë.

— Epo mirë e paske bërë, — tha djaloshi dhe i zgjati dorën.

Bexheti e mbylli letrën dhe e futi në postë që atë natë. Pastaj shkoi në dhomën e tij dhe u shtri në shtrat, pa i hequr këpucët. E ndjente veten shumë të lodhur.

Të nesërmen punëtori operativ shkoi t'i raportonte Gëzimit.

— Përveç njoftimit të parë se Bexheti pregatitej të shkruante një letër, që të thashë para disa ditësh, sot kam një gjë tjetër të re.

— Pa hajde ta dëgjojmë, — u interesua Gëzimi dhe nxori blokun e shënimeve.

— Bexheti më lexoi, as vetë s'e di përse, letrën që do t'i dërgonte Fetahut. Po ajo që më tërhoqi më tepër vëmendjen, është se në letër kishte edhe dy fjalë për atë që interesohemi ne. Në letër thuhej: «Takoje dhe Qazim Belulin e thuaji të vijë edhe ai, se asgjë nuk e kërcënon».

Gëzimi lëvizi pak nga karrigja.

— Si e shpjegon ti këtë? — deshi të dinte ai mendimin e Aliut, punëtorit operativ.

— Të them të drejtën, — tha Aliu, — mua kjo gjë më çuditi shumë dhe më duket si një veprim jo shumë i matur.

— Përkundrazi, — kundërshtoi menjëherë Gëzimi, — mua më duket shumë i matur, gati për t'u admiruar. Bexheti e kupton që ka tërhequr vëmendjen tonë. Saliu është i arrestuar, Selmani u thirr nga ne, çobani diçka ka deponuar dhe ai mendon se, duke vënë atë frazë të mallëkuar në letër, do të na tërheqë për hunde, se ne do të mendojmë që kot rrahim ujë në havan dhe se Qazimi kushedi nga bën qejf andej jashtë.

— Po sikur kjo të jetë e vërtetë, — e shfaqti hapur mendimin e tij Aliu, — dhe ne të jemi gabuar?

— Jo, nuk mund të ndodhë kështu, — tha Gëzimi, por në zërin e tij u ndje një notë lëkundjeje, pesimizmi. — Megjithatë, ne nuk ia kemi vënë vullën kësaj pune dhe po punojmë njësoj për të dy variantet. Veçse duhet të pranojmë që për variantin e vrasjes kemi të dhëna nga shumë drejtime, që na lejojnë të themi se jemi në rrugë të mbarë.

\*  
\* \* \*

Pas dy muajsh ndodhën njëra pas tjetrës dy ngjarje të papritura. Nga një informatë dilte se Bexhetit iu kthye përgjegjja e letrës nga Fetahu dhe pas dy ditësh ai e takoi vetë Aliun. Dukej shumë i mërziur.

— S'më ndezi me atë maskarain. Pa lexoje se çfarë më thotë.

Aliu e lexoi letrën. Fetahu thoshte se ai nuk mund të vinte, se, sido që të ishte puna, kishte tradhëtuar. Veç kësaj, ai nuk para u besonte shumë atyre që shkruheshin në gazetata. Sa për Qazimin, ai thoshte se nuk ndodhej në të njëjtin vend. Qazimi ishte pas një oficeri të zbulimit të huaj, që drejtonte veprimtarinë kundër Shqipërisë. «Vështirë do jetë ta braktisë Qazimi atë vend pëllumbash e të vijë në Shqipëri për të marrë gjysmën e lekut», — shkruante Fetahu. Sa për Bexhetin, ai e falënderonte dhe i thoshte se, si komunist që ishte, ai bënte detyrën e tij e nuk i vinte ndonjë faj, se, fundja, ai, Bexheti, nuk shikonte më larg se hunda e tij.

Aliu ia ktheu letrën.

— Nuk ka faj qelbësira, — tha Bexheti. — Sikur të na vinte dot në dorë, do ta kishte hak gjysmën e lekut. Dhe unë budallai thosha se është djalë i mirë dhe e kanë gënjer.

— Mos u mërzi, Bexhet, njeriu është një maqinë shumë e koklavitur dhe duhet të jesh shumë i zoti që t'ia gjesh difeket, — e ngushëlloi Aliu, duke i zgjatur dorën e duke ia shtrënguar fort, me përzemërsi.

Që atë ditë Aliu vuri në dijeni Gëzimin për përmbajtjen e letrës. Gëzimi u mendua pak dhe shkuan të dy tek kryetari.

— Sapo matesha t'ju thërrisja, — u tha ai duke i ftuar të ulen. — Ka gjëra të reja, interesante.

— Edhe ne erdhëm t'ju themi gjëra të reja, — tha Gëzimi.

Kryetari nxori një letër nga kasaforta. Zarfi ishte i zbukuruar anash me ngjyrë të kuqe e blu.

«Nga jashtë shtetit», — mendoi Gëzimi.

— Këtë letër sapo ma solli e shoqja e Qazimit. Ajo erdhi këtu dhe nuk dinte ç'të bënte. Qante e nuk përmbahej dot: «Më mirë vdekur sesa i gjallë, — më tha ajo. — Ju lutem, sqaroheni këtë çështje».

Kryetari ia zgjati letrën Gëzimit. Aliu u përkul mbi Gëzimin dhe ata nisën ta lexojnë. Përmbajtja ishte e shkurtër. Qazimi i kërkonte të falur gruas, që kishte ikur ashtu rrëmbyer, pa i thënë asnjë fjalë, por nuk mund të thoshte asgjë, sepse kishte dhënë fjalën të ruante sekretin. Tani atë e kishin lejuar të shkruante dhe do t'u dërgonte letra e ndonjë ndihmë ekonomike. Dinte ai si i rregullonte këto punë.

Gëzimi e lexoi me një frymë letrën dhe e rilexoi atë. Kjo copë letër i përmbyste të tëra ëndërrat dhe planet e tyre, si përmbysen një kështjellë prej rëre. Mendja e tij e tulatur tashmë nuk shihte asnjë rrugëdalje. Kryetari e shikonte me kujdes. I ri ishte Gëzimi, por i pjekur. Ai e donte profilin me mjekrën pak të dalë të këtij shoku, që tani iu duk shumë i mërzhitur.

— Mos harro, Gëzim, se fiton ai që ka nerva të qeta dhe logjikë të hekurt. Hajde shkojmë të pimë një kafe dhe t'i hyjmë me qetësi kësaj pune. Për

çdo situatë ka rrugëdalje, por atë nuk mund ta gjejë veçse ai që kërkon me insistim dhe që nuk tërhiqet derisa ta gjejë.

Kur u kthyen në zyrë, Gëzimi i kërkoi kryetarit ta shikonte edhe një herë letrën. Ai ia zgjati. Si ndenji një copë herë duke e studjuar letrën, ai e shikoi kryetarin si për t'i kërkuar ndjesë për hutimin e tij.

— Po këtë letër mund ta shkruajë kushdo, ne duhet ta provojmë që është shkruar nga Qazimi.

Kryetari qeshi gjithë kënaqësi.

— Ja ç'do të thotë të nxitohesh, të ngatërrohesh dhe të humbasësh besimin në çast. Ja ç'do të thotë njëkohësisht të mendosh me kokën të ftohtë. Këtë zgjidhje mund ta japë kushdo që arësyeton me kujdes dhe pa u nxituar.

Gëzimi e kuptoi ku donte të dilte kryetari. Ai po e qortonte se në këtë çështje, megjithëse ishte angazhuar të ndiqte njëloj të dy variantet, prirej më shumë nga varianti për vrasjen.

— Tani unë e kuptoj këtë shumë mirë, — tha Gëzimi pak i skuqur në fytyrë.

— Kam dërguar Pirron në shtëpinë e Qazimit për të kërkuar dorëshkrime të tij. Po ju, ç'doni të më thoni?

Aliu raportoi për takimin me Bexhetin dhe për përmbajtjen e letrës.

Kryetari dëgjoi me interesim, pastaj tha:

— Situata tani po bëhet mjaft interesante, por mendoj se letra e Qazimit do të na sqaronte shumë gjëra. Luani më raportoi se ka të dhëna që Dalpi, ai mullixhiu, ikën natën nga shtëpia dhe kthehet heret në mëngjez. Kjo nuk i ndodh gjithmonë, por janë fiksuar dy raste brenda muajit.



— Po, ne kemi ngritur detyra për këtë, — tha Gëzimi. — Tani për tani ne dyshojmë se ai ka vrarë Selmanin, por me këto të dhëna çështja e tij ndërlikohet më tepër. Ndërsa arma që u gjet në banesën e Selmanit, u identifikua: ishte pikërisht ajo pistoletë, që i kishte «humbur» kur shërbente në ushtri.

— Mirë, çështjen e Dalipit ndiqeni me kujdes, — përfundoi kryetari.

\*  
\* \*

Pirroja arriti shpejt në shtëpinë e Xhevos.

— Desha t'u hedh një sy librave e shkresurina-ve të Qazimit, — i tha ai Xhevos.

Ajo e shpuri tek një arkë e vjetër municioni. Pirroja e ngriti arkën me vështirësi dhe e nxori në një vend me dritë. U ul në një stol dhe nisi t'i kontrollonte librat e fletoret me radhë. Në grumbullin e librave, ai gjeti katër fletore të shkruara me laps kopjativ, me një shkrim të vogël, dhe vendosi t'i merrte. E zonja e shtëpisë i solli kafënë.

— Po i merr?

— Po. Do t'i kthej përsëri.

— Ka ndenjtur shumë kohë mbi ato fletore, jam zënë disa herë me të, se harrohej pas tyre.

Pirroja shfletoi njëherë. Ato ishin shënime të luftës, të shkruara në formën e një ditari. Nuk shquheshin për ndonjë stil të bukur, por ishin mbushur me fjalë të thjeshta e ngjarje të jetës partizane:

«... 13 shtator 1943

Sot komandanti, pas përlëshjes, më dha mitra-

lozin që u kapa fashistëve. Tani jam mitralier i kompanisë».

Pirroja shfletoi një fletore tjetër dhe lexoi:  
«2 dhjetor 1944

Vasfiu po bëhet operacion. Po i presin krahun, që i ka zënë krimba. Ilaç për të vënë në gjumë nuk ka. Ai këndoi derisa humbi ndjenjat. Ne e dëgjonim me sytë të mbushur me lot e duke shtrënguar dhëmbët, sikur bëhej operacion e gjithë kompania».

Pirroja ngriti kokën me përtesë nga fletorja. Ai nuk kishte kohë të lexonte. E mbylli fletoren dhe sytë i vajtën tek kapaku i saj, ku ishte shkruar numri «3». I shikoi dhe të tjerat; mungonte numri «2». Atij i shkrepri një mendim i çuditshëm dhe i drejtoi një pyetje zonjës së shtëpisë:

— Mos ka kërkuar njeri përpara meje në këtë arkë?

— Po, — tha ajo disi e çuditur. — Para nja tre muajsh erdhi Dalipi, një fshatari ynë, dhe më tha se donte ca libra, që ia kishte dhënë dikur Qazimit, se i duheshin, kështu që mund t'i ketë ngatërruar ai. Mos doni që ta pyes?

— Jo, nuk është nevoja, — e qetësoi Pirroja.  
— Unë pyeta fare kot.

Por rrugës, kur po kthehej për në degë, mendonte «çfarë i duhej fletorja Dalipit para tre muajsh?!»

\*  
\* \* \*

Janë njerëz mjaft të qetë ata që merren me pyetjen e «dëshmitarëve memecë». Studimi i shkri-

mit është mjaft i vështirë, sepse vetë formimi i tij tek çdo person është një proces psiqik e fiziologjik.

Është ndryshe, për shembull, në ekspertimin daktiloskopik të gjurmëve të gishtave, të cilin mund ta krahasosh fare mirë me përcaktimin e dy hartave topografike që paraqesin të njëjtin relief, kur u mungojnë të dhënat përkatëse.

I përkulur mbi shkrimin e letrës së Qazimit, eksperti provonte emocione nga më të ndryshmet. Kishte mjaft karakteristika që përputheshin. Por ai vinte re një fenomen të çuditshëm, që nuk i kishte ndodhur në ekspertimet e tjera: ndërsa shkronjat në ndërtimin e tyre përputheshin në një përqindje të mirë, në të njëjtën kohë dukej sikur shkronjave u mungonte zhdërvjelltësia, lidhja harmonike. Shkronjat dukeshin si të montuara dhe nuk të jepnin përshtypjen e një kompozimi, ashtu siç është në të vërtetë shkrimi.

Eksperti ndjeu nevojën të konsultohej me një nga kolegët e tij. U ngrit dhe trokiti në një zyrë tjetër.

— Pa shikoje edhe ti këtë, — i tha një bjondi pak tullac, i cili ishte përkulur mbi mikroskop dhe po studjonte dy plumba.

Ai ngriti kokën, puliti nja dy herë sytë e lodhur nga mikroskopi dhe, pasi i pa materialet, i tha:

— Po ti, a ke arritur në konkluzion?

— Po, unë arrita, — tha ai dhe u largua.

Tjetri i la plumbat dhe u ul në tavlinën e punës me materialet që i pruri shoku i tij. Ai nuk e pyeti për konkluzionin. Ky është një ligj i domosdoshëm në punën e tyre. Është fjala për rrezikun që e kanos ekspertin në dhënjën e konkluzionit, kur ai

ndikohet nga rrethanat e çështjes, ose nga bindja e të tjerëve.

Bjondi e studjoi plot dy ditë atë ekspertim dhe arriti në konkluzion. Pasi mbaroi, nuk e thirri shokun që ia solli, por ia kaloi një shoku tjetër, specialist në ekspertimin grafik. Më në fund ata u mbledhën të diskutonin dhe, pavarësisht nga njëri-tjetri, kishin arritur në të njëjtin përfundim.

\*  
\*   \*  
\*

Grupi operativ ishte mbledhur për të diskutuar rreth realizimit të detyrave. Kryetari mori nga kasaforta një zarf të madh dhe prej andej nxori disa fletë të daktilografuara e disa fotografi.

— Sot erdhi përgjegjja nga laboratorit i kriminalistikës, — e nisi bisedën ai. — Ekspertët kanë arritur në konkluzion se letra nuk është shkruar nga Qazimi, por nga specialistë të aftë në fushën e ekspertimit grafik të dorëshkrimeve. Në këto tabela ato argumentojnë konkluzionin e tyre.

Ata u përkulën mbi tabelat e filluan t'i studjojnë. U dukej një çikë e çuditshme, jo konkluzioni i ekspertëve, por metoda e hollë e punës së përdorur nga armiku. Sikur të mos ishte kapur ky detal i vogël, gjithë punës do t'i vihej një kryq i madh, që do të ishte, në të njëjtën kohë, një vulë turpi edhe për punën e grupit operativ.

— Mbi të zën e këtij konkluzioni ne duhet të nxjerrim disa detyra. Më thoni mendimet tuaja, sipas drejtimeve që keni pasur. Kush e do fjalën?

U ngrit Pirroja.

— Atë ditë që vajta për të kërkuar dorëshkrimet e Qazimit, e shoqja e tij më tha se, para tre muajsh, në shtëpinë e saj kishte shkuar Dalipi dhe kishte marrë disa libra, që dikur ia kishte dhënë Qazimit. Si shpjegohet që ai u kujtua pas kaq kohësh për t'i tërhequr librat? Mendoj që të ndalojmë e të thellohemi më mirë në veprimtarinë e tij. Kam mendimin që ai jo vetëm ka gisht në vrasjen e Selmanit, por këtë e ka kryer për motive të tjera, që neve na interesojnë shumë.

— Mendimi i Pirros më duket plotësisht i bazuar, — e filloi diskutimin e tij Luani. — Dua të shtoj se ai s'ka vajtur atje për libra, atij nuk i duhe-shin ato, ai ka vajtur për fletoren e Qazimit. Dihet që, për të imituar shkrimin, specialistëve të huaj do t'u duhej patjetër modeli i shkrimit të Qazimit. Veç kësaj, siç kam raportuar edhe më parë, është vërtetuar se, në dy raste, Dalipi ka dalë natën dhe është kthyer në shtëpi në të zbardhur të ditës. Mendoj se, po të thellohemi më shumë, diçka do të arrijmë nga dy Dalip, — përfundoi Luani.

— Mua më doli një e dhënë tjetër, që lidhet me atë që thonë shokët lidhur me Dalipin, — e mori fjalën Gëzimi. — Saliu ka deponuar vendin ekzakt të vendosjes së informatave në pyll dhe ne e kemi gjetur atë. Por, nga kontrollet e bëra, nuk kemi mundur të gjejmë asnjë material. Kjo tregon se ne nuk e kemi ndjekur mirë këtë problem. Prandaj, pënderisa Dalipi del natën dhe kthehet në të aguar, pse të mos ngrejmë versionin se ai luan rolin e ndër-lidhësit rezervë? Mendoj edhe unë si shokët, që të thellohemi më tepër.

Kryetari i dëgjonte shokët dhe i vinte mirë për mendimet dhe arësyetimet me logjikë operative që shfaqnin. Tek secili nga ata ai shihte tiparet e një punonjësi të aftë dhe me perspektivë të madhe në organet e sigurimit.

— Ju folët vetëm për Dalipin dhe unë jam dakord me mendimet tuaja. Po me Bexhetin ç'bëhet, — deshi të dinte ai.

— Vazhdon dashuria e tij me Isain, — tha Gëzimi. — Ata të dy më duket se kanë përparuar shumë në marrëdhënjet e tyre. Kam disa të dhëna që më detyrojnë të mendoj — natyrisht kam shumë rezerva në këtë pikë — se Bexheti përpiqet ta futë në kurth Isain.

— Mirë, shikojeni me kujdes këtë problem, veçse kini parasysh, — kryetari nxori një fletë tjetër të daktilogruar, — se pas disa ditësh, sipas kësaj të dhëne, në vendin tonë vjen një vizitor i huaj dhe Bexhetit do t'i duhet të vejë në Tiranë. Aliu dhe Luani do të merren përkohësisht me sqarimin e të dhënave për Dalipin.

\*  
\* \*

Aliu kishte radhën e shërbimit. Ata e kishin ndërtuar pikën e vrojtimit në një pemë të lartë, nga e cila shikohej e gjithë zona ku vendosej posta. Ai e ndjente veten mjaft të lodhur. Përpara kishte natën. Ndërresat nuk i bënin dot të shpeshta, sepse nuk lejonin kushtet. Edhe bukën e hante aty. Kishte dhjetë ditë që e bënte këtë punë dhe nuk kishte asgjë

për t'u shënuar. Herë-herë, puna që po bënte, i dukej si një gjë jashtë logjike. A thua pikërisht ky të ishte vendi që u interesonte? Apo ai, Saliu, i kishte futur në një rrugë pa krye. Megjithatë, ai priste.

«E çuditshme është jeta», — mendonte me vete Aliu. Ai e kishte filluar punën si tornitor, pasi kishte mbaruar vitin e tretë të gjimnazit, ndërsa të katërtin e kishte vazhduar natën dhe i ishte futur me qejf zanatit. Por, si kishte mbaruar ushtrinë e priste të vinte përsëri tek tornoja e tij, e thirrën në komitetin e partisë dhe i thanë se do ta dërgonin të specializohej si punëtor operativ sigurimi. Nga tornoja në dosjet me materiale tepër sekrete. Aliu iu fut me pasion punës si të gjithë të rinjtë, sepse ajo e tërhiqte, po kishte raste, ja si tani, që po priste për dhjetë ditë rrjesht, që kujtonte punën që bënte në torneri. Natyrisht, edhe atje ishte vështirë, por këtu kishte të tjera vështirësi, kishte të bëje jo me bokulla e spinota, por me fatet e njerëzve...

Një zhurmë e vogël ia ndërpreu mendimet. Nuk ishte hera e parë që ai dëgjonte zhurma. Pylli është i mbarsur me zhurma nga më të ndryshmet, që tek fëshfërima e gjetheve e deri tek lëvizja e kafshëve dhe e zogjve. Megjithatë, ai dëgjoi gati pa marrë frymë. Por kjo zhurmë i duk ndryshe nga të tjerat. Pas pak ai pa siluetën e një njeriu, që dukej e zhdukej në mes të pemëve. Ishte natë dhe në dritën e zbetë të hënës nuk mund të dallonte se cili ishte ky «zog nate»; por kjo atij nuk i interesonte, për këtë kujdesej tjetërkush. Aliu vuri dorën instinktivisht në pistoletë, por e hoqi shpejt. Detyra e tij ishte të priste tjetrin, atë që do ta merrte postën. Në këto çaste, atij nuk mund t'i shkonte mendja as për tor-

non e as për shokët e tij. Ai dëgjonte trokitjen ritmike të zemrës së tij, ashtu si ai gjuetari i apasionuar, që, pas një pritjeje të gjatë e me durim, shikon t'i vijë drejt pritës gjahu dhe ndjen se nuk është gabuar në zgjedhjen e pritës. Silueta u afrua deri tek vendi dhe qëndroi ulur atje gati pesë minuta. Aliut kjo kohë iu duk shumë e gjatë. Ai kishte frikë se mos kollitej, ose se mos i shpëtonte ndonjë fjalë instinktivisht. Më në fund njeriu u ngrit dhe u largua. Aliu e ndjeu veten tmerrësisht të lodhur. Të gjithë muskujt, deri tani të tendosur në kulm, iu lëshuan dhe ai ndjeu një kapitje të plotë. Kishte në këto çaste një dëshirë të jashtëzakonshme për gjumë, por ai pikërisht tani nuk duhej të flinte. Në atë gjendje priti deri në të aguar. Ai e dinte se tani fillonte pjesa më e rëndësishme e detyrës së tij. Dikush duhej ta merrte postën. Por përpara kësaj, ai duhej të njihej vetë me të. Me vete kishte marrë aparatën fotografik dhe ishte përgatitur e instruktuar për ta përdorur mirë dhe shpejt. Po si i bëhej po të vinte i interesuari e ta gjente duke e fotografuar. Atëhere prishej e gjithë puna. Nga ky mendim Aliut i shkuan mornica nëpër trup. Megjithatë zbriti nga pema dhe u afrua tek vendi, të cilin e dinte që më parë. Me majën e thikës ai hoqi ashklën, por për çudinë e tij në të nuk gjeti asgjë. Si ishte e mundur? Por aty për aty i shkrepri një mendim tjetër: mos kishte aty një vend tjetër sekret? Ai filloi ta kontrollonte shpejt e shpejt çdo centimetër të pemës dhe më në fund poshtë gjeti një vend të prerë me kujdes. E hapi dhe gjeti letrën. E nxori, po ç'të shikonte! Një fletë fletoreje, në të cilën ishte shkruar një hartim. Ai u bë qull në djersë. Pse, për një copë



letër të tillë kishte ndenjur kaq kohë aty, në majë të pemës? Megjithatë, ai e fotografoi dhe hipi përsëri në pemë.

Në darkë erdhi Luani dhe Aliu e vuri në dijeni për gjithshka. Vetë u nis për t'u çlodhur dhe për të larë filmin.

Luani e ndjente që nuk do të kalonte shumë kohë që të vinin të merrnin informatën dhe priste i gatshëm në çdo moment. Por nuk pati asgjë për t'u shenuar. Erdhi përsëri Aliu për të ndërruar shërbimin.

— Shko lexoje, është një hartim mjaft i bukur. Sidoqoftë, është pozitiv fakti se ai është shkëputur nga fletorja e djalit të Dalipit. Edhe kjo na mjafton. Tani shko, se po e mbaj unë shërbimin dhe, po që se do të na sjellin vazhdimisht hartime, do të bëjmë një përmbledhje të tyre; natyrisht, ne të dy do të jemi redaktorë dhe do t'ua lexojmë shokëve. Ma merr mendja se edhe shoku më serioz ka për të qeshur me ne, — përfundoi Aliu.

— Ç'thua kështu, — e qortoi Luani. — Rëndësi ka që ne zbuluam një kanal, mos harro se midis rrjeshtave mund të shkruhet me bojë të padukshme.

Aliu u çudit nga arësyetimi i tij dhe gjithshka që kishte menduar deri tani, iu duk një absurditet. Ai i dha plotësisht të drejtë Luanit, i cili u nis për në degë.

Nuk kaluan as pesë minuta dhe u dëgjuan hapa. Aliut filloi t'i rrahë zemra me forcë. Ishte i gëzuar që kontaktin e parë me këtë njeri po e vendoste vetë. Pas pak dalloj një njeri të veshur me një xhakëtë të zezë, të hipur mbi një mushkë. Aliu vuri dylbitë në sy dhe ai burri i erdhi fare pranë. I dukej

sikur ndjente frymëmarrjen e tij të rëndë. Kishte një fytyrë të zeshkët e të ashpër, hundë pak me kurriz, buzë të trasha me cepa të varur poshtë. Ai zbriti nga mushka, e lidhi dhe, si hoqi xhakëtën, nisi të presë dru. Kaloi gati një gjysmë ore dhe ai vazhdoi të priste dru. Mos vallë nuk ishte personi që i interesonte? Por megjithatë, nuk ia ndante sytë. Dukej që ai kishte një forcë fizike të madhe dhe, sa herë që e lëshonte sëpatën poshtë me tërë forcën e shpatullave të tij të gjera, e shoqëronte me një «ah», që herë-herë mbytej nga oshëtimat e sëpatës. Pas ndonjë ore ai u ul pikërisht mbi atë trung që i interesonte Aliut, dhe drodhi një cigare. Aliu nuk i hiqte sytë nga dylbitë. Ai e pa tek u përkul për të kruar këmbën dhe me shpejtësi futi dorën tek bujashka. Si bëri ndërrimin (letrën e nxori nga çorapja e tij e leshtë dhe atë që mori e futi po aty), ai vazhdoi të pinte cigaren i qetë. Pastaj u ngrit, ngarkoi mushkën dhe u nis. Mushka lëshoi një hingëllimë. A thua nuk i vjen mirë që u ngarkua aq rëndë, mendoi Aliu, apo mos vallë e ndjeu që ka një njeri përreth. Ai kishte dëgjuar për këtë cilësi të çuditshme të kafshëve dhe u rrëqeth. Por i zoti i saj s'e prishi terezinë. Ai e qëlloi edhe një herë me shufër në vithe, hodhi xhakëtën krahëve dhe u nis pas saj.

Aliu zbriti rrëmbimthi nga pema. Detyra e tij ishte ta verifikonte këtë person. Ai e ndoqi prapa derisa hyri në një shtëpi fshati dhe u kthye përsëri tek vendi. Fotografoi letrën dhe priti derisa të vinte Luani, pastaj të nisej për në degë.

Në zyrën e Gëzimit hyri Aliu.

— Hë, ç'bëre, — e pyeti Gëzimi që po e priste, — e verifikove?

— Po, personi me mushkë quhet Xhemal. Biografia e tij është sterrë. Ka qenë ballist, pas çlirimit ka qenë i dënuar për agjitacion e propagandë dhe për strehim diversantësh.

— Mirë, dëgjo këtu. Kam njoftim se pikërisht ky është takuar me Bexhetin që të nesërmen e ditës që mori letrën tek vendi sekret. Nejsë, këto do t'i verifikojmë më vonë. Kemi të dhëna se Bexheti ka marrë një telegram dhe do të shkojë në Tiranë. Mos harro, vajtja e tij atje koinçidon me ardhjen nga jashtë të një vizitori. Prandaj ti do të shkosh në Tiranë. Ulu dhe lexoi këto, — i tha ai, duke i shtyrë një grumbull informatash përpara. Atje do të takohesh me shokun Nuri, i cili është në dijeni të problemit. Kjo është porosia e kryetarit për ty.

Gëzimi ngriti receptorin.

— Pirro, ti je? Hajde në zyrën time, jam Gëzimi. Pirroja nuk u vonua.

— Pregatitu të shkosh në qytetin «x». Do takohesh me këtë person, — ai i zgjati një copë letër, ku ishte shkruar adresa e plotë. — Ky ka disa kohë që është kthyer si i riatdhesuar. Bisëdo me të nëse e njeh Zahon, i cili ka vepruar si diversant në këto anë. Po që se ka dijeni (ki para sysh se ai ka jetuar në të njëjtin vend me të dhe njihet, e për këtë do të lexosh në këtë proces-verbal), pyete për veprimtari-

në e Zahos këtej. Ne na intereson të dimë prej tij ndonjë gjë për vrasjen e Qazim Belulit. Natyrisht, nëse ka dijeni për këtë.

Pirroja u ul dhe nisi edhe ai të lexonte dokumentat. Ndërsa Gëzimi shkoi tek kryetari për t'i raportuar.

\*  
\* \* \*

Përpara Pirros qëndronte një plak i shëndetshëm, me lëkurë të hollë e të bardhë, me kokën gati tullace. Mbante një palë syze me skelet metalik të hollë ngjyrë ari.

— E njoh, mor djalë, si nuk e njoh Zahon. Për të më kanë pyetur edhe një herë më parë. Po, edhe të mos interesoheshe ta njihje, ai njeri të vinte vetë e të rrihte gjoksin dhe me atë gojën që qelbej gjithnjë era alkool, të thoshte: «Unë jam Zahoja».

— Mos keni dëgjuar prej tij për ndonjë vrasje të kryer rreth vitit 195...?

— Plaku ra në mendime. Pas pak ai ngriti kokën dhe e shikoi në sy Pirron.

— Jeta e tij me vrasje është mbushur e me veprime të qelbura, por, sikur të më thuash emrin e të vrarit, do më ndihmoje se mos e kujtoja.

Pirroja u mendua pak.

— Do të ishte mirë të mendohesha pak. Dua që atë që të ma thoni, të ma thoni pa u influencuar.

— Ashtu, mirë e ke, po halli është se pleqëria

është që të rrëmbesh një shkop e t'i hysh me të, — bëri shaka plaku.

Pirroja qeshi.

— Pa mendohuni, — i tha ai.

— Më mirë unë po të them ngjarjen, — tha ai, — po sa për emrin, unë nuk e mbaj mend.

— Epo mirë, — ra dakord Pirroja, —më thuaj ngjarjen.

— E kam dëgjuar nga Zahoja vetë, — tha plaku, — veçse duhet të kesh para sysh se ai fliste vetëm kur dehej dhe unë nuk di sa e sigurt është. Si dehej, ai griste këmishën e nxirrte gjoksin, në të cilin i dukeshin disa vizatime të çuditshme e një plagë thike, që s'di se ku e kishte marrë. Pastaj fillonte dhe nuk mbaronte derisa vinin shokët e tij dhe e merrnin për krahësh me forcë.

Ai, një herë, tregoi se kishte tërhequr për të rekrutuar një person. Kurthin ja kishin ngritur ata që kishte brenda. I pëlqente të përmendte emrin e njerit prej tyre: «Skifteri». Edhe ky «Skifteri» ka qenë në vrasje. Zahoja tregonte se ai nuk pranoi të bashkëpunonte me ta dhe atëhere kishte dalë ky «Skifteri» e i kishte thënë: «Këtu s'jemi në ato mbledhjet, kur ngrihesh e betohesh se dhe djalin e ther për partinë. Këtu është vendi i burrave, o jep fjalën, o merr plumbin». Ai e kishte pështyrë «Skifterin» në surrat. Në këtë kohë ata i ishin hedhur përsipër dhe e kishin grirë me thika. Më vonë kishin marrë dhe dy të tjerë me vete dhe kishin kaluar kufirin. Për atë hapën fjalën nëpërmjet njerëzve të tyre se ishte arratisur.

Pirroja u ngrit dhe, tek po ndahej me plakun, ky i tha:

— Po të keni përsëri nevojë, më thërrisni, se jam gati. Ah, ç'jetë qeni kam bërë andej, or bir. Ta dish se njerëzit më të ndyrë që kam njohur kur isha në kurbet, ishin ata që qenë arratisur pas çlirimit.

## IV

Në aerodrom kishte gjallëri. Zotin Vasil po e përcillte për në Shqipëri gjithë familja. Ai i tha të birit t'i rregullonte bagazhin dhe, pasi i kërkoi të falur gruas, iu afrua një burri me flokë të thinjur, që mbante një palë syze të zeza.

— Tungjatjeta, zoti Zoi, — tha ai dhe ndjeu zërin t'i dridhej pak. Ai kishte menduar se ata e kishin harruar fare, por, kur e pa majorin midis turmës, u kujtua se duhej ta takonte.

— Tungjatjeta, zoti Vasil. Erdha t'ju uroj rrugë të mbarë, — tha ai me zë të lartë dhe pastaj ndenji e bisedoi me të për një çerek ore të tërë.

Si e pa që gruaja dhe fëmijët e zotit Vasil e humbën durimin, ai u përshëndet me të dhe u largua. Më tutje e priste maqina e tij e zezë.

Zoti Vasil u kthye tek njerëzit e tij dhe pas pak nga altoparlanti tingëlloi një zë i ëmbël gruaje, që i ftonte pasagjerët e linjës për në Shqipëri të hipnin në aeroplan. Vasili u përqaftua me të gjithë dhe u nis drejt avionit. Kur vuri këmbën në shkallën e fundit, ktheu dhe një herë kokën e i përshëndeti me dorë.

Aeroplani u nis. Pas pak ai u shkëput nga pista dhe njerëzit e ndërtesat filluan të dukeshin gjithnjë e më të vogla, derisa u zhdukën fare. I zhytur në vendin e tij, Vasili hodhi shikimin në të kaluarën e tij dhe ajo i doli përpara e qartë dhe reale. Ja si fillonte historia e vizitës së tij në Shqipëri.

\*  
\*   \*  
\*

Zoti Vasil po bënte një gjumë të qetë në dyshekun e tij të butë. Pas një ditë pune të lodhshme e një darke të bollshme, gjumi për të ishte i nevojshëm, në mënyrë që të nesërmen të ishte përsëri i freskët e plot gjallëri. Në gjumë i fanitej ajo shitësja e re, që kishte marrë kohët e fundit të punonte në magazinën e tij të madhe. Për çudinë e tij, ajo ishte veshur me një fustan transparent, me jakë të hapur e të shkurtër jashtë mase. Vasili nuk mund të rrinte indiferent dhe po i afrohej duke kapërcyer me vështirësi pështymën e duke zgjatur pak nga pak duart në drejtim të saj. Vajza nuk po kundërshtonte, ajo dukej se ndjente kënaqësi që zotnia i saj po i bënte këtë nder. Fundja, ai i kishte gjetur punën dhe asaj i duhej t'ia shpërblente në një farë mënyre. Por teksa zoti Vasil po e pushtonte vajzën për beli me ato duart e tij të buta e topolake, një zhurmë e madhe e shkëputi nga kjo ëndërr kaq e bukur. Ishte zilja e telefonit. Ai mallëkoi me zë të lartë dhe mori receptorin. Në anën tjetër u dëgjua një zë i shqetësuar.



— Zoti Vasil, dyqani ynë i rrugës pesë është në flakë.

— Kush je ti, budalla, që më flet ashtu, ç'do të thuash? — e pyeti Vasili që u bë qiqër.

— Jam unë, Kristoja, — bërtiti tjetri në telefon. — Kam lajmëruar zjarrfikësit dhe ata nuk po vijnë. Merrini ju vetë në telefon, ju e njihni komandantin e tyre.

Vasili e mbylli telefonin dhe formoi numrin e zjarrfikësve. Iu përgjegj një zë i përgjumur, që zvarritej.

— Më jepni adresën ekzakte të dyqanit tuaj, zotni, dhe flisni me zë më të ulët.

Vasili i dha adresën, që tjetri deshi gati pesë minuta që ta shkruante, sikur ata nuk flisnin në të njëjtën gjuhë.

Si mbaroi dhe këtë punë, zoti Vasil u ngrit nga krevati dhe veshi **pandoflat e tij të buta**. E shoqja dergjej në krevat dhe nuk donte të dinte fare për ato që ngjisnin: «Dosa, — mendoi me vete Vasili, — di vetëm të hajë, të pijë e të lëpihet. Po të mos më kishite falur ata dy pëllumba (e kishte fjalën për dy djemtë e tij), do ta përzija si ndonjë buçe». Po nuk ishte koha tani të mendohej për këto gjëra. Ai u vesh shpejt dhe zbriti shkallët. Zgjoi shoferin dhe u nis drejt dyqanit të rrugës pesë. Arritën në të njëjtën kohë me zjarrfikësit. Zjarri kishte përparuar shumë dhe sendet që kishin shpëtuar, ishin, si të thuash, një kokosh me plaçka. Ndërtesa ishte bërë shkumb.

Komandanti i zjarrfikësve iu afrua zotit Vasil, e, duke zgjatur përpara fytyrën e tij të mbushur me rrëmba të kuq, vula e alkoolit, që e kishte shokun e tij të jetës, i tha:

— Na vjen keq, zoti Vasil, por kaq mundëm të bënim. Me sa di unë, ju as nuk e keni siguruar këtë dyqan dhe dëmi është shumë i madh.

Zoti Vasil e shikoi me përçmim oficerin pianec dhe, si i dha disa porosi administratorit të tij, hipi përsëri në maqinë. Shoferi priste t'i tregonte drejtimin, por zoti Vasil kishte rënë në mendime të thella. Më në fund shoferi guxoi ta pyeste:

— Zotni, ku t'ju shpie?

Vasili sikur u zgjua nga një gjumë i rëndë. I dukej vetja si një thes me mish, vendosur mbi sedile, por pyetja idiote e shoferit sikur e pruri në vete.

— Në dreq do vemi, — iu hakërua ai, — ku tjetër veçse në shtëpi!

\*  
\* \*

Komandantin e zjarrfikësve e kishin thirrur në drejtori. Ai trokiti në derën e drejtorit, pasi u pa në pasqyrën e korridorit e u bind se ishte në rregull. Hyri brenda dhe e gjeti drejtorin të zhytur në kolltukun e tij të zi, duke shfletuar një revistë të ilustruar.

Drejtori vazhdonte të shfletonte revistën, ndërsa komandanti i zjarrfikësve rrinte në qëndrim gatitu. Ai e njihte mirë drejtorin e tij, i cili të linte të prisje një copë herë të mirë në këmbë dhe pastaj të pyeste, të jepte ndojnë urdhër, ose — kjo ndodhte mjaft rrallë — të lejonte të uleshe e të jepte një

gotë nga ato pijet e mrekullueshme, që s'dihej se nga i vinin.

— Ulu, kapiten, — e theu heshtjen drejtori, duke e flakur revistën në dysHEME.

Kapiteni u ul në kolltuk dhe i hodhi një sy revistës që dergjej përtokë, e cila ishte hapur në një faqe, ku një femër, që dukej se ishte vetë Eva, kur u krijua bota, shikonte me ca sy të përmalluar. Kapiteni i hoqi sytë andej, megjithëse deshë ta admironte akoma atë pamje, por i erdhi turp, ose deshë të rruhej nga xhelozia e drejtorit.

Drejtori hapi një komodinë që ndodhej aty pranë, nxori prej andej një shishe me dy gota dhe ia zgjati njërën kapitenit, i cili u kapërdisi nga kënaqësia.

— E, si vajti puna?

— Në rregull, zoti drejtor. Kur arritëm ne, dyqani i zotit Vasil ishte bërë shkumb.

— Besoj se nuk ka nevojë të të porosit që ta mbyllësh gojën, — e pa me vend t'ia kujtonte drejtori kapitenit.

— Ç'është kjo fjalë, zoti drejtor! As varrit nuk do t'ia tregoj.

Pasi doli kapiteni i zjarrfikësve, dera trokiti përsëri dhe në zyrën e drejtorit hyri një civil shtatllartë, me flokët e thinjur të ndarë anash, i veshur me një kostum të zi, të prerë sipas modës së fundit. Drejtori lëvizi pak nga vendi. Ky gjest tregonte se për këtë vizitor të ri drejtori kishte më tepër respekt.

— Ç'kemi nga ju, major, — i tha drejtori duke i zgjatur një puro.

— Sot pata një takim në universitet. Njeriu ynë atje ka një mendim mjaft origjinal. Ai tashmë është

miqësuar me djalin e zotit Vasil dhe ka filluar ta tërheqë në biseda komuniste. Ka siguruar dy libra me ndihmën time dhe me sinjalin më të parë mund t'i vendosë në çantën e tij. Kur të urdhëroni ju, jam gati të filloj nga puna.

— Mirë keni punuar, por tani për tani është shpejt të marrë një goditje të dytë zoti Vasil. Në fillim duhet të mendohet për gjendjen në të cilën ndodhet, dhe ndoshta arrin në përfundim se duhet të kërkojë një takim me ne.

— Kam frikë, zoti drejtor, se ai nuk do të vijë dot tek ne. Më duket se duhen bërë akoma presione. Ai vazhdon të ketë akoma para dhe ju e dini që, po të ketë para, ka personalitet. Nga kjo rrjedh dëshira për pavarësi.

Drejtori s'po i kthente përgjegje. Ai po admironte shkathtësinë e gjykimeve të vartësit. Drejt u shpreh ai. Paratë janë si themelet e një godine. Nëse e le njeriun pa para, e le pa themele dhe godina pa themele nuk mund të qëndrojë. Kështu që duhet të kërkojë të mbështetet diku. Ai mori receptorin dhe formoi një numër.

— Si jeni miku im? — e pyeti ai me një zë të ëmbël bashkëbiseduesin. — Nuk më thoni, si është gjendja financiare e zotit Vasil? Çfarë, sekret profesional?! Po më çuditni, miku im. Ne të zyrës sonë jemi si tek mjeku. A ndruhet pacienti të zhvishet lakuriq përpara mjekut? Natyrisht që jo. Atëhere dhe ju kështu duhet të bëni. Si thoni... ne jse, unë e di që ju nuk mund të arrini deri aty. Ju e shihni. u muarëm vesh. Po ju pres në telefon.

Drejtori vuri dorën mbi mikrofon dhe iu drejtua majorit:

— Ai po shfleton librat e llogarisë.

Ndërkohë u dëgjua zëri i drejtorit të bankës në telefon. Drejtori ngrysi vetullat dhe lëshoi një vërshëllimë pasi mbylli telefonin. Ai mori një vendim të prerë, të cilin ia komunikoi aty për aty majorit.

— Ky zoti Vasil të thyen kokën me para dhe nuk besoj të na vizitohë së shpejti. Kështu që sot duhet të zgjedhësh pesë djem të shkathët dhe një kamion. Të tjerat i ke vetë të qarta.

Tjetri shqiptoi një «siurdhëron» dhe doli.

\*  
\* \*

Zoti Vasil kishte rënë në mendime. Ai për tri-dhjetë e pesë vjet rrjesht jetonte në këtë vend. I kujtohej si nëpër tym fshati i tij i lindjes atje në Shqipëri dhe nëna e tij plakë. Babai, që i kishte vdekur nga tuberkulozi, i kujtohej pak më shpesh me atë kollën e tij mbytëse e ato mollëzat e faqeve të fishkura, gjithnjë të kuqe. U detyrua të merrte rrugën e mërgimit që në moshën pesëmbëdhjetëvjeçe. Në fillim e pati të vështirë. Puna e vështirë, gati çnjerëzore, dhe malli për nënën e për shokët e torturonin. E mallëkonte në këto momente një fshatarin e tij, që ishte bërë sebeb dhe e kishte marrë me vete për t'u pasuruar. Po nga mallëkimet nuk vinte gjë.

Kaluan vitet e ato lanë gjurmët e tyre, por Vasil u rrit e u burrërua. Kur mbushi të njëzetat, e vendosi të kthehej. Kishte marrë vesh se e ëma kish-

te vdekur dhe ai tashmë kishte mbetur fillkat vetëm në këtë botë e në këtë vend të huaj. Asokohe punonte në minierë. Jeta i kishte mësuar shumë gjëra dhe ai mësoi ta milte mirë atë. Në këtë vend, ku nuk ta zgjaste kurkush dorën të të ndihmonte, ai u mësua të manovronte. E la punën që bënte, dhe me paratë që kishte mbledhur, hapi një pijetore të vogël. Punët nisën t'i venin mbarë. Gjëja e parë që mësoi nga jeta e tij si tregëtar, ishte që ta fshinte nga kujtesa fjalën «ndershmeri». Ai zuri miq që e përkahën (natyrisht, ai këtë ua shpërblente mirë) dhe u martua me Lizën. Kjo martesë ishte një kontratë, si të gjitha kontratat e shitblerjes. Ajo kishte para dhe Vasilit kjo i mjaftonte. Për të, gruaja ishte si një pjesë përbërëse e pasurisë së tij, që i solli fitim, një send që ai e kishte në inventar si të gjitha të tjerat. Kishte një farë respekti për të shoqen vetëm për dy djemtë që i kishte lindur. Djemtë ishin krenaria e tij. I dyti dukej sikur do ta zëvendësonte në punët e tregëtisë, ndërsa i madhi merrej me studime. Ai kishte dëgjuar për të fjalë të mira. Shokët e tij thoshin se i biri kishte prirje të veçanta për matematikë dhe letërsi. Dhe Vasili e kishte lenë të lirë nga çdo gjë. Jetonin të lumtur. Por kohët e fundit dukej se një dorë e padukshme e sulmonte dhe donte t'i prishte lumtërinë. Njëri dyqan u dogj, tjetrin ia vodhën. Shefi i policisë, që kishte ngrënë e pirë kaq herë tek Vasili, dukej shumë i ngathët në veprimet e tij. Premtime kishte bërë shumë, por asgjë nuk po zbulonte.

Zoti Vasil vriste mendjen të gjente shkaqet, por mendja e tij, e tulatur nga fatkeqësitë, nuk punonte, nuk i bindej. Mendimet i ngatëroheshin dhe atij,

në fund të fundit, i dukej më e udhës të pinte që të harronte hidhërimet dhe t'ua nxirrte dufin së shogës, shoferit dhe administratorit, që kishte ca sy si të dhelprës.

Në këtë gjendje e gjeti Zahoja, një bashkatdhetar i tij. Ai hyri i qeshur dhe u ul drejt e në karriqe, si njeri i shtëpisë. Zoti Vasil e njihte Zahon si njeri që ishte arratisur nga Shqipëria për bindjet e tij politike, por kurrë nuk ishte thelluar se ç'ishin këto bindje politike. Zoti Vasil kishte hallet e tij. «Një tregëtar i mirë s'ka përse të ngatërrohet në politikë», mendonte ai. Edhe Zahoja nuk e ngacmonte. Fundja, atij i pëlqente të hante e të pinte në shtëpinë e zotit Vasil, ose në ndonjë nga restorantet ku takoheshin. Por sot ai kishte ardhur për një punë. Zahon e kishin thirrur në një zyrë, i kishin dhënë një paradhënjë, me qëllim që të bënte një bisedë me zotin Vasil, sipas instruksioneve që kishte marrë. I kishin dhënë me vete edhe një çantë, të cilën ai e vendosi mbi karrigen afër atij.

— Ç'kemi, i dashuri im Vasil, — e çeli bisedën Zahoja, duke marrë një puro nga kutia që ishte mbi tavolinë. — Ç'janë këto që dëgjoj për ty. Më duket se po të vijnë fatkeqësitë njëra pas tjetrës.

Zoti Vasil e shikoi me vëmendje. Iu duk me të vërtetë i shqetësuar sot Zahoja. Dukej që s'kishte ardhur as për ndonjë para borxh, as për ndonjë drekë qyl, por thjesht për të marrë pjesë në hidhërimin e tij. Ai ndjeu dashuri për të dhe në të njëjtën kohë ndjeu nevojën t'i qante hallin. Atë çast, për herë të parë në jetën e tij, i shkoi ndër mend se edhe në dejet e Zahos rridhte gjak si ai i dejeve të tij.

— As vetë nuk e di, Zaho vëllai. E kam keq punën. Policia po tregohet e ngathët. Unë nuk di të kem ndonjë armik që të më sulmojnë në këtë mënyrë.

— Po ti kujtohu, mos vallë të kanë bërë ndonjë kërkesë ose propozim e s'e ke pranuar? Duhet të kesh para sysh një gjë, vetëm kuptomë drejt, se unë të flas me dorë në zemër. Këtu vërtet je i stabilizuar e i ke të drejtat si të gjithë, por duhet të jemi të ndër-gjegjshëm, se jemi si të njerks e jo si të nënës.

Vasili u mendua një grimë rreth atyre që tha Zahoja. Jo, nuk ishte më ajo gjuha e tij e shturur, nuk ishin më ato mendimet e tij të zbrazëta. Ai i fliste seriozisht dhe po i hiqte pa pikë mëshire dregëzat e një plage të vjetër, që zoti Vasil nuk ia kishte treguar asnjëri se ku e kishte marrë. Ai vendosi t'i hapej Zahos.

— Para katër muajsh më erdhi një burrë me flokë të thinjur, të ndara anash, e i veshur mirë. Mban-te një palë syze të errëta. Ai njeri më bëri një propozim.

— Çfarë propozimi? — u interesua Zahoja, duke zgjatur qafën jashtë masës përpara dhe duke luajtur pak kokën.

— Këtë nuk mund ta them, se më kanë porositur, — u përgjegj Vasili, — por unë atë propozim e refuzova.

Ra heshtje. Vasili mendonte nëse kishte bërë mirë që ia kishte thënë atë Zahos. Ndërsa Zahoja mendonte se fjalët që do të thoshte në këtë moment, duhet ta justifikonin plotësisht paradhënjen që kishte marrë, dhe të përfitonte edhe kompensimin që i takonte.



— Po përse nuk pranon? Mbase nuk ka qenë ndonjë kiamet i madh. Fundja, ç'jemi ne, gurë shahu jemi, që mund të na lëvizin kur të duan e kush të dojë? Të këshilloj të mos i biesh murit me kokë, miku im.

Zahoja u ngrit, mori çantën dhe doli pak si i çuditur që Vasili pranonte më mirë të rrënohej ekonomikisht sesa të kryente një porosi, çfarëdo që të ishte ajo. Ai eci një copë rrugë në këmbë dhe pastaj e ndjeu se afër tij ndali një maqinë e zezë. U hap dera dhe ai kërceu shpejt brenda. Burri elegant, me flokë të thinjur e të ndara anash, nuk i bëri asnjë pyetje. Ai mori çantën dhe e drejtoi maqinën për nga zyra e tij.

«Domethënë ai nuk ka ndër mend të vijë, — mendoi major Zoi. — Atëhere do ta bëjmë ndryshe».



Përpara godinës së universitetit ndaloi një veturë e zezë. Prej andej zbriti një civil, ndërsa shoferi dhe dy të tjerë ndenjën brenda. Civili ngjiti shkallët dhe hyri në zyrën e dekanit.

— Zoti Spiro, — e filloi bisedën major Zoi, — më duket se është koha të na ndihmoni dhe ju në një punë të vogël. Nuk besoj të jetë nevoja t'ju kujtoj se dikur kemi qenë kolegë dhe ju në saje tonë e zutë këtë post.

— Ç'thoni kështu, major? Unë nuk e harroj për asnjë çast këtë. Po përse është fjala, ju lutem?

Zoi pa orën e dorës.

— Kur të dalin studentët në pushim, më sillni këtu Leonidhën.

Dekanit i erdhi keq që emri i studentit më të mirë të fakultetit u shqiptua në këtë mënyrë nga miku i tij. Por ai nuk mund të pyeste për shkaqet. Normat e punës ai i dinte mirë dhe nuk mund t'i shkelte.

Ra zilja. Korridorët jehuan nga zhurma dhe bisedat e studentëve. Dekani doli dhe pas pak në zyrë hyri Leonidha. Njëzetvjeçar, me ballë të lartë e fytyrë të rregullt, me trup të lidhur mirë e i veshur me hijeshi. Ai qëndronte gjithë respekt përpara këtij të huaji dhe u çudit që dekani s'i prezantoi, por i la vetëm.

Ata qëndruan një çast pa folur, duke shikuar njëri-tjetrin. Leonidha nuk i uli sytë dhe kjo shkaktoi një ndjenjë kënaqësie tek Zoi, që mbahej si njohës i mirë i karaktereve dhe i psikologjisë së njerëzve. Aty për aty ai mendoi se jo zoti Vasil, po biri i tij do të ishte një kandidat i përshtatshëm për detyrën që kishin. Zoi aty për aty projektoi punën për të ardhmen e këtij djaloshi. Po tani për tani djalit i ishte caktuar roli. Ai duhej të shërbente si karrem për të kapur një peshk të majmë dhe, për fat të keq, ky peshk ishte pikërisht i ati i tij.

— Ju, Leonidha, jeni me origjinë shqiptare, — e hapi bisedën Zoi, — apo gabohem?

— Po, zotni. Por unë jam shtetas i këtij shteti. Im atë është nga Shqipëria, ndërsa nënën e kam vendase. Shqipërinë nuk e njoh fare.

— Po gjuhën e dini?

— Në saje të babait, gjuhën shqipe e zotëroj mjaft mirë.

— Po si e ushtroni, a lexoni, a e dëgjoni radion?

— Jo, — u përgjegj djaloshi, si nguroi pak... — as lexoj dhe as dëgjoj radion.

— Për një shkencëtar të ardhshëm, mungesa e sinqeritetit është shenjë e keqe, mor djalë. Ne do t'ju faktojmë të kundërtën. Ju merreni në universitet me propagandë komuniste.

— Kjo është shpifje, zotni.

— Mirë, do t'ju kontrollojmë. Besoj se ju nuk keni ndonjë kundërshtim.

Djaloshi ngriti supet. Në këtë kohë hyri dekani. Zoi i propozoi të venin në klasë për një kontroll, po me kusht që studentët të mos ishin atje. U drejtuan për në klasë, Leonidha ecte me këmbët si të prera. Ai e mallëkoi njëqind herë Viktorin, që i kishte dhënë atë mëngjez ata dy libra.

Në kontrollin që përfshiu gjithë klasën, u gjetën materiale të ndaluara në çantën e Leonidhës dhe të Viktorit. Zoi qeshi me sarkazëm, kur i gjeti dhe urdhëroi t'i sillnin dhe Viktorin. Ky erdhi sakaq, i bërë dyllë i verdhë. I shoqëruan që të dy në maqinë.

Dekani e pa maqinën që po largohej, dhe fërkoi duart. Ai e dinte që sa për sy e faqe do të mernte një vërejtje që studentët e tij s'ishin në rregull. Por atë e ngrohte mendimi se atë do ta lavdëronin nga ish zyra e tij. Fundja, Viktori ishte krijesa e tij dhe atë askush nuk mund t'ia mohonte, e aq më tepër t'ia përvetësonte, siç ndodhte dendur në kësi punësh.

\*  
\* \* \*

Zoti Vasil nuk kishte më maqinë. Atij i ishin qepur kreditorët dhe dukej që po hiqte dorë nga të mirat e kësaj bote. Ai e krahasonte rënjen e tij me lëshimin e aeroplanit në pikiatë. Rreth këtyre gjërave mendonte, kur ra zilja e telefonit.

E ftuan, pa i dhënë asnjë sqarim, që të paraqitej në zyrën e policisë për një çështje që kishte të bënte me djalin e tij. Vasili hyri në mendime. Ç'ti kishte ndodhur djalit të tij?! Jo, patjetër kishte ndodhur ndonjë keqkuptim e asgjë më shumë. Ai u ngrit, veshi pallton, mori çadrën dhe u nis për në zyrën e policisë politike.

E futën në zyrën e major Zoit. Atje gjeti edhe të birin së bashku me një shokun e tij, Viktorin. Djemtë ishin katandisur në pikë të hallit. Vasili, nga pamja e tyre, e kuptoi se situata ishte e rëndë e jo ashtu siç e kishte parashikuar.

— Ju thirra, zoti Vasil, t'ju vë në dijeni se djali juaj është ngatërruar në çështje politike. Ai zhvillon propagandë komuniste dhe u shpërndan studentëve libra me përmbajtje krejt të ndaluar. Krimi është plotësisht i vërtetuar, — përfundoi major Zoi.

Vasili deshi të ulej. Ai nuk kishte më forca të përballonte sulme të tilla.

Majori i ra sinjalit dhe dy policë hynë brenda. Ata u vunë hekurat djelmoshave dhe i morën me vete. Ky veprim iu duk Vasilit tamam si veprimi i xhelatit, i cili do t'ia marrë shpirtin viktimës pak nga pak, me anë ceremonish të stërzgjatura.

Iu kujtua se kjo histori kishte nisur tetë muaj

më parë. Një ditë, pikërisht ky Zoi, që atëhere nuk e njihete, i kishte vajtur në zyrë dhe i kishte dhënë një kartëvizitë që të paraqitej në zyrën e tij. Vasili kishte vajtur në kohë, por në vend të tij e kishte pritur një burrë tjetër, i cili kishte hyrë drejt e në temë.

«Si qytetar, keni për të marrë përsipër një detyrë, që shpresojmë se do ta kryeni më së miri».

«Varet nga detyra, zotni».

«Ju keni një të afërmin tuaj në Shqipëri, për të cilin ne kemi interesa. Duhet të hyni në lidhje me të. Në këtë punë do t'ju udhëheqim ne dhe ju s'keni përse të vrisni mendjen për asgjë».

«Jo, nuk mund të merrem me gjëra të tilla. Di që kam një kushëri të parë, që quhet Sokrat, por unë thuhetse nuk njihem me të dhe nuk kam ndër mend t'u hyj këtyre punëve».

«Mos u nxitoni në përgjegjet tuaja, ne kërkojmë fare pak nga ju».

«Jo, unë nuk dua të merrem me këtë punë».

Ata ishin ngritur të dy më këmbë dhe nëpunësi ishte treguar shumë xhentil. E kishte përcjellë deri tek dera dhe, kur po ndaheshin, e kishte porositur:

«Nuk besoj ta bisedoni me njëri këtë çështje dhe, po qe se ju mbushet mendja, më telefononi». Në xhep i kishte futur kartëvizitën dhe numrin e telefonit të tij.

Po zoti Vasil e kishte harruar me kohë këtë ngjarje. Ndërsa tani, i ulur në karrige përpara major Zoit, e kujtoi me hollësitë më të vogla dhe e kuptoi që qe zënë ngushtë. Aty sollj ndër mend edhe bisedën me Zahon.

— Zoti major, a mund të takohem me gjeneralin?

— E përse e doni? Ai është shumë i zënë. Po qe se keni ndonjë gjë, ia them unë.

— Jo, po pati mundësi, dua të takohem personalisht me të. Dikur kemi lenë një bisedë përgjysmë. Do të dëshiroja ta vazhdonim. Mendoj se edhe ai nuk ka për të qenë kundra, — tha zoti Vasil.

— Mirë, po përpiqem një herë. — Majori mori receptorin dhe formoi numrin e gjeneralit. Si bisedoi një farë kohe në një gjuhë, që Vasili s'e kuptonte, ai uli receptorin dhe tha:

— Gjenerali do të jetë i lirë pas një ore. Kaloni në dhomën e pritjes.

Ajo orë Vasilit iu duk si një shekull. Më në fund hyri brenda. Gjenerali ishte i zhytur në punë dhe e la të priste gati pesë minuta në këmbë. Ndërkohë Vasili po i hidhte një sy zyrës. Çdo gjë në të dukej e errët: kasaforta, kolltukët, perdet. Çudi si nuk e pat vënë re misterin e kësaj dhome, kur kishte ardhur herën e parë. Apo ndoshta atëhere nuk kishte asnjë hall.

— Ç'urdhëroni? — e pyeti gjenerali me një zë të akullt, në një mënyrë të tillë, sikur çdo minutë për të ishte e shtrenjtë.

— Unë jam gati të pranoj propozimin tuaj, por me kusht që të më nxirrni djalin prej këtej, — i ra shkurt zoti Vasil.

— Djaln tuaj? Mos është ai studenti, që zhvillonte propagandë komuniste?

— Jo, zotni, ai kurrë nuk ka zhvilluar propagandë të tillë, ai është çilimi.

— Gaboheni. Ai nuk është çilimi dhe ka pranuar çdo gjë. Së shpejti do të dalë në gjiq.

— Ju më bëtë një propozim dikur dhe vij t'ju them se tani jam dakord.

Gjenerali u mendua gjatë. Këtu kishte mundësi të vriste me një gur dy zogj. Së pari, kombinacionet për të shtënë në dorë zotin Vasil kurorëzoheshin me sukses dhe, së dyti, ai mund të nxirrte një grusht para për lirimin e të birit. Sa për Viktorin, bashkëpunëtorin e major Zoit, ai mund ta nxirrte kur të donte e, veç kësaj, mund t'i jepte edhe një shpërblim. Gjenerali deshi të fërkonte edhe një herë duart, siç e kishte zakon kur përfundonte ndonjë «aksion personal», siç i quante ai, por iu desh të përmbahej.

— Mirë, unë do ta bisedoj më lart këtë çështje, ndërsa ju, tani për tani, do të nënshkruani këtë deklaratë bashkëpunimi me ne. Më vonë do t'ju njoftojme për detyrën që do të kryeni. Me këtë rast ju vë në dijeni se policia kriminale është në gjurmë të atyre që kanë vjedhur magazinën tuaj. Shpresojmë se sendet do t'ju kthehen, — tha ai duke mbyllur bisedën.

Vasili doli nga zyra i dërmuar. Ajo bisedë e shkurtër me gjeneralin dukej sikur kishte qenë kontrata e skllavërisë së tij të përjetshme. Pra, ai tani nuk i përkiste më vetëvetes, por ishte si një gur shahu në dorën e të tjerëve, të cilët tani e tutje do ta lëviznin sipas disa skemave të caktuara dhe ai nuk kishte më asnjë të drejtë, por vetëm detyra. Natyrisht, Vasili nuk ishte aq naiv, sa të mos ta kuptonte se në ç'gjendje kishte rënë. Ndjente t'i vlonte përbrenda dëshira për të rrëkëllyer ndonjë gotë, për të ndrequr pak nuhatjen. Ai kishte besim se çfarëdo që të kërkohej prej tij, do ta realizonte. Ishte i bindur për zotësinë dhe aftësinë e tij. Jeta, hallet e së

cilës i kishin lënë gjurmë që nuk shlyheshin, e kish-  
te bërë optimist. U kthye në pijetoren e parë të rru-  
gës. Aty pinin dhe bënëin potere. Hodhi dhe ai disa  
gota e ndjeu nevojën të mbërthehej me ndonjërin,  
të rrihej, ose ta rrihnin. Po, për çudinë e tij, hyri  
Zahoja, i qeshur dhe i gatshëm për të rrëkëllyer  
ndonjë gotë.

Ata u ulën në stolat e lartë të banakut, afër një  
leshverdhe, që priste t'i afrohej ndonjë kavalier.  
Vasili i hodhi një sy dhe e vlerësoi nja dyzet vjeçe.  
Ajo dukej si një limon i shtrydhur e i flakur tej, por,  
megjithatë, kishte bërë një tualet të hollë, si të don-  
te t'u thoshte të tjerëve se nuk ishte shtrydhur  
plotësisht.

— Të shoh në qejf sot, — e ngacmoi Zahoja. —  
Si ta shpjegoj këtë?

— Njeriu, veç qejfeve, nuk ka ç't'i shikojë kë-  
saj bote. Vuajtjet janë për ata, që, në detin e madh  
të jetës, lëshojnë lopatat dhe e lenë barkën ta shtyjë  
era nga të dojë. Ndërsa unë nuk jam gatuar nga ai  
brumë. Nuk i lëshoj kollaj lopatat.

— Vërtet, ti nuk i lëshon lopatat, por preferon  
për të mos u mbytur, të rimorkjohesh pas ndonjë  
anijeje tjetër, — e thumboi Zahoja. — Pikërisht për  
këtë dua të pimë sonte. Gëzuar, — shtoi Zahoja gj-  
thë entuziazëm.

— Gëzuar, — u përgjegj Vasili dhe, tek po ngrin-  
te gotën me fund, mendoi: «Ky qen nuk është aq  
budalla, sa kërkon të hiqet. Duket që di shumë gjë-  
ra. Pa le që më flet dhe me figura!»

Por gotat ndiqnin njëra-tjetrën dhe ata nuk ki-



shin më kohë për bisedime filozofike. Ata pinin dhe Zahoja vetëm për një gjë ishte i sigurt: se miku i tij kishte hyrë në të njëjtën valle si dhe ai vetë, dhe se paratë për gotat e kthyerat sonte do t'i paguante zoti Vasil.



Pas kësaj, zoti Vasil vazhdoi punën i qetë. I biri vazhdonte rregullisht studimet. Punët e financës ai i vuri përsëri në vijë dhe kreditorët e lanë të qetë. Ai gati po i harronte peripecitë që kaloi me zotërinjtë e policisë dhe ngandonjëherë ato i dukeshin si një ëndërr e keqe, që e kishte parë kohë më parë. Ata as që ishin kujtuar më nëse ekzistonte në botë zoti Vasil dhe, siç dukej, s'kishin ndër mend t'i caktonin ndonjë detyrë. Por frikën, ama, ua kishte. Ai hiqte kapelen me shumë respekt, sa herë që i kalonte përpara major Zoi, ndërsa ai e përshëndeste fare ftohtë, sikur të ishin njohur rastësisht në një udhëtim me tren. «Të çuditshëm janë këta njerëz», — mendonte me vete zoti Vasil. Mirëpo një ditë dikush e mori në telefon. I dhanë një adresë dhe orën në të cilën duhej të paraqitej. Vetëm kaq. Nuk i lanë kohë të kërkonte ndonjë shkoqitje.

Vasili pa orën e tij të dorës. Donte dhe tri orë që të shkonte në pikëpjekje. Mbyllj dokumentat, i la borosi sekretares dhe u nis pa u nxituar për tek vendi i takimit. Ecte dhe mendohej për këtë takim. Përse e donin? Mos vallë donin ta dërgonin në Shqi-

përi? Jo, ai nuk do të shkonte atje pa pasur garanci të plota. Zoti Vasil nuk ishte budalla. Atij vërtet që edhe filmat me detektivë nuk i ngjallnin emocione e i shikonte pa qejf, po ai e dëgjonte radion dhe, megjithëse ato që dëgjonte nga Radio Tirana, si tregëtar i mirë që ishte, i pjesëtonte me dy, prapëseprapë, edhe të pjesëtuara me atë koeficient, ato që kishte bërë Shqipëria ishin shumë. Jo, ai nuk mund të linte kokën atje dhe pikërisht për këtë do kërkonte garanci.

Me këto mendime në kokë ai u end për një kohë të gjatë nëpër rrugët gjithë zhurmë të qytetit, dhe, si i hodhi për të dhjetën herë një shikim orës, u drejtua për në adresën që i kishin dhënë. Ai u afrua me hapa të ngadaltë atje.

Ishte një vilë e vogël dykatëshe, e lyer me ngjyrë të verdhë dhe e rrethuar me një mur të lartë. Nga muri dukej vetëm fasada e katit të dytë dhe gjethet e pemëve. Zoti Vasil u afrua dhe i ra ziles, që qe fiksuar në anën e majtë të derës. Ai dëgjoi hapa dhe pak pas dera u hap. Pa një grua plakë përpara tij, që e lejoi të hynte brenda, pa i bërë asnjë pyetje. Zoti Vasil u çudit pak nga kjo pritje. Gati iu krijua përshtypja se ky ishte një han pa porta e jo një shtëpi konspirative, siç e mendonte ai. Por Vasili nuk dinte, dhe nuk mund ta dinte, se, që nga koha që kishte nënshkruar deklaratën, e kishin mbajtur në vëzhgim të pandërprerë dhe ai nuk kishte mundur të identifikonte asnjërin prej tyre. Edhe tani që ai po hynte brenda e po zinte vend në një sallon pritjeje gjithë komoditet, pesëdhjetë metra larg vilës kishte ndaluar një veturë, në të cilën ishin tre djel-

mosha të rinj. Njëri nga ata, nëpërmjet një radioje të vogël, njoftonte për lëvizjet e përpikta të zotit Vasil, ndërsa në mesin ku hyri Vasili, një grua ishte përkulur mbi një aparat dhe dëgjonte raportin, të cilin e inçizonte, që të kishte mundësi shefi të një-hej personalisht me të.

Pas dhjetë minutash pritjeje, zoti Vasil pa të vinte drejt tij major Zoin me një mesoburrë të dobët e si të sëmurë, të cilin kurrë nuk e kishte parë më parë. Si u takuan, ai mesoburrë filloi të fliste shqip me Vasilin dhe ky e kuptoi se kjo gjuhë nuk ishte e huaj aspak dhe për major Zoin.

— Për të kryer detyrat tuaja, do t'ju duhet herë pas here të vini në këtë mesin, — i tha major Zoi. — Do të merrni disa njohuri fare të thjeshta, të cilat do t'ju shpjegojë kryesisht zoti Gjini.

— Po nuk më thoni, zotni, cilat janë këto detyra? — s'iu durua zotit Vasil të pyeste.

— Mos u ngutni. Në fillim do të bëni përgatitjen e domosdoshme, pastaj do të fillojmë nga detyra. Pa e njohur kundërshtarin, nuk mund ta luftosh.

Major Zoi i la vetëm. Ata qëndruan një copë herë pa folur. Pastaj Gjini u ngrit dhe e ftoi zotin Vasil në një dhomë tjetër për të filluar punën.

Nuk kaluan as dy muaj nga fillimi i përgatitjes dhe Gjini mori urdhër të shpejtonte programin e përgatitjes. Më në fund zotit Vasil iu caktua detyra e tij e parë. Atij i dhanë adresën e kushëririt të tij, Sokratit, dhe i përgatitën letrën e parë për të. Këtë letër, që ia dha Gjini, Vasili e kopjoi dhe e ni-

si për në Shqipëri. Ai u çudit kur iu kthye për-gjegjja.

Në fillim e nisi korrespondencën me të kushëri-rin në Shqipëri vetëm për shkak të detyrës, por, pasi mori letrën e parë prej tij, filluan të ngrinin krye disa ndjenja, në krye disi të zbëta, por që sa venin e bëheshin më të qarta. Atij iu kujtua fshati i lindjes dhe Sokrati i vogël. Ata nuk e ngopnin dot kurrë barkun me bukë. Vasili vente shpesh tek xhaxhai i tij, sepse atje ishte Sokrati. I vogël, i dobët, me një tufë flokësh të verdhë e rebelë që i rrinin mbi ballë. Ata të dy vraponin nëpër lëndinë me ato këmbët e tyre të vogla e të zbathura. Këmbët e tyre. Të shkretat këmbët e tyre! Ato nuk i gjeje dot kurrë pa një plagë ose pa një të gërvishur, sepse, sa shërohej njëra, hapej tjetra. I kujtoheshin plot raste kur nëna e Sokratit, një grua e urtë e punëtore, kur nxirrte bukën nga furra, u priste nga një copë të ngrohtë e ua jepte me një vezë. E, kur ata e mbaronin vezën, e ndanin bukën në dy copa e njëjërën e quanin gjellë, ndërsa tjetrën bukë.

Vasilit iu mblodh një nyje në grykë dhe iu largua vetëm kur sytë iu mbushën me lot e kur ata filluan t'i pikojnë në letër. Pastaj ai mori fotografinë. Jo, nuk kishte mbetur më asnjë gjurmë nga ato që mbante mend ai nga Sokrati. Nga fotografia e shikonte me krenari një burrë rreth të dyzetepesave, i shëndetshëm, i veshur mirë. Pranë tij qëndronte e shoqja dhe në këmbë, përreth tyre, dy djemtë dhe vajza. Në sytë e tyre pasqyrohej një ndjenjë: lumtëria. Fotografinë e tyre e vendosi mbi tavolinën e punës dhe e shikonte shpesh. Tiparet e secilit

iu ngulitën në kujtesë. Admironte veçanërisht Agimin, djalin e dytë, me balië të lartë e të gjerë, me flokët kaçurrelë të krehur lart, e me një trup atleti. I dukej se ngjante me djalin e tij, Leonidhën.

\*  
\* \* \*

Një ditë, gjenerali e gjeti duke biseduar me Gjninin dhe i komunikoi se do të nisej për në Shqipëri. Zoti Vasil provoi dy ndjenja të kundërta: ndjenjën e gëzimit se do të takohej me të afërmit e tij, e cila dalëngadalë, kur mendoi se përse do vente atje, filloi të zbehej dhe të zëvendësohej, derisa arriti kulmin, duke u shndërruar në një ndjenjë frike.

— Çfarë detyre do të kryej? — e pyeti ai gjeneralin, duke shkelur kështu një nga rregullat më elementare të punës, që ia kishin përsëritur shpesh dhe që donin t'ia ngulnin në kokë si me çekiç.

Gjenerali shkëmbeu një shikim të shpejtë me Gjninin dhe muskujt e fytyrës iu tkurrën, sikur ta kishte zënë ngërçi, sytë iu zvogëluan, buzët i shtrëngoi fort me njëra-tjetrën dhe zotit Vasil iu duk si një i çmendur.

— Do të mbash një fjalim në qendër të Tiranës, — i tha gjenerali. — Je i kënaqur?

Vasili i kërkoi falje.

— Tani bëj kërkesën për vizë dhe, si të të aprovohet ajo, do të marrësh detyrën. U kuptuam?

— Siurdhëron, — u përgjegj Vasili, që mezi po mbahej në këmbë në atë gjendje të nderë që ishte krijuar.

Kur mbetën vetëm Vasili me Gjinin, mbretëronte një atmosferë e ftohtë midis tyre. Më në fund Gjini theu heshtjen:

— Duhet të tregoheni më i matur. Kurioziteti i tepruar është gjithmonë i dëmshëm. Sot nuk do të punojmë. Paraqitni kërkesën për vizë dhe rrini i qetë. Asnjë takim të dyshimtë, asnjë gotë pije më tepër. Në qoftë se do të konstatohet ndonjë gjë e dyshimtë. . .

\*  
\*   \*  
\*

Dhe ja ku më në fund zoti Vasil ndodhej në aeroplan. Ai e hoqi mendjen nga peripecitë e tij dhe filloi të mendonte për Shqipërinë. «Interesant, — mendonte ai, — a janë të vërteta të gjitha ato që thuhën për të?» Ai ishte përpjekur të krijonte një mendim të saktë për gjendjen në Shqipëri, por nuk kish-te mundur, sepse, duke dashur të zbulonte të vërtetën, kishte shfrytëzuar shumë burime. Bile shumë herë, veçanërisht kohët e fundit, e hapte shpesh radion në stacionin e Tiranës e në të jepeshin mjaft gjëra interesante.

Mendja i shkoi pastaj tek Zahoja. Ai ia paraqiste me ngjyrat më të zeza gjendjen e Shqipërisë. Kur mori vesh se Vasili do të shkonte në Shqipëri, ai e takoi dhe i tha:

— Nuk ta kam zilinë. Mbaje vëth në vesh nga unë: diktaturë më të urryer se atje, as ke parë e as ke për të dëgjuar. Veç detyrat kryeji mirë. Po ki kujdes se, për dyshimin më të vogël, të varin mu në

qendër të qytetit. Në rast se nuk kryen detyrën, pisk do ta kesh edhe këtej. Një herë më ngarkuan të rkrutoja një njeri. E thirra, por ai nuk pranoi në asnjë mënyrë. Atëhere u dhashë shenjë shokëve dhe ata mbaruan punë në pak sekonda. Natyrisht, unë nuk kalova me pasaportë andej, siç po shkon ti, por nëpërmjet kufirit e me qefinin në trastë. Këtë ta them që të kesh kujdes. Në qoftë se i propozon njërit një detyrë dhe ai nuk ta pranon, atëhere qëroje, por me mjete moderne e jo si veproja unë e shokët e mi një herë e një kohë. Po nuk e qërove, gjëja e parë që do të bëjë ai është të shkojë tek ata të sigurimit dhe kjo nuk do të jetë një gjë e këndshme për ty.

Pastaj zoti Vasil u mbështet në ndenjësë dhe filloi të dremiste. E zgjoi zëri i stjuardesës, që paralajmëronte pasagjerët për ulje. Ai u lidh me rrip dhe zgjati kokën në dritare. Që andej pamja ishte e mrekullueshme. Në kufitë midis malesh, në një luginë të madhe, shtrihej qyteti. «Kjo është Tirana», — mendoj Vasili dhe i hoqi sytë prej andej, se i merreshin mendtë.

Aeroplani bëri rrethxhirimet e tij të zakonshme dhe u dëgjua kontakti i rrotave me pistën. Pas pak zhurma pushoi dhe pasagjerët, si të trulllosur, u ngrihën nga vendet e tyre.

\*

\* \*

E kishte të vogël familjen Sokrati. Tani fëmijët i ishin rritur. Djali i tij i madh ishte inxhinier në ushtri. Kishte studjuar jashtë, veçse vitin e fundit

e kishte bërë në Shqipëri. Ai ishte i martuar dhe jetonte me të shoqen në qytetin ku shërbente. Djali i dytë ishte pedagog në një institut, ndërsa Shpresa, vajza e vetme, mësonte në klasën e tretë të gjimnazit.

Ishte natë dhe ata qenë mbledhur e po lexonin letrën që u dërgonte kushëriri i tyre, Vasili, nga jashtë shtetit. Ishte një letër e shkurtër, që më shumë synonte të arrinte rinjohjen e tyre. Vasili thoshte se e kishte gjetur rastësisht adresën e tij nga një shok që kishte shkuar me shërbim në qytetin e tyre e që vinte nga Shqipëria. Ai e vinte në dijeni se familja e tij përbëhej nga gruaja dhe dy fëmijë dhe se jetën e kishte rregulluar shumë mirë.

Si mbaruan së lexuari, Shpresa i tha të atit:

— Baba, na thuaj ndonjë gjë për kushëririn tënd.

Sokrati ra në mendime. E ç'mund t'u thoshte. Ai e mbante mend Vasilin si një djalë fare të vogël, që kishte marrë rrugën e kurbetit. Ai ishte i sigurt se do ta kishte shumë të vështirë ta njihte, nëse do ta binte rasti të shiheshin.

— Ç't'ju them, ai ka ikur shumë i vogël në kurbet. Atëhere ishte e vështirë ta siguroje bukën e gojës.

— Thuaj si të duash, — i tha Shpresa, — po ai ka mundur të pasurohet atje.

— Ka ditur të rjepë më mirë të tjerët, — u tall me të motrën Agimi.

— Ashtu mendon ti, po, sido që ka bërë ai, unë do t'i shkruaj të më dërgojë disa gjëra të vogla, që të mos i ketë njeri tjetër në bulevardin e Tiranës.

— Çfarë thua kështu, moj bijë? — ndërhyri So-



krati. — Ti ke plot për të veshur e për të mbathur. Eshhtë turp të mendosh kështu.

— E pse qenka turp? — kundërshtoi Shpresa.  
— Mos jam e para unë që bëj kështu?

— Edhe ata që bëjnë, gabim e kanë, — tha Agimi.

— Mirë, mirë. Ti, Agim, je shumë parimor, por kjo është e drejta ime. Të paktën unë kështu mendoj.

Agimi nuk i dha përgjegje së motrës, por u ngrit e shkoi nga dhoma tjetër. Ai donte të studjonte, por nuk mundte.

Nga dhoma tjetër dëgjonte diskutimin e të atit me të motrën dhe i vinte inat me vetëveten. Përse nuk ishte pajisur edhe ai me atë cilësinë e durimit dhe të gjakftohtësisë si babai. Edhe shokët ia kishin vënë në dukje këtë të metë, por ai siç dukej po rritej bashkë me të.

Më në fund zërat nuk u ndjenë më. Babai hyri në dhomën e tij dhe, si i vuri të dy duart në supet e Agimit, i tha:

— Ama, për pedagog që më je. Kur nuk e bind dot kundërshtarin, tërhiqesh nga beteja! Si është puna? Nuk ke argumenta, apo nuk përmbahesh dot.

Agimi u kthye nga i ati dhe u ngrit në këmbë.

— Për fat të keq nuk përmbahem dot, baba. Por edhe ajo ngul këmbë si mushka në ca budallallëqe, që nuk i ngre kandari.

— Ajo me mua diskutoi ndryshe. Dhe e di se ç'kuptova unë: ajo ta di tipin ty dhe do që të të sulmojë. Prandaj ruaju. Dhe tani hajde, se na pret Shpresa t'i bëjmë një përgjegje këtij kushëririt, që na shkaktoi një të çarë të vogël me letrën e tij të parë.

Sokrati u ul në tavolinë dhe, duke pasur dy fëmijët mbi kokë, nisi të shkruante përgjegjen e letërsë së Vasilit. Ata të dy ndiqnin me sy rrugën që bënte stilografi mbi letër, dhe tundnin kokën në shenjë aprovimi.

Pastaj letërkëmbimi u bë një gjë e natyrshme. Ata dalëngadalë filluan të ndjenin një mall të vërtetë për ta parë se çfarë njeriu ishte ky kushëriri i tyre jashtë shtetit. Ai, përveç letrave, nisi të dërgonte edhe pako. Dukej që Vasili ishte një mjeshtër i vërtetë në dërgimin e pakove. Ai sikur e dinte se çfarë i duhej njerit e tjetrit. Edhe Sokrati i dërgonte gjëra simbolike, për të cilat zoti Vasil shkruante se i pëlqenin shumë. Pas gjithë këtyre shkëmbimeve, atyre u erdhi lajmi se kushëriri i tyre do të vinte për një vizitë të shkurtër në Shqipëri. Ata u gëzuan dhe u përgatitën për ta pritur sa më mirë. «Në fund të fundit, — mendonte Sokrati, — ai duhet ta shohë se ç'kemi qenë në gjendje të bëjmë ne këtu, në Shqipëri, për kaq pak vjet».

\*

\* \*

Sokrati e pa aeroplanin që u ul, dhe fiku cigaren në taketuke. Ai u ngrit dhe doli nga lokali. Pasagjerët dilnin një nga një dhe njerëzit që kishin ardhur për t'i pritur, u dilnin përpara. Aty kishte vendas, që prisnin njerëzit e tyre t'u ktheheshin nga shërbimi, diplomatë, që prisnin shokët e tyre, përfaqësues institucionesh, që prisnin specialistë, etj. Njerëzit takoheshin, përqafoheshin, shtrëngonin duart.

Sokrati mundohej të gjente midis tyre Vasilin, sipas përfytyrimit që kishte krijuar nga fotografia e tij. Më në fund e pa. Ai po afrohej me një çantë në një-rën dorë dhe me pallton në dorën tjetër. Sokrati hezitoi pak, pastaj iu afrua:

— Vasil!

Pasagjeri ktheu kokën, hezitoi dhe ai për një moment, pastaj i shpejtoi hapat. U puthën fort, u përgafuan një copë herë dhe shkuan në lokal sa të mbaronin punë me doganën.

— Si jeni me shëndet, si janë fëmijët? — e pyeti Sokrati.

— Mirë, po ju këtej si jeni? Sa i gëzuar që jam, më duket vetja si i ri! Eh, Shqipëri, Shqipëri! — tha zoti Vasil dhe sytë iu mbushën me lot.

— Si e kalove rrugën?

— U lodha ca. S'janë më për ne këto udhëtime; u plakëm.

Sokrati e shikonte me vëmendje. «Jo, nuk duket i plakur, duket burrë i mbajtur. Kur qesh, tregon më i ri», — mendonte ai me vete.

Pastaj zotin Vasil e thirrën në doganë. Ata vendosën bagazhin në taksì dhe u nisën.

Rrugës Vasili kthente kokën sa nga njëra anë, në tjetrën, thuase nuk donte t'i shpëtonte asgjë pa e parë. Në të gjitha anët fusha të mbjella e të sistemuara mirë. Në qytet pallate, rrugë të gjera, njerëz të veshur mirë, të qethur e të gëzuar, fëmijë që vrapojnë e lozin, vitrina dyqanesh të mbushura plot. Zoti Vasil nuk ngopej së pari. «Ja, kjo na qenka Tirana, një qytet evropian, si të gjitha qytetet e tjera!» — mendonte ai. Por, ama, prapa kësaj pamjeje, duhej të fshihej huri e kërbaçi, burgjet e kampet. Këtë ai

e dinte mirë. Për këtë flisnin radiot e gazetat e përrëndimit, flisnin të arratisurit dhe disa nga ata që vinin në Shqipëri për turizëm, ose për vizita. E kush nuk fliste. Dhe vërtet, zoti Vasil nuk mund ta konsideronte të lirë një njeri, që s'kishte të drejtë të hapte një dyqan, që vinte e punonte në një fabrikë, që i thoshin se ishte e tij, por që ai nuk mund të mburrej qoftë edhe me një vidë e të thoshte se i përkiste atij. Këto mendime i ishin ulur këmbëkryq brenda në trutë e tij dhe dukej që ishin të lodhura e nuk kishin ndër mend të ngriheshin kurrë me vullnetin e tyre. Zoti Vasil u largua prej tyre, kur Sokrati i tregoi shtëpinë e tij.

\*

\*   \*   \*

Pas tri-katër ditësh, zoti Vasil doli vetëm nëpër qytet. Ai donte ta shikonte çdo gjë me sytë e tij. Ecte rrugës i qetë. «Të thuash atë që është, — mendonte ai me vete, — këtu duket çdo gjë në vendin e vet. U është dashur një punë kolosale që të arrijnë ata këtu. Po qe se është vetëm Tirana kështu, atëhere nuk është vështirë të bëhet kjo punë, — arësyetonte ai, — por, në qoftë se e gjithë Shqipëria ka ecur në këtë ritëm, bravo u qoftë». Po atij nuk i duheshin shumë këto mendime filozofike. Zaten ai kurrë nuk kishte menduar pse e si ndryshon bota e shoqëria. Për atë, si tregëtar, ishte e domosdoshme të nuhaste momentin, të shikonte punën e bursës. Por këto mendime nuk i ndaheshin. Ç'dreq i kishte hi-

pur kështu! Mos vallë e kishte fajin vetë ambienti shqiptar, që e shtynte në këto mendime. Kur njeriu shikon dy gjëra ndoshta i duhet që t'i krahasojë, të shfaqë mendimin për to.

Kështu mendonte Vasili dhe ecte me duart prapa në rrugën e shtruar me asfalt. Ngandonjëherë e shikonin me vërejtje kalimtarët e ai çuditej: «Mos vallë u bën përshtypje veshja ime? Ç'dreqin vallë u bën përshtypje? Mos më vëzhgojnë?» — i lindi atij një mendim, që e bëri të rrëqetëj dhe nisi të ecte më me kujdes. Nervat nuk i gjenin qetësi. Njerëzit ecnin në punën e tyre, ndërsa ai nuk kishte punë. Për të puna fillonte sonte, ose jo puna, por faza e parë e detyrës së tij.

«Zahoja më kishte thënë se këta janë shumë të varfër, — filloi të mendonte përsëri ai, — ndërsa mua nuk po më duket kështu. Tek Sokrati të paktën jetojnë mirë: kanë një shtëpi të bollshme, të pajisur mirë, vishen dhe ushqehen mirë. Për plaçkat që u solla, vetëm Shpresa u tregua pak entuziaste, ndërsa Agimi më tha një «faleminderit, përse i sollët, ne kemi plot» dhe iku. Se si më duket ai djalë! Më duket sikur më shikon pak shtrembër. Apo nuk ka një shikim që të hyn tej e tej. Po ai tjetri, Koçoja përse s'erdhi të më takonte? Apo nuk e kanë lejuar, se është ushtarak. Mua ma do puna që të takoj ushtarakë e aq më tepër pilotë. Sidoqofë, Sokrati më tha se do të vijë të më takojë. Të shohim një herë se ç'janë këta oficerë».

Zoti Vasil vazhdonte të ecte ngadalë. Kaloi sathatin dhe gjeti kafenenë që i duhej. Nuk u fut brenda, por vetëm u sigurua nga tabela që kishte sipër.

«Ama qen që është ai Gjini, — mendoi Vasili, — ma bëri skicën dhe ja ku e gjeta kafenenë. Po mos vallë këtu ka dy kafene me të njëjtin emër?» — u frikësua ai. Por aty për aty e largoi këtë mendim. «Do dhe pesë ditë që të vijë në këtë kafene. Po atë «Skifterin», si e kanë lajmëruar? Apo banon edhe ai në Tiranë. Eh, ç'punë është edhe ky spiunazhi! Përse nuk merren me tregëti njerëzit dhe ta lenë rehat njëri-tjetrin?»

Pastaj u kthye për në shtëpi.

Kur po u ngjitej shkallëve, dëgjoi dikë që zbrishte. Ngriti sytë dhe pa në fillim një palë këpucë ushtarake, pastaj pantallonat, armën dhe nuk guxoi t'i ngrinte sytë më lart nga frika. Më në fund i ngriti sytë dhe njohu Shpresën.

— Po ti, përse je bërë kështu? — e pyeti fort i çuditur zoti Vasil vajzën.

— Po shkoj në zborin ushtarak, — xha Vasil.

— Të gjithë shkoni në këtë zborin ushtarak? — deshi të dinte ai.

— Nuk e keni dëgjuar atë parullën: «Çdo qytetar ushtar e çdo ushtar qytetar»? — u çudit Shpresa.

— Jo, ku ta dëgjoja unë këtë parullën tuaj?

— Vërtet, keni të drejtë, — i tha Shpresa dhe aty tek shkallët e mbajti gati një çerek ore, duke i shpjeguar kuptimin e këtyre fjalëve. Më në fund ajo i hodhi një sy orës dhe lëshoi një «uh, ç'u vonova», e hodhi automatikun në krah dhe, si e përqafoi xha Vasilin, zbriti shkallët e lehtë si flutur.

Zoti Vasil mbeti aty, tek shkallët, për një kohë të gjatë. Atij thuase nuk i bënë këmbët të ngjitej më lart. «Në goftë se ka arritur puna që të armato-

sen e të stërviten edhe Shpresa me shoqet e saj, — mendonte ai, — atëhere kam frikë se kot mundohen ata andej e kot rrezikoj edhe unë këtu». Atij i shkoi një herë ndër mend që të mos zbatonte asnjë nga detyrat që i ishin ngarkuar, por kujtoi fjalët e Zahos, i cili, para se të ndaheshin, e kishte paralajmëruar se do ta kishte të vështirë po të mos kryente detyrat. Kjo sikur i dha forcë dhe aty për aty i erdhi një mendim: «Mos e kanë përgatitur këta qëllimisht për mua këtë skenë?». Zahoja më ka thënë se këta, për propagandë, janë të vetmit. Ky mendim e qetësoi dhe ngjiti shkallët.

Pas darke, kur fëmijët ranë të flenë, zoti Vasil mbeti vetëm me Sokratin. Ai mendoi se pikërisht tani ishte momenti.

— Sokrat, mos ke ndonjë mik të mirë që merret me fotografi? — e pyeti ai duke e shikuar në bebzën e syrit.

— Jo, nuk kam ndonjë të tillë, — u përgjegj instinktivisht Sokrati. — Po përse e do, nuk më thua?

— Kam këtë fotografi për të zmadhuar, — tha zoti Vasil, duke nxjerrë një fotografi fare lehtë nga xhepi, sepse e kishte përgatitur që më parë.

Sokrati zgjati dorën dhe e pa me vëmendje fotografinë. Atje kishte dalë një njeri në këmbë dhe prapa, në sfond, dukej një shatërvan. Fotografia ishte prerë përgjysmë. Ai u ngrit me rrëmbim dhe hapi një sirtar. Prej andej mori një libër, nga i cili nxori një fotografi të prerë. E bashkoi me fotografinë e zotit Vasil dhe shatërvani doli i plotë. Pra, çdo gjë ishte në rregull.

Zoti Vasil, për çudinë e tij, nuk ndjeu ndonjë keqardhje për gjendjen në të cilën ra Sokrati. Për-

kundrazi, ai ndjeu kënaqësi, sepse këto momente që po kalonte Sokrati, i kishte kaluar edhe ai në zyrën e drejtorit, kur i biri i tij ishte me hekura në duar.

— Zoti Zoi ju bën të fala, po ashtu edhe gjysma e fotografisë suaj, Zahoja.

Sokrati heshte. Ai ishte kredhur në mendime «Ja kë paskan zgjedhur, — mendoj ai me vete. — Bukur e paskan menduar këtë punë horrat».

— Nejse, ti fli sonte, — ia preu mendimet zoti Vasil, — pa kemi kohë kur të bisedojmë. Për sonte mjaft, jam i lodhur.

Ai hoqi xhakëtën dhe filloi të zbrëthente këmi-shën për t'i prerë çdo shpresë Sokratit, në qoftë se donte të diskutonte për ndonjë problem me të. Zoti Vasil, në planin e tij, deri këtu i kishte caktuar kufitë e takimit të parë me agjentin e tij «Vjedhësi i kasafortave».

Sokrati u ngrit me vështirësi dhe, si shqiptoi nëpër dhëmbë një «natën e mirë», doli krejt i dërmuar nga dhoma. Ai hipi në dhomën e fjetjes, u zhvesh dhe u fut në shtrat. Atje vendosi t'i hidhte edhe një sy jetës së tij, megjithëse asnjëri nuk e detyronte ta bënte një gjë të tillë.

Në kohën e Luftës nacionalçlirimtare, Sokrati punonte në xhandarmëri. Ai kishte një punë në administratë dhe i ndihmonte familjes që kishte në fshat. Vetë funksioni i tij nuk e komprometonte shumë në marrëdhënje me popullin dhe për punën e tij ilegale kishin shumë interes. Komunistët ilegale e studjuan mirë Sokratin me sytë dhe veshët që kishin në xhandarmëri dhe, si u bindën për cilësitë



e tij, një ditë e ndaluan në një rrugicë, që nuk binte shumë në sy. Personi që e ndaloi ishte i ri, gati moshatar i Sokratit.

«Dëgjo këtu, Sokrat, — e çeli bisedën djaloshi, — unë jam komunist ilegal. Të drejtohem ty, që nuk të lidh asgjë me pushtuesin dhe i ke akoma duart të pastra. Braktise këtë rrugë dhe hajde me ne, me popullin, me njerëzit e tu».

Sokratit ishte menduar pak dhe i qe përgjegjur:

«Po ç'duhet të bëj. more vëlla, pa më thuaj?»

Tjetri kishte rrudhur pak vetullat dhe i qe përgjegjur:

«Në xhandarmëri mund të bësh mrekullira. Na informo ne, — dhe i tregoi se si duhej të mbanin lidhjet. I dha detyrat e para.

Sokratit iu duk se djaloshi vepronte kuturu, pastaj se si i shkrepri në mendje se ai mund të ishte një provokator i zakonshëm i policisë dhe mendoi për një çast se kishte rënë në kurth. Ai hodhi sytë përreth dhe mundi të shquajë katër djem me duar ndër xhepa, që qëndronin në pozicione të ndryshme dhe i vëzhgonin.

«Këta janë me ty?» — e pyeti Sokrati.

«Po, me mua janë, — qe përgjegjur me çiltërsi djaloshi ilegal. — **Ti e kupton se ne nuk mund t'i bëjmë punët të pamatura.** Apo mos ta kanë mbushur mendjen nacionalistët se ne jemi axhami».

Sokratit ndjeu një farë lehtësimi. Ja, më në fund rrugëdalja që i duhej, u gjet. Tani edhe ai mund të bënte diçka për atdheun e tij. Ai u nda me djalo-shin pasi la takimin tjetër.

Që atë ditë, djaloshi ilegal e regjistroi Sokratin në blokun e tij të vogël me pseudonimin «Trojani».

Sokrati vazhdonte punën dhe kryente detyrat. Ai punonte me një inisiativë, që po e çudiste ilegalin. Në të njëjtën kohë ky ishte vigjilent. I krahasonte dhe i verifikonte të dhënat e «Trojanit» me të dhënat e bashkëpunëtorëve të tjerë. Ai ishte i kënaqur nga puna dhe aftësitë e Sokratit.

Një ditë Sokrati u ndesh ballëpërballë me Zanon, që atë kohë ishte nëntoger.

— Nga vete e zhdokesh, mor pëllumb, që nuk të shoh fare? — e kishte ngacmuar Zahoja. — Apo ke gjetur ndonjë thëllëzë.

— Çfarë thëllëze do gjej, — ishte tallur Sokrati. — E ku vijnë thëllëzat tek korbat!

Zahoja kishte qeshur me të madhe.

Në një nga takimet, ilegali i kishte dhënë një çelës Sokratit:

— Sokrat, kjo është detyra jote e fundit. Ky çelës është i kasafortës së komandantit. Merr gjithshka që të gjesh atje dhe detyra jote merr fund. Pastaj do largohesh në çetë. Kam një të dhënë të vogël se ai qeni, Zahoja, të është qepur prapa.

Sokrati e kuptonte që kjo ishte detyrë e vështirë, por ishte e domosdoshme. Prandaj ai nuk mund të kundërshtonte. Duhej rrezikuar.

Natën ai hyri në zyrën e komandantit dhe iu afrua kasafortës. Në momentin që ai kishte futur gjithshka në çantë, hyri Zahoja së bashku me një major.

— Po ti, o pëllumb, nuk e dije që në kasafortë funksiononte një mjet sinjalizimi, — i tha Zahoja dhe, kur pa dorën e Sokratit që po rrëshqiste drejt xhepit të pantallonave, ngriti automatikun lart:

— Mos lëviz, se të bëra shoshë.

Sokrati ngriti duart. Ishte zënë ngushtë. Atë mund ta vrisnin ose mund ta arrestonin dhe shokët nuk do të merrnin vesh asgjë. Ofceri i huaj u afrua, e çarmatosj dhe i tha të ulej. Derën e mbyllën me çelës. Pastaj ai nxori nga sirtari një copë letër dhe i zgjati Sokratit stilografin.

— Shkruaj gjithshka që do t'ju diktoj, — i tha ai në gjuhën e tij dhe Zahoja ia përktheu.

Sokrati mori stilografin. Ai kërkonte me çdo kusht një rrugëdalje. Me duart që i dridheshin, shkroi ato që i thanë. Ai zotohej me shkrim se do t'i shërbente me besnikëri zbulimit dhe se do të ishte armik i egër i komunizmit, deri në vdekje.

Si mbaroi së shkruari Sokrati, majori i mori shenjën e gishtit tregues dhe nënshkrimin.

— Si mendoni, — e pyeti ai pastaj, — pranon më mirë këtë, apo më mirë një përpunim të shkallës së tretë në birucat tona dhe litarin?

Majori kishte idera. I kërkoi Zahos një fotografi çfarëdo dhe, si e preu më dysh, i dha gjysmën Sokratit, ndërsa gjysmën tjetër e bashkoi me deklaratën e Sokratit.

Ata biseduan për një kohë të gjatë dhe së fundi përgatitën planin e «arratisjes» së Sokratit, si dhe një numër dokumentash të falsifikuara për dizinformacion.

«Tani ikë. Ne do të qëllojmë, do të organizojmë ndjekjen dhe, që ta marrin vesh atje ku duhet, do të hapim fjalën se ti vodhe dokumentat dhe shpëtove për një qime. Shko drejt e në mal dhe bëhu partizan.

Sokrati u ngrit dhe doli jashtë. Prej andej ai u nis për nga dalja. Trupi i ishte bërë kallkan. Mos do

ta qëllonin prapa krahëve për t'u lavdëruar për vrasjen e një tradhëtari? Ai eci ashtu me gjak të ngri-rë dhe, si e ndjeu veten jashtë rrezikut, ia dha vrapit. Prapa tij u dëgjua një breshëri automatiku dhe pas saj të shtëna pushke. Sokrati nuk vajti atje ku kishte lënë takimin me shokun e tij ilegal. Ai u end një copë herë dhe, si u bind që nuk e ndiqte njeri, shkoi në një bazë tjetër. Prej andej e lajmëruan illegalin dhe ata u takuan. Sokrati i tregoi gjithshka. Ishte e qartë se atë e kishin rekrutuar me qëllime të caktuara, donin ta ruanin për ta përdorur më vonë.

Djaloshi ilegal i mori të gjitha me shkrim dhe e nisi Sokratin për në mal. Pastaj ai njoftoi në rrugë tjetër zëvendëskomisararin e brigadës ku shkoi Sokrati, dhe e konsideroi të përfunduar detyrën e tij.

Po ata u takuan përsëri pas çlirimit. Ata u takuan ballëpërballë në Tiranë dhe u përqaftuan fort, si dy shokë të vjetër.

— Ku punon tani? — e pyeti Sokrati Nuriun, si u shmallën.

— Në sigurim, — u përgjegj Nuriu duke qeshur. — Siç duket, fati im u përcaktua që në luftë. Po ty, akoma nuk të kanë shqetësuar?

— Jo, ndryshe do ju kisha lajmëruar me kohë.

Sa herë që e takonte Nuriun, që tani punonte në ministri, Sokrati i tundte kokën në shenjë mohimi.

— Akoma je në pritje? — e pyeste ai.

— Po, s'më kanë ngacmuar. Po që se vijnë, do t'ua nxjerr nga hundët këtë pritje të gjatë.

Të gjitha këto Sokrati i kujtoi atje në krevat, pas bisedës me kushëririn e tij, Vasilin, dhe i erdhi

inat që ata të dy, që ishin gjak me njëri-tjetrin, i kishin vënë ballëpërballë. Për pozitën e tij ai ishte i qartë, por ndjeu keqardhje për pozitën që kishte zënë Vasili, dhe i erdhi turp për të.

\*  
\* \* \*

Në zyrën e drejtorit të Sigurimit të Shtetit kishin zënë vend tre oficerë. Nuriu ishte në këmbë. Ai raportonte për të dhënë e fundit.

— Qëllimi i zotit Vasil, me sa kemi mundur të kuptojmë, është aktivizimi i agjenturës së vjetër. Zoti Vasil e ka pyetur Sokratin për disa persona që punojnë në qytete të ndryshme. Një pjesë të detyrave do t'ia ngarkojë Sokratit, tek i cili, siç duket, ka besimin e duhur. Sokrati raporton midis të tjerash se zotit Vasil i interesojnë edhe të dhëna me karakter ushtarak. Është interesuar veçanërisht për Kìçon, djalin e Sokratit, i cili është inxhinier avionash.

Me sa ka kuptuar Sokrati, qëllimi është që ata të organizohen, të gjallërohen e të zgjerojnë rrjetin e tyre me elementë të tjerë, të mbledhin informata e të qëndrojnë gati për një ditë të bardhë, siç është shprehur zoti Vasil.

— Mirë, — tha drejtori. — Le ta lemë të mbarojë punën e tij zoti Vasil dhe pastaj të fillojmë ne. Por për këtë duhet të dimë me saktësi dhe të dokumentojmë çdo hap të tij. Ja, për këto gjëra ju thirra, që t'i diskutojmë bashkërisht.

Zoti Vasil pa orën e dorës. Donte edhe dhjetë minuta që të vinte koha e takimit. Ai ndaloi përpara një vitrine dhe la të kalonin njerëzit që ishin prapa tij. Si u bind se nuk e ndiqte njeri, u kthye dhe hyri në kafene. U ul në një tavolinë të lirë dhe ndezi cigaren. Kamerieria iu afrua dhe, duke qëndruar gjithë respekt përpara tij, e pyeti se çfarë dëshironte.

— Kafe dhe sifon, — porositi zoti Vasil dhe vazhdoi të thithte cigaren. E hoqi xhaketën dhe e vuri mbi karrige, pastaj përveshi pak mëngët e këmishës. Duke pritur kafënë, ai u hodhi një sy klientëve që ishin brenda. Në këtë orë, kafeneja nuk frekuentohet shumë. Larg tij, në një qoshe, kishte zënë vend një djalë e një vajzë dhe dukeshin kaq të thelluar në çështjet e tyre, sa që dukej sikur asgjë nuk ekzistonte përveç tyre. Më tutje ishte ulur përpara një filxhani kafeje të zbratur një plak i vjetër me syze mbi hundë. Plaku ishte thelluar në leximin e gazetës. Pas pak hyri brenda një mesoburrë, me xhaketë të hedhur krahëve dhe zuri një tavolinë në qoshen tjetër, ballëpërballë me zotin Vasil. Ata shkëmbyen nga një shikim. Ai tjetri i hoqi sytë për një çast, por pastaj i ngriti prapë dhe u përqëndrua tek unaza që mbante në dorë zoti Vasil. Me të vërtetë unaza e tij dukej provokuese ashtu e madhe dhe me gur të kuq.

Ai burri nxori kutinë e duhanit dhe deshi ta dridhte një herë, por, kur ngriti dorën për t'i bërë shenjë kamerieres, kutia iu rrëzua përdhe dhe duhani u shpërnda nëpër dysheme.

— U bëfsh farmak, u bëfsh, — u nxeh ai dhe u ul ta mblidhte.

Pastaj e futi kutinë brenda dhe nxori çakmakun, por për dreq dhe ai nuk po i ndizte. Më në fund atij iu sos durimi, e futi çakmakun në xhep dhe iu drejtua kamerieres:

— Më bjerë kafënë, moj shoqe, dhe një shkrepse.

Zoti Vasil i ndiqte me kujdes lëvizjet e tij. Atij, porsa hyri ai mesoburri, iu duk fytyrë e njohur. Këtë tip e kishte parë në ato dhjetëra fotografi që ia kishte vënë Zoi përpara atje në vilë. Në ato fotografi ishte në poza të ndryshme: ballas, profil, duke ecur, në grup, duke pirë cigare, duke ngritur gotën, etj. Po sikur të gabohej? Sa vetë ngjajnë me njëritjetrin në këtë botë! Zoti Vasil u tremb nga ky mendim. Po sikur në vend që t'i drejtohej «Skifterit», t'i dilte papritur një person tjetër? Atëhere patjetër do ta merrte lumi tërë punën. Por jo, jo. Zoti Vasil nuk mund të gabohej. Ai që rrinte atje, në tavolinë, s'ishte veçse «Skifteri», pa çka se e shikoi vetëm një herë zotin Vasil dhe tani dukej se ishte kredhur në hallet e tij me atë filxhanin e kafesë përpara.

Nga ana tjetër edhe Bexheti e njohu të dërguarin e qendrës: ora në dorën e djathtë, xhaketa e hequr dhe unaza e Zoit në gishtin e vogël. Ai piu kafënë dhe doli jashtë. Kontakti u vendos, por takimi, sipas rregullit, do të bëhej tri orë më vonë, në një vend tjetër. E gjithë kjo histori ishte kurdisur nga shefat në mënyrë të tillë, që të mënjanohesh në çdo mënyrë zbulimi nga kundërshtari.

Pas tij doli dhe zoti Vasil e pas Vasilit edhe ai çifti i ri i studentëve që, si duket, i thanë ç'kishin për të thënë e tani nxitonin për në leksionet. Në ka-

fene mbeti vetëm plaku me syze mbi hundë, që kish-te arritur në faqen e katërt të gazetës.

Pas tri orësh, zoti Vasil ecte për tek vendi i takimit me «Skifterin». Ai nuk mund ta përmbante ndjenjën e frikës që e kishte pushtuar. U afrua tek vendi i errët dhe i zgjati dorën Bexhetit që e priste aty.

— U sigurove se nuk të ndjek njeri? — e pyeti zoti Vasil tërë ankth.

— Mos u bëj merak. Asnjeri nuk na ndjek.

— Si venë punët e tua?

— Ja, kisha mbetur si peshku pa ujë. Megjithatë, diçka kemi bërë.

— Sa vetë ke me vete?

— Ishim gjithsej shtatë, por një hyri në burg për vjedhje, ndërsa një tjetër e eliminuam vetë.

— Pse e eliminuat? — u çudit Vasili.

— Sepse na rrezikonte. Atë e thirrën në degë dhe e pyetën për një çështje, që mund të na merrte në qafë.

— Porosia është të grumbulloni forcat. Rëkrutoni sa më shumë dhe i lini në gatishmëri. Situatatani po kthehet në favorin tonë. Besojmë të ketë ndërhyrje, veçanërisht tani, që këta mbetën si peshku pa ujë. Vini dorë mbi këdo që është i pakënaqur, — tha Vasili si të ishte një vjershë që e kishte mësuar përmendsh.

— Nuk është aq e lehtë, zotni, — u ankua «Skifteri». — Ja, kam një kandidat të përshtatshëm, që ka lidhje mjaft të mira e është invalid në punë. Me të kam shkuar thellë, por më duket se s'është i vendosur. Një, dy e më përmend fëmijët e gruan.

— Këtej e tutje lidhjet do t'i mbash me agjen-



tin tonë «Vjedhësi i kasafortave», këtu ke parullën dhe paratë. Ndaji proporcionalisht. Jepi dhe atij që ke filluar të punosh me të. — Këtu zoti Vasil ra në terrenin e tij si tregëtar. — Paraja e kthen lumin përpjetë. Të gjitha informatat që do të grumbullosh, do t'ia japësh «Vjedhësit të kasafortave». Takimet i keni në datë një, ora një të çdo muaji. Merre këtë pako. Këtu ka kallëpe sapuni. Brenda në to do të gjesh disa ampula me helm dhe një aparat fotografik të vogël. Instruksionet për përdorim i ke brenda, të përkthyer shqip. Dhe tani dëgjo me vëmendje. Një nga porositë më të rëndësishme është kjo, — dhe i zgjati Bexhetit një pako, — Këtë do t'ia japësh së shoqes së Qazim Belulit, e ka nga i shoqi. Brenda ke para dhe një letër. Mënyrën se si do t'ia japësh e si do ta justifikosh përpara saj gjeje vetë, por porosia është t'ia japësh sa më parë. Kjo ka të bëjë me vetë ekzistencën e grupit tuaj. Me këtë rast, të njoftoj se qendra të përgëzon për këtë çështje, sepse ke vepruar me inisiativë, kuptove?

— Kuptova, — u përgjegj Bexheti, i lehtësuar, se kjo plagë e Qazimit më në fund do të mbyllej. Për këtë mendonin tashmë edhe ata të qendrës. — Dhe tani merre këtë, — i tha zotit Vasil, duke i zgjatur një pako. — Këtu ke një grumbull informatash, që kam mbledhur për gjithë situatën. Janë shkruar me bojë simpatike, që e dinë vetëm ata të qendrës, në radhët e një libri që flet për politikë. Le t'i analizojnë e t'i vlerësojnë.

Vasili e mori dhe e futi në xhepin e brendshëm të xhaketës.

— Ke gjë tjetër.

— Desha të pyes, si është zoti Zoi?

— Eshtë shumë mirë, të bën shumë të fala.

— Edhe ti bëji shumë të fala. Kemi miqësi të vjetër me të... Shpresoj të takohem edhe një herë. Unë kam besim, dhe ky besim më ka mbajtur në këmbë.

I dhanë dorën njëri-tjetrit dhe u larguan në drejtime të ndryshme.

Tek po kthehej në shtëpi, zoti Vasil mendonte për këtë takim. Kishte shkuar çdo gjë në rregull. Ai ndjeu kënaqësinë e punës, që i zuri vendin ndjenjës së frikës, dhe kërciti gjuhën. Sonte për herë të parë, pas kaq ditësh, ai kujtoi gruan dhe fëmijët që i kishte lënë tutje, tej kufirit.

\*  
\*   \*  
\*

Aliu u paraqit në zyrën e Nuriut.

— E, djalosh, si i ke punët? — e pyeti Nuriu, me të cilin kishte punuar këto dy-tri ditë.

— Mua më duhet të iki. Tani nuk kam më punë këtu.

— Mirë, mor pëllumb. Fluturo pas «Skifterit» tënd, po kujdes nga ai, — bëri shaka Nuriu. — Jepi të fala kryetarit tënd dhe thuaji të mos ju mbajë të gjithëve atje, se ka mbledhur rreth vetes gjithë gardën e re. Le t'ju dërgojë disave këtu, në qendër.

Aliu qeshi, u përshëndet me të dhe u largua.

Nuriu nxori dosjen dhe nisi të sistemonte të dhënat e fundit, që t'i kishte gati për tek drejtori. Ai i hodhi një sy orës dhe nisi të studjonte. Nuk e kuptoi

si kaloj aq shpejt ora, kur dëgjoi zilen e telefonit. E kërkonte drejtori. Ai u nis për në zyrën e tij.

— Na thuaj ç'kemi nga ti, — e filloi bisedën drejtori.

— Zoti Vasil realizoi takimin e tretë dhe çdo gjë shkoi në rregull. Tani së fundi kemi një të dhënë se ai realizoi një takim me të quajturin Sabri Lini, ish oficer i ushtrisë së vjetër. Edhe atë e ka vënë në lidhje me «Vjedhësin e kasafortave». Pas tri ditësh, zotit Vasil i mbaron afati dhe do të largohet nga vendi ynë.

— Pa i hyrë asnjë gjemb në këmbë? — e ndërpreu drejtori.

— Ja, këtë desha t'ju them. Tashmë ai e ka konsumuar figurën e krimin. Ne kemi zbuluar lidhjet e tij dhe disponojmë materiale të mjaftueshme për ta goditur. E rëndësishme është që ne kemi tashmë lidhjet e vjetra që aktivizoi tani zbulimi i huaj. Por unë mendoj që ne të organizojmë një takim me Vasilin, në mënyrë që edhe ai të mund ta kuptojë dështimin e tij dhe të padronëve, edhe ne të mund të sqarojmë disa pika të errëta.

Drejtori ra dakord. Ata punuan dy orë duke përpiluar një plan bisede e duke nxjerrë çështjet që do të diskutonin. Më në fund, me materialet në duar, drejtori u nis për t'i raportuar udhëheqjes.

Pas një ore ai e mori në telefon Nuriun.

— Plani u aprovua. Na përgatit takimin në shtëpinë e Sokratit. Kuptohet që, gjatë kësaj kohe, nuk duhet të ketë tjetër njeri veç nesh atje.

Nuriu shqiptoi «siurdhëron» dhe e mbylli telefonin. Pastaj nxori shaminë dhe fshiu ballin e djer-

situr. «E vlen ta bësh një takim të tillë me të», — mendoi ai dhe u nis për tek Sokrati.

Të nesërmen, dy veta trokitën në shtëpinë e Sokratis. Ata patën një bisedë të gjatë dhe në fillim aspak të këndshme me zotin Vasil. Por më vonë biseda u ngroh kaq tepër, sa që zoti Vasil e pati të vështirë të ndahej prej tyre. Kur dolën nga shtëpia, Nuriu shtrëngonte fort nën sqetull çantën e tij të zezë dhe qeshte duke sjellë ndër mend fragmente nga biseda. Ndërsa drejtori ecte i menduar. Ata i arriti maqina dhe, si zunë vend në të, u nisën për në ministri.

\*  
\* \*

Bexhetin e lodhte shumë udhëtimi me maqinë. Ai ishte mbështetur në ndenjësë dhe, nga lëkundjet e tepërta, po i mbylleshin sytë. Rruga kishte disa gropa të hapura nga maqineritë e rënda, që transportoheshin për ngritjen e një uzine të re, dhe ai u zgjua.

Mendonte për takimin e tij me zotin Vasil dhe pastaj u ndal tek Zoi. Iu kujtua takimi i parë me të. Ai kishte lënë, si zakonisht, një pikëpjekje me bandën e Zahos, që asikohe qarkullonte në ato anë dhe, pasi që nisur nga puna për të vajtur në shtëpinë e tij në fshat, kishte marrë monopatin për të vajtur në afërsi të shpellës, ku ishte strehuar banda. Rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme. Zahoja i kishte dalë përpara, sepse nuk mund ta takonte në prani të shoqëve agjentin e tij më të çmuar. Pasi këmbyen fja-

lët e para, Zahoja i kërkoi zbatimin e detyrave të ngarkuara. Bexheti raportoi rrjedhshëm. Pastaj Zahoja i ngarkoi detyrat e reja, duke ia ndarë për secilin anëtar të grupit. Atij s'i rrihej pa hyrë edhe në detajet më të vogla. Më në fund i dha një grusht monedha ari.

«Ndaji me të tjerët», — i tha ai duke i bërë një shenjë, që të kuptonte bashkëfolësi se pjesën më të madhe duhej ta mbante për vete.

Bexheti, edhe pa porosinë e tij, kështu do të vepronte. Ai e dinte që edhe Zahoja kishte mbajtur pjesën e tij. Bile Bexheti e merrte me mend se edhe ai që ia kishte dhënë Zahos, kishte mbajtur pjesën e tij.

«Kështu do të bëj», — i tha Bexheti dhe i futi paratë në xhep.

«Nesër ti ke pushim dhe nuk do të ishte keq që të vije me mua. Në kufi na pret një oficer i lartë, eprrori im, i cili do të njihet me ty nga afër».

Bexheti, megjithëse kishte frikë si dreqi nga kalimi i kufirit, ra dakord. Kureshtja e shtynte ta njihet këtë oficer, për të cilin punonte Zahoja e ai vetë.

E kishin kaluar kufirin me frikë në zemër. Ja edhe ai oficeri, që i kishte thënë Zahoja se do të takonin. I gjatë, i pashëm, i veshur me një kostum gjuetie gati të papërdorur, me flokë të zinj, që sapo kishin filluar t'i thinjeshin. Bexhetit i pëlqyen sytë e tij të zinj, që kishin një shikim të butë, përkëdhelës dhe duart e tij të bardha, të holla e të mbajtura mirë. Nuk iu duk më tepër se tridhjetë e pesë vjeç.

Ata hëngrën, pinë, dolën në fotografi dhe shkëmbyen mendime për organizimin e punës. Bexheti vuri re se Zoi ishte shumë i informuar për Shqipë-

rinë dhe e ndihmoi edhe atë me mendimet e tij për të parë më qartë perspektivën. Bexheti pinte nga ato cigaret e tyre dhe nuk i shijonin, megjithëse Zahoja thoshte se ato ishin të mrekullueshme. Pastaj ata u ndanë. Bexheti u largua andej me përshlypjen se kishte bërë një kurë të mirë, që ja kishte përtërirë forcat. I kujtoheshin fjalët që i kishte thënë oficer Zoi kur u ndanë: «Siç e sheh, këtyre me pushkë nuk u dilet dot; pra, detyra jote është që të punosh mirë dhe të mos komprometohesh. Sa më shumë shkallë të ngjitesh në detyrat e tyre, aq më i vlefshëm do të jesh. Në këtë mënyrë ne do t'i brejmë nga brenda, si ai krimbi bimën, dhe ata do të thahen. Pastaj do të vijë prapë koha jonë, jotja, e Zahos dhe e qindra shqiptarëve të tjerë, që ndodhen larg vatrave të tyre».

«Ah, sikur t'i kisha mbajtur mirë para sysh këto këshilla! — mendonte Bexheti. — Kushedi ku do isha. E vërteta është se më morën me sy shumë të mirë, por unë budallai u nxitova, duke marrë nën mbrojtje kulakët. Nuk e frenova dot urrejtjen që kisha për ta dhe ja, tani vjen një barkalec që andej, më merr në lidhje, më jep detyra. E jo vetëm kaq, por të jep në lidhje të një tjetri. Se ç'dreq do jetë ky tjetri, nuk dihet. Nejse, unë do të bëj detyrën, qoftë edhe sikur të më lidhin edhe me vetë djallin, vetëm të marrë fund kjo farë e keqe. Po i erdhi fundi, e di unë vetë si do hakmerrem», — mendoi ai duke lëvizur kokën.

— Ç'ke që e luan kokën ashtu? — e pyeti shoferi, që plasi e nuk ndërroi dot dy fjalë me këtë pasagjer. Ta dinte kështu, ai nuk e merrte fare në maqinë.

— Më është bërë zakon të mendoj me vete, —  
i tha Bexheti, që u frikësua dhe nxori kutinë e duhanit. — Do të të bëj një të fortë?

— Dridhe, — tha shoferi dhe filloi t'i tregonte për gjyshen e tij, e cila e kishte zakon t'i bënte llogaritë me zë të lartë kur ecte rrugës.

\*  
\*   \*  
\*

— Ç'mendim ke për të gjithë këta?

Isai hezitoi pak dhe më në fund u përgjegj:

— Të të them të drejtën, Bexhet, ti flet shumë bukur dhe m'u duk se ma vizatove të ardhmen me ngjyra shumë të qarta. Po nuk më thua, a ka rreziqe kjo punë?

Bexheti tashmë e kuptoi që Isai po thyhej përfundimisht dhe, siç duket, donte të merreshin vesh për kushtet. Tani ai, si profesionist dhe në të njëjtën kohë si përgjegjës, do t'i jepte këtij fillestari mësimin e tij të parë mbi jetën e re të spiunit.

— Gjëja më e rëndësishme është të mbash veten dhe të mbyllësh gojën, të mësosh të përdorësh si duhet e ku duhet buzëqeshjen dhe thikën. Për këto ti mos u bëj merak, ne nuk jemi vetëm, ne kemi plot shokë që do të na ndihmojnë.

— Po mirë, çfarë detyre do të kem unë? — kërkoi të dinte Isai.

— Hëpërhë ti hyrë në valle. Detyra jote e parë është të ruash konspiracionin dhe të qëndrosh gati në sinjalin që do të jepet.

— Për çfarë sinjali bëhet fjalë? — e ndërpreu Isai.

— Mos më ndërpre. Veç kësaj, ti do të kesh si detyrë që të shtosh rrjetin me njerëz të tjerë të besuar e të përshtatshëm për punën tonë. Prandaj fillo të mendosh mirë për ta. Ja, ashtu si veprova unë me ty. Për paratë mos u bëj merak, se na furnizojnë mirë. Puna është të dimë të kapim persona të përshtatshëm. Na interesojnë të gjithë, por veçanërisht ata që kanë baza të forta në këtë pushtet, që gëzojnë besimin. Ti ke disa lidhje mjaft të mira me njerëz të tillë, se ty nuk të largohen njerëzit, siç më largohen mua. Dhe tani për pyetjen që më bëre: po jetojmë kohëra të stuhishme, gjendja në botë ka ndryshuar shumë dhe këta kanë mbetur vetëm. Ndërhyrje do të ketë dhe këtë ta them unë me siguri.

— Çfarë sigurie ka në këtë mes? Ja, unë di një njeri që u dënua për spiunazh. Atë e kishin rekrutuar në moshën tridhjetëvjeçare dhe ai mbushi të gjashtëdhjetat e gjendja nuk ndryshoi. Unë për vete nuk kam asnjë dëshirë të mbaj qefinin me vete tridhjetë vjet rrjesht.

— Leri budallallëqet. Kjo është fantazi e njerëzve. Për ndërhyrje të jesh i sigurt. Por për këtë duhet punë, që, kur të vijë dita e madhe, të mos na vijë turp t'i shikojmë njerëzit në sy.

Në tonin e Bexhetit u ndjenë nota vrazhdësie dhe Isai e vuri re mirë këtë.

— Mirë, ne po diskutojmë, ti mos u nxeh. Vetëm dua të merremi vesh për një gjë: po qe puna për t'u arratisur, ose për të kaluar kufirin, mua nuk më ke me vete.

— Ç'është gjithë kjo frikë për këtë punë? Po të thanë të arratisesh, duhet të arratisesh. Detyra nuk mund të kuptohet ndryshe.



— Jo. mua më dhimbet familja. Do ma internojnë dhe ç'faj kanë ata të vuajnë për mua. E di ç'ndodhi me Qazim Belulin? Kishte goxha emër dhe mund të punonte fare mirë këtu brenda, kur fësht ja bëri dhe u arratis. E shoqja vuan pikën e dreqit. E përse? Për një budallallëk.

Bexheti nuk i dha përgjegje. T'ia thoshte këtij të vërtetën mbi Qazimin? Edhe humbiste, edhe fitonte. Humbiste një sekret të rëndësishëm, por, ama fitonte këtë njeri dhe në të njëjtën kohë i jepte të kuptonte se, po të futeshe në këtë punë, nuk dilje dot aq kollaj. Ai shikoi një herë përreth, nxori kutinë e duhanit dhe drodhi dy cigare. Kur po ja ndizte Isait, shikimet e tyre u kryqëzuan. Të dy kishin shikime të forta, depërtuese.

— Dëgjo, por harroje sa ta dëgjosh: Qazimi nuk është arratisur.

Isai lëshoi një klithmë habie.

— Si?! Si është e mundur kjo?

— Mos i hap sytë si budalla. Puna jote këtej e tutje do të ketë plot të papritura të tilla, prandaj duhet ta mbash veten. Pra, Qazimi nuk u arratis. Atë e likuiduam në bashkëpunim me diversantët. Në fillim deshëm ta bënim për vete, sepse ai kishte rënë në gjurmët tona dhe se kishim shumë interes për një njeri si ai. Por ai nuk u bind dhe ne e zhdukëm. Për të mbuluar gjurmët, u arratisën dhe dy të tjerë e bashkë me ta, veshur me këpucët e Qazimit, ka-loi edhe njëri nga diversantët e bandës. Për ta mbuluar këtë, ne hapëm fjalën se ai u arratis. Kishim dhe një qëllim tjetër kur hapëm fjalën se u arratis: duke qenë se ai ishte komunist, ne lëkundnim besimin tek njerëzit, i bënim njerëzit të mendoheshin mirë.

Isai qëndroi si i shastisur për një moment, pastaj buzëqeshi si fajtor dhe i tha Bexhetit:

— Ja ç'na qenka! Kurse unë dhe plot të tjerë si unë paskemi qenë budallenj. Thuaj si të duash, por këtë e keni kurdisur shumë hollë.

Bexhetit do t'i pëlqente që ta vazhdonte akoma bisedën, bile atij i dukej se edhe Isait ia kishte qejfi një gjë të tillë, por për sot e quajti të mjaftueshme. Edhe një u shtua në radhët e tij. Ai kishte për se të raportonte. Ata u ndanë.

Bexheti e ndjente veten të lehtë dhe gjoksi i dukej më i gjerë, më i plotë e i gatshëm për të përballuar çdo furtunë, çdo dallgë. Ai kishte mundur të merrte një grumbull të dhënash nga Isai dhe tani e lidhi përfundimisht pas vetes.

Por edhe Isai kishte se ç'të raportonte. Kur Gëzimi me Luanin bënin planin se si të kishin në tavolinën e tyre gjithshka që fliste dhe mendonte Bexheti, veç të tjerash, e bazonin punën e tyre edhe në inteligjencën, ndershmërinë e patriotizmin e Isait, i cili tashmë kishte depërtuar në strofkën e armikut dhe që andej mund të jepte të dhëna të vlefshme për demaskimin dhe shpartallimin e tij.

\*

\* \*

Bexheti zbriti nga treni dhe i hodhi një sy orës së stacionit. Kishte në dispozicion dhe tri orë që të takohej me shefin e tij të ri, «Vjedhësin e kasafortave». Nuk e kishte parë asnjëherë turirin e këtij njeriu, por e urdhëruan të bashkëpunonte me të dhe ai

nuk mund të mos e zbatonte urdhërin. Bexheti e kishte vënë në plan që, qysh në takimin e parë, të ndikonte mbi të sa më shumë dhe ta nënshtronte. Kujtoi dhe një herë parullën e kundërparullën e u nis të zinte hotel.

Në orën trembëdhjetë ai u ndodh tek stacioni i autobuzit. Ndezi një cigare dhe ndenji në pritje. Përpara tij u ndal një burrë me gazetën «Bashkimi» në dorë. Ai e palosi atë dhe deshi ta vinte në xhepin e djathtë.

— Më lejoni t'i hedh një sy? — i tha me zë të sigurt Bexheti.

Tjetri i zgjati gazetën dhe i tha:

— Veçse unë do të shkoj me autobuzin e kësaj linje.

— Edhe unë këtu do të hipi, shkoj në spital, se kam operuar vajzën.

— Hallin e paskemi njëloj. Dhe unë shkoj tek një i sëmurë.

Pasi shkëmbyen këto fjalë, ata heshtën.

Bexheti filloi t'i hidhte një sy gazetës, derisa erdhi autobuzi. Ata hipën të dy dhe zbritën tek spitali. Ecnin krah për krah.

Në autobus, Bexheti pati kohë ta vëzhgonte mirë shefin e tij. Ai ishte i gjatë dhe i mbushur. Në kokë mbante një kasketë të prerë nga e njëjta copë që kishte edhe kostumin. Ishte syzi, me hundë të drejtë e pak të gjerë, me një mjekër të dalë përpara e me buzë të holla, të puthitura fort. Duart e tij leshatore iu dukën veçanërisht të fuqishme Bexhetit. Pamja e tij e jashtme të ngjallte besim.

— Ç'kemi andej nga ti, — e hapi bisedën shefi.  
— Ç'bëre me atë që kishe në dorë.

Bexheti e kuptoi: i dërguari nga qendra e kishte vënë në dijeni për gjithshka dhe nisi të tregojë për Isain.

Tjetri e dëgjonte me kujdes dhe më në fund i tha:

— Ki kujdes nga ndonjë provokator, ruaju mirë, se pikërisht kur ti mendon se e fitove davanë e gjithshka shkon mirë, atëhere vjen dhe disfata. Mos u deh nga sukcesi, vëzhgoje mirë dhe në fillim mos i trego asgjë nga puna që bën ti dhe shokët. Për të tani ka vetëm detyra. Kjo duhet për ta lidhur sa më shumë pas vetes.

Bexheti tundi kokën në shenjë aprovimi. Ai u pendua për vendimin që kishte marrë sa zbriti nga treni. Ky që kishte përpara, të impononte respekt. Atij po i vinte mirë që kishte marrëdhënie pune me një njeri të tillë.

— Këto që më thatë i kam mirë para sysh, — tha Bexheti. — mos u bëni merak. Ju ndoshta nuk më njihni mirë, por unë kam kryer edhe detyra të tjera më delikate; kam kohë që punoj.

— Jam në dijeni për gjithshka, — e ndërpreu tjetri. — Tani më jep emrat e atyre që ke në lidhje dhe perspektivën e secilit.

Bexheti filloi të raportonte hollësisht.

— A ka secili një armë në dispozicion.

— Po, secili është i pajisur, — u përgjegj Bexheti.

— Në të ardhmen mund t'u ngarkohet një detyrë terrori. Armët duhet t'i kenë të pastra. I ruani me kujdes. Dhe tani dëgjomë mirë. Njerëzit të mbahen në gatishmëri, secili të punojë mirë në qendrën e tij të punës dhe të dëgjojë me veshët ngritur gjithshka flasin njerëzit, gjithshka, qoftë edhe gjërat e parëndësishme. Të gjitha ato do t'i grumbullosh, do

t'i sistemosh dhe do të m'i biesh mua. Puno me më të besuarit, që të krijojmë një ide të plotë mbi dislokimin e gjithë forcave në rrethin tuaj, veçanërisht në kufi. Kjo është detyra jote më e rëndësishme. Këto, pasi t'i përpunoj edhe me të dhënat që marr nga rrethet e tjera, do t'i dërgoj jashtë, sepse kanë shumë interes për to në këtë situatë.

— Si do t'i nxjerrësh jashtë? — e pyeti Bexheti.  
Tjetri e shikoi me vrazhdësi.

— Ju thatë se jeni i vjetër dhe e njihni mirë zatin, por po bini brenda. — Pastaj ai deshi ta zbusë pak efektin e këtyre fjalëve dhe i futi krahun. — Nejse, ti nuk pyete me ndonjë qëllim, por kurioziteti i tepërt në punën tonë është i dëmshëm. Mos e ler këtë të metë të shfaqet tek vartësit e tu. Ke sjellë gjë të shkruar me vete.

— Po. — u përgjegj Bexheti, që qëndronte si ndonjë nxënës i bindur dhe i dha disa fletë letre.

Ata u muarën vesh për parullën, për vendin e ri të takimit dhe u ndanë.

\*

\* \*

Maqina ndaloi afër një ndërtese dhe prej andej zbritën tre veta, të cilët iu ngjitën shkallëve. Ata arritën në katin e dytë dhe u futën brenda, sepse dera e dhomës nuk ishte mbyllur me çelës. Dhoma mbante një erë djerse, të përzier me erën e duhanit. Gëzimi u drejtua tek krevati, ku ishte shtrirë një person dhe e zbuloi.

— Bexhet, ngrehu, erdhi koha.

Ai që flinte, tha diçka nëpër dhëmbë dhe u kthye

në krahun tjetër. Por Gëzimi nuk e la.

— Ngrehu, pra, erdhi koha të shkojmë.

Bexheti u ngrit ndenjtur dhe fërkoj sytë.

— Kush jeni ju? — tha ai për të përmbledhur pak veten.

— Vmë nga dega e punëve të brendshme. Ngrehu dhe hajde me ne.

— E përse, përse duhet të vij? — u çudit Bexheti.

Pirroja dhe Aliu rrinin në këmbë me duart në xhepat e pantallonave.

«Ja dhe fundi im, — mendoj Bexheti. — Ata dy karafilët rrinë me gishtin në këmbëz, kurse këtë këtu nuk e ha dot!» — u ngrit dhe filloi të vishej. Pirroja i vuri hekurat në duar.

Gëzimi zgjoi dhe tjetrin që po flinte.

— Na falni që po ju prishim gjumin, por duhet të merrni pjesë në kontrollin që do t'i bëjmë këtij personi.

Isai u ngrit dhe u vesh. Ai dukej i shqetësuar.

«Mos ka gisht dhe ky në këtë punë?» — mendoj Bexheti, duke i hedhur një shikim të egër Isait, si për ta paralajmëruar ta mbyllte gojën për ato që kishin biseduar bashkë.

Gëzimi me Pirron filluan kontrollin e valixhes. Kontrolli ishte i imët, sado që valixhja ishte e vogël. Si i hoqën të gjitha plaçkat, Gëzimi e ktheu përmbys dhe i ra fundit nja tri-katër herë me grusht. Përtokë u rrëzua një kompensatë sa fundi i valixhes dhe mbi të u derdhën tri tufa të mëdha kartëmone-dhash, një pistoletë «kolt» dhe disa sende të tjera.

Pirroja nisi të shkruante procesverbalin e kontrollit, ndërsa Gëzimi fliste.

Bexheti u drodh kur Gëzimi mori në dorë një shishe të vogël pa etiketë.

— Një shishe me një lëng të panjohur, i cili duhet dërguar për analizë, se nuk besoj të shërbejë për të lyer flokët, — tha Gëzimi duke shikuar nga Bexheti, që kishte ulur kokën.

Ndërsa ata po merreshin me punën e tyre, Bexheti mendonte. Eshtë për t'u çuditur. Kur njeriu sheh fundin, ai nis të mendojë për fillimin. Siç duket ai ka dëshirë të shpëtojë, të fitojë përsëri lirinë që ka pasur dhe mendon për atë periudhë që e afron më shumë me lirinë. Ai kujton gjendjen e dikurshme dhe mendon se, në qoftë se do të mbante një tjetër qëndrim, ndryshe do të kishte rrjedhur jeta e tij. . .

Një ditë atë e nisën së bashku me një shok tjetër në një detyrë të rëndësishme. Komisari i porositi që të bënin njoftimin dhe të ktheheshin urgjent. Dhe ata u nisën. Në të aguar, ndjeu se ishin rrethuar. I ftuan të dorëzoheshin, por ata u përgjegjën me pushkë. Për një gjysmë ore ata luftuan. Shoku i Bexhetit u vra. Bexheti i vajti afër dhe e pa për një copë herë në sytë që i kishin mbetur hapur. Atë e tmerruan ata sy. Ndoshta pas pak edhe unë kështu do dukem, mendoj ai duke i mbyllur sytë shokut të tij, dhe nisi përsëri të qëllonte. Por gjaku nuk po i ziente më, dukej se iu ftoh. Rrethimi u ngushtua shumë dhe ai shikonte kundërshtarët në fytyrë. Ai nuk qëlloi më. Ndenji në pritje, por duart nuk i ngriti nga sedra. Ata po i afroheshin barkas, derisa iu hodhën përsipër. Me të u muarën dy veta. Ata e shtrënguan të tregonte, e shtruan në dru dhe ai u thye. Tregoi për misionin. Pastaj atij i ishte dashur të lëshonte deklaratë, ndërsa armiqtë sulmuan batalio-

nin e tij. Në këtë mënyrë ata e komprometuan plotësisht Bexhetin dhe pastaj e dërguan në batalion, duke i përgatitur një legjendë. Gjatë gjithë kohës ata nuk iu ndanë. I mësuan gjithshka të keqe, i kultivuan ambicien dhe urrejtjen dhe ai filloi të punonte për ta me mish e me shpirt.

Duke sjellë të gjitha këto ndër mend, Bexheti u bë qull në djersë. Ai kërkoi të ulej, po ata mbaruan punë. U ngritën dhe pas pak Isai dëgjoi motorin e maqinës që u ndez. Ai u ngrit dhe shkoi tek dritarja. E hapi atë dhe e la gjithë natën hapur që të pastrohej dhoma.

Po atë natë, grupe të tjera operative kishin shkuar në shtëpinë e Dalipit dhe të Xhemalit e, brenda natës, ata të tre i vendosën në dhoma të veçanta. Në sytë e tyre kishte zënë vend hutimi dhe tmerri.

\*

\* \*

Pirroja me Gëzimin zbritën nga maqina dhe morën një monopati që të nxirrte në fshatin Gurrë. Pas një gjysmë ore rrugë ata mbërritën dhe kërkuan t'i shoqëronin për në shtëpinë e çobanit. Ky rrinte në krye të shkallëve dhe gdhendte një copë dru me thikën e tij të xhepit. Si i pa miqtë, u ngrit në këmbë. Ai e njohu Pirron që atë ditë kishte veshur një pelice dhe në këmbë mbante një palë çizme llastiku.

— Mirse na erdhët, o djem! — tha plaku duke i zgjatur më parë dorën Gëzimit, kurse me Pirron u përqaftua.

Ata hynë në shtëpi dhe zunë nga një qoshe. Në



oxhak, zjarri ishte ndezur mirë e, megjithëse ata ishin të nxehur nga rruga, u pëlqente t'i shtrinin duart drejt tij. E reja e plakut erdhi e i takoi. Plaku e porositi t'u binte kafe dhe ajo doli nga dhoma. Ai u hodhi miqve atë rutinë e tij prej alumini që të dridhnin nga një të fortë, dhe me vete mendonte përse ishin munduar deri në shtëpinë e tij.

Pirroja shikonte dhomën. Ajo ishte rregulluar thjesht dhe dukej mjaft e pastër. Në mur qëndronte varur një fotografi, në të cilën dukej një ushtar. Çobani e vuri re shikimin e përqëndruar të Pirros dhe i tha:

— Është djali im i vetëm. Tani punon në kooperative. E dua si dritën e syve, por një herë jemi grindur bashkë.

— Përse? — deshi të dinte Gëzimi.

Plaku u kollit lehtë.

— Ja, si mbaroi ushtrinë, deshi të zinte një punë andej nga qyteti dhe të më merrte edhe mua atje. «Jeto het mirë andej nga qyteti, mor bab», më thoshte sa herë që vinte me leje. Unë e dëgjoja dhe nuk e dija se ku donte të dilte, por që bluante diçka të keqe në mendje, këtë e kuptoja. Më në fund ma tha. «Mirë, more djalë, — i thashë, — po edhe këtu tek ne nuk rrohet keq. Tërë ato shpatulla të gjera nga ky fshat i ke, se nuk t'u zgjeruan atje në qytet. Pastaj, po të ikim të gjithë, po fshatin kujt do ia lëmë». Kam luftuar shumë me të derisa ia mbusha mendjen. Sa erdhi këtu, filloi punën në kooperative dhe thashë se u rahatova. Por më bëri proçkën tjetër: ma pruri në shtëpi këtë nusen që takuat. «Kjo është nusja ime, mor bab, është nga familje e mirë dhe ne duhemi shumë». Fliste biri i botës dhe nuk i

bënte tërr syri. Në fillim nuk më erdhi fare mirë, se isha tallur dhe me të tjerët, që u kishte ngjarë kjo punë, por më vonë e mblodha mendjen. Po shyqyr, nusja është vajzë për kokën e vajzës dhe djalit nuk i vete më mendja për andej nga qyteti.

Ata qeshën të tre. Ashtu duke qeshur i gjeti dhe nusja, kur u pruri kafënë.

Më në fund Gëzimi i tha plakut:

— Do të të mendojmë një çikë, po duam të vemi deri tek ai varri, se sikur i erdhi koça dhe kësaj pune.

— Vemi, mor djem, si të doni ju, — tha plaku, — por nuk do të qe keq sikur të merrnit nga një kafshatë bukë, me ç'të na ndodhet.

— Më mirë kur të kthehemi, — tha Gëzimi. — se tani nuk kemi as uri.

Ata u ngritën. Plaku mori shkopin, që e kishte dhendur për merak, dhe u nisën. Rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme. Plaku i udhëhiqte. Kur u nisën, Gëzimi mendoi se plaku, me atë shkopin e tij, do t'ua bënte orën ditë, por nuk doli ashtu. Ai ecte përpara dhe herë-herë kthente kokën prapa e u thoshte:

— U lodhët, o djem? — Dhe, pa marrë përgjegje, vazhdonte: — Po qe se u lodhët, pushojmë pak.

Atyre u vinte turp të thoshin se ishin të lodhur, megjithëse i kishin zërthyer edhe kopsat e këmishës, dhe ia kthenin:

— Jo, jo, ne jemi të rinj, por se mos lodhesh ti, xhaxho.

Pirroja donte të orientohej sipas procesverbalit, që kishte mbajtur nga biseda me çobanin, por as që e formonte dot idenë për vendin e saktë. «Po sikur

të më duhej të vija vetë këtu, a do të mund ta gjeja?» pyeste veten ai.

Ata ecnin nëpër pyll. Drurët e lartë, me degë të dendura, krijonin hije të plotë. Vetëm aty-këtu dielli gjente ndonjë të çarë dhe rrezet e tij depërtonin, ndriçonin dhe ngrohnin tokën, nga e cila avullohej dhe ngrihej një afsh i ngrohtë nga plehu i gjetheve të kalbura, që atyre u guduliste hundët.

Më në fund plaku ndaloi. Dhjetë metra më tutje ishte gropa. Ata u afruan dhe filluan të gërmonin e të largonin prej andej gurët dhe drurët. Por, sa më shumë punonin, aq më shumë bindeshin se nuk kishte asgjë, veç disa pjesëve të shajakta e ndonjë vertebër.

— Po kjo si është e mundur! — i tha Gëzimi plakut. — Eshtrat nuk qenkan.

Plaku ngriti supet nga habia.

— Unë i kam parë ato me sytë e mi, bile i mbulovala dhe ato që dukeshin, — tha ai.

Që i kishte parë me sytë e tij, kjo ishte plotësisht e besueshme, sepse ata gjetën pjesët e shajakut dhe disa koska të vogla. Por të tjerat ku ishin?!

Të dy oficerët dukeshin si me krahë të prerë. Po aq i pikëlluar dukej edhe plaku. Ta dinte kështu, ai do t'u kishte bërë roje atyre eshtrave. Ata mblodhën ato që gjetën, dhe kërkuan një pjesë të madhe të territorit. Por, si nuk gjetën ndonjë shenjë dyshimi, morën rrugën për t'u kthyer, pa mundur të shijonin dot kënaqësinë e këtij udhëtimi në ajër të pastër. Ecnin të heshtur. E ç'të thoshin?

Kryetari ecte lart e poshtë nëpër zyrë, me duart prapa e me kokën pak të përkulur.

— Po tani, si i bëhet? Në këtë rast, puna jonë vështirësohet shumë.

Gëzimi me Pirron rrinin në këmbë dhe ndiqnin lëvizjet e kryetarit.

— E kontrolluat mirë vendin përreth, — tha ai dhe u bëri shenjë të uleshin.

— Po, e kontrolluam, por aty nuk dukej ndonjë shenjë gjermimi i freskët.

— Ti, Pirro, shko thirre edhe një herë Saliu. Do të na duhet të bisedojmë edhe një herë me të.

Pirroja doli dhe zbriti shkallët me shpejtësi. Ai nuk dinte se përse i duhej kryetarit tani Saliu. Pas pak ai u kthye në zyrë dhe lejoi të futej i pandehuri përpara.

Kryetari i tha të ulej. Për pak kohë mbretëroi heshtja në dhomë. Saliu rrinte kokulur. Ai i priste pyetjet që do t'i bënin tani me një farë indiferentizmi. Dukej që puna e tij kishte marrë fund. Por në të njëjtën kohë ai nuk mund të mos vinte re se ata ia kishin nevojën. Ai e dinte vlerën e vetes së tij. Ishte tamam si ai thesi që ka mbajtur miell dhe, sa herë që ta shkundësh, do të nxjerrë diçka, derisa të lahët fare.

— Sali, — e theu heshtjen kryetari, — tani ka ardhur puna deri tek eshtrat.

Saliu ngriti kokën dhe shikoi me ata sytë e tij si pa jetë. Eshtrat. Atij i kujtoheshin mjaft mirë atc eshtra. T'i mbaje ato në kurriz ishte një tmerr më

vete. Po aq e tmerrshme ishte të kujtoje edhe atë moment. Saliut i shkoi një e rrëqethur në trup.

— Për cilat eshtra është fjala? — bëri sikur nuk e kuptoi pyetjen ai.

— Për ato të Qazim Belulit. Ato na duhen si provë materiale e veprimtarisë suaj kriminale, — foli troç kryetari. Zëri i tij ishte i qetë. — Ku janë ato?

Saliu heshte. Ishte mësuar me ato ecejaket nëpër zyra dhe ishte bindur se, sa herë që e thërrisnin për ndonjë gjë, ai në fund të fundit jepte shpjegime. Sa herë ishte betuar ai që ta mbyllte gojën ndaj çdo pyetjeje që t'i bëhej, aq herë kishte folur. Nuk e kuptonte as vetë se si i ndodhte kjo. E megjithatë, ai betohej rishtas. Ndjehej i lodhur nga kjo luftë, shumë i lodhur dhe çdo ditë që kalonte, dukej se ia thithte energjitë me një gjakftohtësi të habitshme.

— Përse më pyesni pikërisht mua për këto? — tha ai pa e ngritur kokë. — Unë tani kam pranuar mjaft gjëra dhe ju kam ndihmuar me sa kam pasur mundësi.

— Ti më tepër ke ndihmuar veten tënde, — u përgjegj kryetari, duke e kuptuar se Saliu nuk ishte shëruar dot nga ajo sëmundja e tij e kompensimit.

Saliun e ngrohu kjo përgjegje. Vërtet, ai duhej ta kishte ndihmuar veten e tij. Kryetari thuajse i foli fare troç për këtë.

— Ne po të drejtohem vetëm ty, megjithëqë, — kryetari hezitoi për një moment, pastaj vazhdoi, — këtu i kemi edhe të tjerët: Bexhetin, Dalipin, Xhemalin. Por ti ke dijeni për këto. Veç kësaj, bashkë sikur jemi mësuar të merremi vesh.

Saliut iu duk vetja si mbi një stivë me dru, që kishin filluar të digjeshin e të kërcëllinin nga flaka,

nga ky lajm që i dha kryetari për arrestimin e shokëve. Emrat e tyre, që i përmendi fare qartë dhe pa asnjë ngurrim. Me një fjalë, atyre tashmë u ishte vënë të gjithëve nga një kryq.

— Të shkojmë t'jua tregoj në vend, — u tha ai me kokën ulur. — Unë ua ndërrova vendin atyre, së bashku me Bexhetin. Ka qenë një natë e llahtarshme ajo, kur i kemi ngritur në krahë. Kërkëllitja e tyre nuk më është ndarë gjatë gjithë kohës, më duket sikur akoma i kam këtu, në shpinë. Ai i tha këto fjalë dhe e uli më tepër kokën për të mos i parë lotët, që filluan t'i rridhnin faqeve.

Kryetari e kuptoi që ai po qante. Jo, ai nuk duhej të qante, se ishte penduar për krimet e tij. Ai ndoshta u thye përfundimisht dhe kryetarit iu duk tashmë si një kufomë. «Ja ku të çon tradhëtia», mendoi ai dhe lotët e të pandehurit ia dhjetëfishuan neverinë dhe urrejtjen për këta armiq. Kryetari u hodhi një sy shokëve të tij të rinj. Jo, edhe në sytë e tyre ai nuk pa të pasqyrohej ndjenjë keqardhjeje, edhe në sytë e tyre ai gjeti të shprehura qartë po ato ndjenja. «Ata dinë vetëm të urrejnë fort dhe të dashurojnë fort», mendoi atë çast kryetari.

— Zbriteni poshtë të pandehurin dhe përgatitni maqinën, — i tha kryetari Pirros.

Gëzimi po e shikonte me admirim kryetarin, që në atë kohë u ngrit dhe hapi dritaren që të ajrorej dhoma. Pastaj ai ndezi cigaren dhe, duke e ditur se Gëzimi do ta pyeste se si qe e mundur që i ra në të me Saliun, i tha:

— Ai gaboi në një seancë të pyetjes, kur na tha se «pas një jave kalova nga ai vendi, ku më tha çobani se pa ato koskat, dhe nuk gjeta gjë». Atëhere

ai ka shkuar dhe ia ka ndryshuar vendin varrit. Këtë e kapa, se e kam studjuar shumë herë e me vëmendje gjithë materialin e dosjes së tij.

Për gëzimin ky qe një mësim i mirë, i dhënë me shumë kujdes e urtësi.

\*  
\*   \*

Ata të katër ecnin nëpër monopati. Saliu sa më tepër i afrohej vendit, aq më tepër ndjente se gju-njët nuk i punonin. E gjithë jeta e tij i dukej një budallallëk, një çmenduri. Atij i dukej sikur nuk kishte jetuar fare në këtë botë, që kur u ishte futur këtyre rrugëve për disa premtime boshe. Por edhe ata që e kishin futur në këtë rrugë e i nxinë jetën, ja tek përfunduan: në bankën e të akuzuarit. Le të jepnin edhe ata llogari. Ndaloi pak hapat, sepse i lindi papritur një mendim: a nuk do të ishte më mirë që t'i jepte fund jetës? Ja, mjaftonte të ikte me vrap dhe ata që e shoqëronin, do t'i nisnin prapa një breshëri e gjithshka do të merrte fund. Por edhe vdekja e tmerronte po aq sa jeta e tij. Ai ndaloi përfundimisht dhe tregoi një pishë të lartë.

— Tek ajo pisha atje, — munda të thoshte ai dhe u ul në shesh.

Kryetari nuk i tha asnjë fjalë. Fundja, ai e shikonte si në pëllëmbë të dorës gjendjen në të cilën ndodhej i pandehuri. Pirroja u muar me fotografimin e vendit, ndërsa Gëzimi nisi të gërmonte. Punonte me kujdesin e atij arkeologut që kërkon gjurmët e një qyteti të lashtë. Më në fund kasma zbuloi

një eshtë, pastaj tjetrën, derisa i nxori të gjitha. Pirroja i fotografoi dhe pastaj të dy bashkë filluan t'i futin në një qeskë plastmasi. Kryetari i shikonte të tëra këto me një cigare në buzë, që nuk dihej se qëkur i ishte shuar, ndërsa Saliu mendonte se sa e tmerrshme do të ishte sikur t'i thoshin që t'i mbar-te në kurriz deri tek maqina. Jo, ai nuk do të pranonte, le t'i bënin ç'të donin. Por asnjëri nuk ia kërkoi këtë dhe ata u nisën përsëri për udhë.

\*

\* \* \*

Zotësia e hetuesit, kur ka të bëjë me më shumë se një të pandehur, është që ai të zgjedhë midis tyre atë që është hallka më e dobët. Kur ia arrin qëllimit që të thyejë atë, hetuesi siguron jo vetëm prova të reja, por në të njëjtën kohë këput lidhjen e zinxhirit dhe e ka më të lehtë punën me të tjerët.

Duke u mbështetur në materialet e çështjes, Pirroja zgjodhi midis tyre Dalipin. Ai u përgatit seriozisht për punën me të. I studjoi materialet në ngarkim të tij, e veçanërisht personalitetin e tij. Dalipi ishte një tip frikacaku dhe mjaft i lëkundur. Gjatë luftës kishte qenë indiferent. Ai nuk guxoi të lidhet me asnjërën palë dhe në të njëjtën kohë përpiquej ta kishte mirë me të dy anët. Ndoshta ata, duke u mbështetur në këto cilësi të tij, e kishin joshur me ndonjë gjë dhe njëkohësisht e kishin kërcënuar, duke u futur në kurthin e tyre.

Pirroja e thirri atë një pasdite. Ai zuri vend dhe priste s'e çdo t'i bënin. Ishte i gjatë dhe i dobët, me



nyjet e duarve të fryra e me ca damarë mjaft të trashë.

— E kuptoni ju, i pandehur, se përse gjendeni këtu? — e pyeti Pirroja. Me këtë pyetje ai donte të dinte deri në ç'shikallë Dalipi e ndjente veten fajtor.

Ai ndenji disa çaste pa folur. Të thuash të drejtën, ai e ndjente se kishte plot mëkate mbi kurriz, por që të fliste vetë për këto, nuk e quante aspak të arësyeshme. Atë natë që e arrestuan, nuk pati kohë të mendonte se si duhej të sillej në hetuesi. Por më vonë ai mendoi gjatë për këtë çështje. Mirëpo Dalipi, edhe tani që gjendej përballë hetuesit, akoma nuk kishte marrë vendim të prerë se çfarë qëndrimi duhej të mbante. «Hëpërhë, — mendoi ai vetë, — është mirë të marrë vesh se çfarë dinë këta. Se, po të them ndonjë gjë ashtu në tym, bëj ndonjë budallallëk».

— Ju duhet të keni ndonjë shkak që më keni thirrur, — nisi t'i përgjigjej pyetjes ai, — por, t'ju them të drejtën, unë nuk e kuptoj, bile çuditëm.

Ai i tha këto fjalë me një zë të çjerrë, sa iu duk se nuk qe i tij dhe u kollit për ta pastruar.

— Domethënë ju mendoni se diçka kemi, — tha Pirroja, që e kuptoi qëndrimin që kishte marrë i pandehuri. Qëllimi i Pirros ishte të tërhiqte të pandehurin në bashkëbisedim dhe dalëngadalë ta çonte bisedën atje ku i interesonte atij.

— Ju diçka keni, por ajo mund të mos jetë e vërtetë, ju mund t'ju kenë gënjyer.

— Në kontrollin e banesës suaj u gjet një pushkë. Kjo nuk është një gënjeshtër, apo jo? — tha Pirroja dhe vazhdoi: — Më thoni, përse e keni mbajtur fshehur dhe kundër kujt do ta përdornit?

Pirroja e filloi qëllimisht bisedën nga pushka. Ajo ishte si një urë që do ta lidhte me çështjen e Qazimit. Nga kontrolli kishte dalë se pushka e gjetur në banesën e Dalipit i ishte dhënë Qazim Belulit me leje nga dega.

— Ja, më kishte mbetur atje në mur, shoku hetues. Ju e dini se ne, shqiptarët, nuk rrimë dot pa një armë.

— Ashtu! Po më çuditni, — i tha Pirroja. — Mos vallë nuk e dini se ne, shqiptarët, kemi fituar disa zakone të tjera? Një nga këto zakone është  e armë, pa lejen e organeve tona, nuk duhet të mbahen. I gjithë populli është i armatosur, por armët i mban varur në armaturë e jo vrimave. Pastaj, me sa di unë, ju, edhe kur ka qenë koha për ta përdorur armën, nuk e keni shkrepur, — e thumboi Pirroja.

I pandehuri rrinte si i hutuar. Ata sytë e tij ngjyrë kafe i lëviznin me shpejtësi sa andej — këtej. Mendonte si në ethe për të gjetur një rrugëdalje. I kujtohej mjaft mirë ajo ditë e mallëkuar, kur kishte marrë armën. Ja kishin dhënë me qëllim të caktuar, ta lidhnin akoma më shumë pas vetes së tyre. Ai nuk mund ta kundërshtonte, se i vinte edhe frikë, edhe turp.

— Na thoni, pra, ku e keni gjetur armën, — tha Pirroja dhe u ngrit në këmbë. — Kjo gjë na intereson shumë.

— Këtë armë e kam gjetur që pas luftës dhe e fsheha, — tha Dalipi me gjysmë zëri.

— Ju e besoni vetë këtë që thoni? — e pyeti Pirroja duke e qesëndisur.

Dalipi në fillim se' kuptoi pyetjen, pastaj papritur i ra në të.

— Si s'e besoj, — dhe ngriti supet.

Pirroja hapi një regjistër dhe mori edhe procesverbalet e kontrollit të banesës, ku qe shënuar numri i armës.

— Meqenëse nuk doni të flisni, hajdeni të shikoni diçka këtu, — i tha Dalipit, që ngurronte të ngrihej nga karrigja.

Dalipi u afrua të shikonte. Pirroja vuri gishtin tek numri i armës në procesverbal dhe tek po ai numër në regjistër. Dalipi nuk kuptonte dhe Pirroja u detyrua t'i shpjegonte:

— Këtë armë, që u gjend në shtëpinë tuaj, ne ia kemi dhënë me leje një personi tjetër. Ja se kujt ia kemi dhënë, — i tha Pirroja dhe filloi të lëvizte gishtin horizontalisht me numrin në regjistër, derisa arriti tek emri.

Dalipi i shqeu sytë jashtë mase, kur lexoi emrin e Qazim Belulit në regjistër. Dukej shumë i tronditur dhe kjo filloi të pasqyrohej kudo: në gjunjët që i dridheshin, në fytyrën e verdhë dhe në pështymën, që nuk i shkonte dot poshtë.

— Uluni, — e urdhëroi Pirroja, — dhe para se të flisni, dëgjomëni mirë. Në qoftë se doni të pendoheni për veprimtarinë tuaj dhe të ndihmoni sado-pak veten, mundohuni që ta fshini nga mendja se ne ju kemi thirrur kot këtu. Të gjitha pyetjet e mia kanë një kuptim dhe synojnë të arrijnë një qëllim të caktuar.

Pirroja heshti. Ai e kuptoi që ky moment ishte i rëndësishëm për hetimin. I pandehuri mori goditjen e parë që në fillim për gënjeshtren e tij. Tani ai do të ishte më i matur në marrëdhënje me hetuesin.

Bexheti dukej sikur e kishte mbledhur veten pas arrestimit, por, megjithatë, gjurmët e një tensioni të madh nervor i dukeshin në zbetësinë e syve, në rrathët nën ta, dhe veçanërisht në duart, që i djersitnin e i fshinte çdo çast pas pantallonave.

Pirroja ndjehej i qetë. Tashmë ai ishte ndodhur disa herë përpara njerëzve të kësaj kategorie. Ajo ndruajtja e kohëve të para ishte zëvendësuar dalëngadalë nga ndjenja e sigurisë; fytyra i merrte një shprehje të vrazhdë sa herë që kishte të bënte me njerëz të tillë, e kjo ishte pasqyra e botës së tij të brendshme. Në pyetjen e Bexhetit ai kishte një rol mjaft të kufizuar: vetëm sa t'i komunikonte akuzën dhe të hynte në debat, pastaj do t'ia kalonte një shoku, që do të vinte nga qendra, dhe ai vetë do të vazhdonte me të tjerët. Pirros i dukej çudi si kalonte koha në këtë valë të madhe pune. Ai shkëputej sa hante bukë e të merrte ndonjë sy gjumë dhe kthehej përsëri i gatshëm për të kryer detyrat. Dy herë rrjesht kryetari e pat gjetur natën vonë në zyrë dhe e kishte urdhëruar të shkonte të flinte, e ai e kishte zbatuar urdhërin. Por thellë në veten e tij ai e ndjente se, duke qenë i ri, shokët donin ta lehtësonin e kjo e zemëronte. Ndërsa ata vetë shkriheshin në punë, duke përfshirë këtu dhe kryetarin. Ai me të tjerët sillej ndryshe, ndërsa Pirron e dërgonte të flinte, sikur ky të ishte i vogël. Ai u shkëput nga mendimet dhe e pyeti Bexhetin:

— Ç'mund të na thoni për akuzën, i pandehur, a e pranoni?

— Jo, nuk e pranoj. Akuza juaj më duket një absurditet. Mbi se e bazoni atë?

Bexheti e ngriti zërin. Le ta kuptonin që në fillim qëndrimin e tij të prerë. Në fund të fundit, ata vetëm dyshime mund të kishin e disa gjëra fare të vogla. Ato paratë që ia gjetën në valixhe ai mund t'i justifikonte. Fundja kishte punuar kaq kohë. Ndërkaq i erdhi një mendim i papritur! Mos vallë ka folur gjë Saliu?

Ky mendim e tmerroi. Ai e njihte mirë Saliun, bile kishte shumë shpresë tek ai. Por Saliu mbeti një rraqexhi tërë jetën e tij. E vërteta është se Bexheti këto cilësi të tij diti t'i shfrytëzonte kur ishte koha, por, pasi ia hodhi rrjetën, nuk u përpoq më që t'ia higte. Por jo, Saliu ishte akuzuar për vjedhje. Këtë ai e dinte shumë mirë.

— Ç'mund të na thoni për paratë që ju gjetëm në valixhe gjatë kontrollit, — ia ndërpreu mendimet Pirroja.

— Mund të them se i kam fituar me djersën e ballit, — u përgjegj Bexheti me ironi.

— Natyrisht, atë unë nuk e vë në dyshim. Bile jam i sigurt se të kanë shkuar nga shtatë palë djersë për t'i fituar; por unë vë re një gjë: që ato janë një prerje dhe me numrin që vazhdon pa ndërprerje. Si mund të biesh në kaq para të reja? Apo mos vallë t'i shkëmbeu ndonjë shok në bankë.

— Unë s'e kam vënë re këtë fakt.

— Jo, ju e keni vënë re shumë mirë, bile procesverbalin e kontrollit personal, ku janë specifikuar këto gjëra, ju e keni nënshkruar vetë.

— Mos më ngatërroni në këto gjëra. Këto s'janë

veçse intrigat që më kanë ndjekur për tërë jetën e që më janë kurdisur nga duar të padukshme për të më diskredituar, — tha Bexheti i indinjuar.

— Ne nuk ju ngatërrojmë aspak. Pyetja është fare e qartë: ku i keni marrë tërë këto para?

— Jua thashë që i kam fituar me djersë.

Pirroja e kuptoi që i pandehuri nuk mund ta jepte veten kaq lehtë. Ai e dinte se përpara tij kish-te një njeri të rrezikshëm, kriminel dhe tradhëtar. Megjithatë, ai nxori një vërtetim të bankës, ku thuhej se ato para ishin tërhequr nga një person i huaj dhe ja zgjati Bexhetit.

Bexheti e lexoi me qetësi dhe e grisi në copa të vogla. Pirroja vuri buzën në gaz. Ai nxori një fotokopje nga sirtari.

— Mund të bëj me dhjetëra të tilla, përderisa ekziston banka dhe mjetet. Të gjitha nuk m'i grisin dot. Me këtë gjest tregoni vetëm dobësinë tuaj dhe nuk fitoni asgjë.

— E grisa, jo për të shpëtuar nga ndonjë përgjegjësi që unë nuk e ndjej, por sepse këto kurthe dhe intriga më janë neveritur. Unë jam krejt i pafajshëm dhe shpresoj se ky nuk është qëndrimi i të gjithëve këtu, në degë. Unë do t'i ankohe për këtë kryetarit të degës dhe, po qe nevoja, do të ankohe edhe më lart.

Pirroja heshti. Deri këtu ishte puna e tij. Ai pris-te të vinin të tjerët. Kjo qetësi e përkohshme, Bexhetit iu duk një fitore. Ai po i jepte një mësim të mirë këtij djali, që i kishte akoma buzët me qumësht. Po të qenë edhe të tjerët kështu, ai do të kishte edhe njëqind vjet jetë prej tyre.

Por nuk ishte e thënë që të zgjaste shumë kjo

ndjenjë gëzimi. U hap dera dhe brenda hyri një burrë shtatlartë, me një kasketë në kokë e me krahë të fuqishëm. Pirroja u ngrit e u përshëndet me të. Ndërsa Bexheti në fillim nuk e ktheu kokën. I pëlqente të mos tregohej kurioz dhe të mos i përfillte të tjerët. Por prania e një njeriu të huaj, të ardhur rishtas dhe shikimi i tij, që dukej se i qe drejtuar atij, e detyroi Bexhetin të ngrinte kokën e të shihte. Bexhetit iu duk se diku e kishte parë të porsaardhurin. Ai i ngriti edhe një herë sytë dhe u ndesh në shikimin e tjetrit. Po, ata diku ishin parë. Bexhetit iu zmadhuan sytë jashtë mase, por u përmbajt dhe u shtrëngua edhe më tepër në karrige. I porsaardhuri buzëqeshi lehtë dhe u ul në karrige.

— Më duket se ju kam parë diku, — tha ai, që s'ishte tjetër veçse Nuriu... Aha, ne njihemi shumë mirë bashkë. Ç'doni ju këtu zoti «Skifter»? Unë ju kam dhënë gjithë ato detyra në takimin tonë! Përse nuk i keni kryer?

Bexheti heshte. Iu kujtua takimi me këtë njeri, që kishte përpara. Pra, gjithshka ishte një kurth, një mashtrim. Ai ishte takuar jo me «Vjedhësin e kasafortave», por me një oficer të Sigurimit të Shtetit dhe për faqen e tij të zezë i kishte raportuar atij për gjithshka dhe kishte marrë detyrat për t'i zbatuar. Të gjitha vendimet që kishte marrë Bexheti për një qëndrim heroik në hetuesi, u shuan nga kujtesa e tij.

## V

Zoti Vasil ishte ulur në tavolinën e tij të punës. Ai kishte shfletuar disa shkresa dhe merrej me punën e tij të zakonshme si tregëtar. Ndërkohë u hap dera pa trokitur dhe në zyrë hyri sekretarja e tij. Ky veprim i sekretares, në kundërshtim me rregullin, nuk e çuditi zotin Vasil, përkundrazi e gëzoi. Ishte bërë tashmë traditë për të, që, kur sekretarja i sillte letër nga Shqipëria, ai lejonte të thyhej çdo normë e etiketës zyrtare. Ajo buzëqeshi dhe tundi në dorë një zarf të thjeshtë. Ai u ngrit dhe i doli përpara. Sekretarja, përveç zarfit nga Shqipëria, la edhe një tufë tjetër të korrespondencës zyrtare mbi tavolinë. Zoti Vasil nuk i përfilli aspak ato letra. Me duart e tij topolake e të ngathëta, zoti Vasil hapi zarfin dhe nisi të lexojë letrën. E kishte nga kushëriri i tij Sokrati. Aty e gjithë familja kishte shkruar nga një copë letër. Ai filloi t'i lexonte me ngut dhe, si i mbaroi të gjitha, nisi t'i lexonte nga fillimi. Këtë radhë ai lexonte ngadalë, thellohej mbi kuptimin e çdo fjale e fjalie, donte të depërtonte tej mendimeve të shprehura në letër.

Qëkur ishte kthyer nga Shqipëria, ai e kishte për nder që në dejet e tij rridhte gjak shqiptari.

I kujtohej dita e largimit të tij nga Shqipëria. Të afërmit e përcollën deri në aeroport. Kur ngjiti shkallët, megjithëse sytë i kishte të mbushur me lot, ai mundi të shquante midis turmës një njeri shtatlartë



dhe me duar të fuqishme, që zbriti nga maqina dhe e përshëndeti me dorë. Zoti Vasil hipi në aeroplan dhe uturima e motorit i dukej e vogël në krahasim me rrahjet e zemrës së tij. Dukej sikur ditët e fundit të qëndrimit në Shqipëri kishte qenë më i përtëritur. I dukej sikur atdheun kishte filluar ta shikonte pikërisht ato ditët e fundit, kur një dorë e fuqishme kishte arritur t'i hiqte syzet e tij të zeza, të cilat ja nxinin pamjen që kishte përpara.

Po, zoti Vasil tani shikonte më qartë, shikonte drejt lartësisë. Gjatë gjithë rrugës ai solli në mend çdo detaj, sado të vogël, të jetës në Shqipëri; kujtoi me radhë të gjithë njerëzit që kishte takuar dhe herë-herë buzëqeshte me vete. Ndoshta pasagjerët e tjerë e shikonin dhe talleshin me atë buzëqeshje, por ai nuk donte t'ia dinte. Ishte thelluar në përshtypjet e tij, në mendimet e tij dhe nuk donte që këto t'ia prekte njeri. Ato ai mund t'i ndante vetëm me njerëzit më të dashur të zemrës.

Nga këto mendime e shkëputi për një çast sinjali i zbritjes në tokë. Aeroplani, pasi përshkoi xhiron e tij të zakonshme, u ul në pistë. Zoti Vasil u liria nga rripi i ndenjësës dhe u ngrit. Ai eci drejt derës. I pa njerëzit e tij dhe zbriti shkallët me shkahtësi. Djemtë u sulën drejt tij dhe iu varën në krahe. Ai i putni fort dhe i shtrëngoi në gjoks. Përqafoi të shoqen dhe hyri në maqinë. Leonidha u ul tek timoni dhe ata u nisën për në shtëpi.

Pasi u çlodh dhe hëngri darkë, ai u ul në dhomën e pritjes bashkë me fëmijët. Nuk kaluan as pesë minuta dhe ra zilja e telefonit. Leonidha vrapoi për atje dhe, si mori receptorin, shqiptoi:

— Po, këtu është. Kush flet? — Pastaj u kthye

nga i ati dhe, si mbylli me dorë mikrofonin, i tha se e kërkonte një mik.

Zoti Vasil u ngrit dhe mori receptorin. Ishte major Zoi. Ai e ftonte nesër, në orën 8, në zyrë për të shkëmbyer disa mendime mbi përshtypjet e tij nga udhëtimi. Zoti Vasil pranoi dhe mbylli telefonin. Pastaj, pa u ulur në tavolinë, iu afrua çantës së tij të udhëtimit, e preku lehtë kartonin e saj dhe, si u sigurua se gjithshka ishte në rregull, u ul në tavolinë. Ai qëndroi me fëmijët deri natën vonë. Dukej që asnjëri nuk kishte gjumë atë natë. Djemtë e donin babanë e tyre, por kurrë më parë nuk e dinin se ai ishte një tregimtar aq magjepsës. Zoti Vasil tregon-te e tregonte për mbresat e tij dhe, sa më shumë fliste, aq më shumë i vinte keq që e kishte vizituar atdheun në këtë moshë, i shtyrë nga disa rrethana të çuditshme.

\*

\* \*

Rrugën deri në zyrën e major Zoit e bëri në këmbë. Ecte me duar prapa, me hap të ngadalshëm dhe mendonte për diskutimin që do të bënte. Nëpunësi i shërbimit e drejtoi për tek major Zoi. Ai hyri brenda. Për një çast gjithshka iu duk e errët, e zbehtë. Zoti Vasil mendoi se kjo vinte për shkak se po kalonte nga një ambient me diell në një dhomë të errët. Dalëngadalë ai u ambientua dhe i zgjati dorën major Zoit, që e kishte zgjatur në drejtim të tij. Ai ndjeu dorën e ftohtë dhe të fortë të majorit, që i shtrëngonte të tijën. Ata zunë vend përballë njëri-tjetrit në kolltukët e veshur me lëkurë të zezë dhe asnjëri prej tyre nuk po e thyente heshtjen. Majori u kthye në të djathtë dhe, pa lëvizur nga vendi, tër-

hoqi nga rafti një shishe dhe dy gota. I mbushi gotat me një lëng të verdhë të tejdukshëm dhe, si ia zgjati njërën zoti Vasil, çeli bisedën:

— Mirse na erdhët, zoti Vasil. Shpresoj se udhëtimi ju ka rinuar dhe ju ka bërë të mendoni shumë për atdheun tuaj.

— Po, kalova disa ditë të këndshme dhe mendoj se me të vërtetë pushova mirë, — tha zoti Vasil, ndërsa me vete mendoj: «Mos vallë këta i kanë dëgjuar ato që bisedoja mbrëmë me fëmijët?» Si mendoj këtë, një lëmsh iu mbështoll në grykë dhe iu djersit tërë trupi. Në atë moment ai e ndjente veten si në mes të një dare, nofullat e së cilës mateshin ta shtrëngonin fort.

— Si e kalove me detyrat modeste që more përsipër të kryeje për llogari të shërbimit tonë? — kaloi drejt e në temë majori, duke e shkundur gotën me fund dhe, pa ia ndarë sytë bashkëfolësit, u zgjat në drejtim të shishes për ta mbushur prapë.

— Atje nuk ishte dhe aq lehtë sa mendonit ju, që t'i konsideroj aq modeste detyrat që më ngarkuat; por unë i zbatova deri në një të gjitha, — tha zoti Vasil me një zë të qetë e të matur. Ai nuk nxitohej apsak dhe s'kishte përse të nxitohej. E dinte që biseda do të vazhdonte disa ditë rrjesht. Ajo do të kontrollohej e çdo gjë do të kalonte në një filtër mjaft të hollë. Jo, zotit Vasil i ishin hapur sytë mirë. Ai ishte në gjendje tani të merrte me mend shumë gjëra, për të cilat më parë nuk interesohej apsak. Dukej se, përderisa i kishte hyrë këtyre punëve, jeta e tij e kishte humbur atë qetësinë e llogaritur që përmbledhej më parë në punë tregëtie e asgjë tjetër.

Pastaj zoti Vasil u përkul dhe mori çantën e tij

të udhëtimit, shqepi astarin e nxori prej andej një pako të vogël dhe disa fletë letre.

— Kjo është një pjesë e detyrës. I keni nga «Vjedhësi i kasafortave». Aparati ynë i maskuar në një kallëp sapuni tualeti, ka një efekt të jashtëzakonshëm. Sokrati e përvetësoi shumë shpejt përdorimin e tij.

— Ë instaloi në vend të sigurt?

— Po, në një vend plotësisht të sigurt.

Majori mori mikrofilmat dhe shkoi tek tavolina e punës. Atje shtypi një sustë dhe pas pak erdhi një djalosh i ri, i cili qëndroi në pozicion gatitu. Major Zoi i zgjati pakon dhe i tha:

— Të zhvillohen dhe të më sillen këtu për një gjysmë ore bashkë me një aparat projektimi.

Djaloshi pa orën dhe doli jashtë.

Pastaj zotit Vasil iu desh të futej në një bisedë të gjatë, ku përshkoi tërë udhëtimin e tij në Shqipëri. Atij i duhej të kujtonte çdo detaj të secilit episod. Këtë gjë e përsëriti disa ditë rrjesht, derisa një ditë u paraqitën së bashku me major Zoin tek drejtori. Ky i priti në kabinetin e tij, i qerasi të dy dhe iu drejtua zotit Vasil:

— Të dhënat që na prutë nga Shqipëria ishin të një vlere të rëndësishme. Ne i shoshitëm dhe i vërtetuan nga burime të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe veprimtarinë tuaj. Tani për tani ne nuk gjetëm asgjë të dyshimtë. Prandaj ju thirra këtu t'ju shpreh falënderimet e mia. Në të ardhmen, padyshim, do të kryejmë edhe detyra të tjera. Për këtë do t'ju duhet të bashkëpunoni me major Zoin. Shpresojmë që nga fillimi i vitit tjetër të ktheheni edhe një herë në Shqipëri.

— Tani unë iu futa kësaj pune, — tha me zë të

ulët, gati si me të murmuritur zoti Vasil. — Puna është që detyrat që më ngarkohen, t'i kryej mirë. Natyrisht, unë këto detyra i shikoj jo më me prioritet se interesin tim si tregëtar.

— Për atë mos u shqetësoni. Zyra jonë paguan mirë për inisiativa të tilla të suksesshme, — u përgjegj drejtori.

Pritja mori fund. Zoti Vasil zbriti shkallët e hyrjes së sipërme të drejtorisë dhe u ngatërrua me turmën.

\*  
\* \*

Maqina ndaloi përpara godinës, ku ishte vendosur laborator i kriminalistikës. Gëzimi zbriti nga maqina dhe priti sa shoferi të nxirrte një thes nga portobagazhi. Pastaj, me thesin në dorë, Gëzimi ngjiti shkallët e godinës. U ndal përpara një dere dhe trokiti. Qetësi. Gëzimi pa orën e dorës. A ishte e mundur të mos kishte njeri në këtë kohë? Ai e përsëriti edhe një herë të trokiturën dhe mendoi me vete se kriminalistët duhet të shkulen me top nga mikroskopët e tyre. Pastaj sytë i vajtën tek zilja, që ishte vendosur në mur, qeshi me veten dhe shtypi fort sustën. Derën ia hapi një djalë i ri, rreth të njëzetepesave.

— Ç'dëshironi? — e pyeti ai duke i zgjatur dorën e duke e tërhequr brenda.

— Kam sjellë një skelet njeriu për identifikim, — u përgjegj Gëzimi dhe hyri brenda. Djaloshi e çoi tek dera e një zyre, trokiti dhe hynë brenda. I priti një bjond, flokët e të cilit kishin filluar të thinjen.

— Për identifikimin e një kufome, — tha dja-

loshi, duke e lejuar Gëzimin të kalonte përpara.

— Keni sjellë fotografi të personit që mendoni se i përkasin eshtrat? — pyeti bjondi me një zë melodioz.

— Siurdhëron. Veç kësaj kemi marrë edhe të dhëna nga dega ushtarake për gjatësinë e tij dhe nga klinika dentare për dhëmbët e kuruar nga personi që dyshojmë se i përkasin eshtrat.

— Mrekulli, — u përgjegj bjondi.

Pastaj ata diskutuan rreth ngjarjes dhe rrethamave në të cilat ishte gjetur skeleti.

Për disa ditë rrjesht, laboratorit i kriminalistikës ishte i mobilizuar në kryerjen e kësaj detyre. Interesi i çështjes kërkonte që kjo metodë shkencore, e zbatuar me sukses nga kriminalistët të tjerë të huaj, të zbatohet edhe tek ne.

U formua një grup i posaçëm për zbatimin e kësaj detyre, në të cilin bënë pjesë ekspertit mjeko-ligjor, specialisti për fotografimin dhe dy ekspertë. Konsultimi me leteraturën dhe me metodikat e posaçme zgjati disa ditë, pastaj u kalua në çështjen konkrete.

Bjondi e mbante kafkën në dorë dhe po bënte matjet së bashku me doktorin, një burrë i vjetër, tullac, me një palë syze me skelet të zi.

— Hëm, po më dukesh si Hamleti, — bëri shaka doktori. — Të kujtohet monologu «Të rrosh a të mos rrosh»?

— Më kujtohet, por mua nuk më shkon mendja atje. Tani detyra jonë është të përcaktojmë kujt i përket, — u përgjegj bjondi dhe ata vazhduan punën.

Pas disa ditë pune, prova e parë doli me sukses, por ata nuk u nxituan të japin konkluzionin. Bënë prova me një sërë kafkash të tjera, por asnjëra prej

tyre nuk dilte e përbashkët me fotografitë e Qazimit.  
Konkluzioni ishte kategorik.

\*  
\* \* \*

Gjenerali ecte lart e poshtë nëpër kabinetin e tij. Ai dëgjonte vetëm fëshfëritjen e hapave mbi qilimin tërë push të kabinetit. Lajmi që sapo kishte marrë, ishte shqetësues. Si t'u dilte përpara epurve? Ai kishte shpresa shumë te Bexheti dhe grupi i tij. Ishin njerëz të përshtatshëm, me stazh dhe, në çdo kohë që t'u bëje shenjën, mund të hidheshin në veprim. Ndërsa tani i kishin thënë se i kishin arrestuar dhe se ishte bërë një gjyq i madh në qendër të qytetit. Ata kishin bërë deponime diskredituese për shtetin e tij. Disa nga oficerët e drejtorisë së tij ishin përmendur me emra në gjyq, ky ishte turpi dhe diskreditimi. Gjenerali priste të vinte major Zoi. Ai hyri i qetë si gjithnjë.

— Më kërkuat, zoti gjeneral?

— Ju kërkova, — tha gjenerali duke ndalur në vend. — Ç'kemi andej nga drejtimi juaj?

— Hëpërhë, asgjë me rëndësi. Ne po përgatitemi për një rekrutim të ri. Nuk mund të qëndrojmë kaq gjatë pa ndërldhje. Nga kufiri kjo punë është bërë tmerrësisht e vështirë. Kemi dështuar dy herë, ju këto i dini.

— Ashtu?! Domethënë asgjë të re nga ju. Bravo major, bravo. Po mua më duket se ju keni filluar të rahatoheni ca si tepër dhe nuk mendoni më si dikur për punën. Duket se, me të marrë drejtimin e sektorit, ju mendoni që arritët majat e gjithshkaje.

— S'po ju kuptoj, zoti gjeneral, — tha i hutuar

major Zoi. — Si është puna? — pyeti ai me ndrojtje.  
— Po, po. Siç u bë puna, mua më duhet t'ju furnizoj me të dhëna, — nënvizoi gjenerali. — Grupi që drejtonte «Skifteri» juaj, mori fund. Përpara tri ditësh përfundoi gjyqi i tyre.

Ky lajm i ra si bombë major Zoit. Pikërisht tani që ai mendonte se e kishte vënë punën në vijë, i ndodhi fatkeqësia. Po cili ishte shkak, si ndodhi? Këto pyetje po e mundonin. Por ai nuk guxonte ta pyeste gjeneralin. Përveç humbjes së grupit, ai kishte edhe hallin e tij. Kjo do të kishte patjetër pasoja edhe për të. Dhe, veç karrierës së tij në zbulim, ai nuk dinte të bënte ndonjë punë tjetër. Kur mendoi se mund ta pësonte, e lanë të tëra forcat. Shikimi krenar i tij u zëvendësua nga një shikim lutës dhe i përvuajtur, siç i ndodh qenit kur ndodhet përballë të zotit, i cili mban në dorë një kamzhik dhe përgatitet ta ndëshkojë.

Gjeneralit, kur e pa ashtu, i erdhi keq, por nuk e shfaqti dhe nuk kishte si ta shfaqte keqardhjen e tij. Edhe për atë vetë, për gjeneralin kjo gjë nuk do të kalonte ashtu thatë. Ai edhe për vete e dinte se dikujt nga kolegët ose nga eprorët do t'i vinte keq, por shumicës dhe veçanërisht atyre me të cilët shkonte si macja me miun, do t'u bëhej qejfi për këtë dështim.

— Po agjenti ynë, «Vjedhësi i kasafortave», — i shpëtoi goja major Zoit, — ka pësuar gjë?

— Jo, ai nuk është arrestuar. Dhe tani dëgjoni. Bëni ç'është e mundur që të na siguronit të dhëna të sakta rreth gjyqit. Për këtë duhet të punoni me kujdes. Ju, besoj, e kuptoni pozitën në të cilën kemi rënë. Shkoni!



Major Zoi doli andej me mendje të turbulluar. Këmbët nuk i bindeshin. Ai vajti në zyrën e tij, mbylli derën nga brenda dhe u ul në kolltuk. Mori shishen dhe piu sa u ngop. Pastaj qëndroi ashtu për një kohë të gjatë. Tëmthat i rrihnin fort. Ai kishte vrotuar me vëmendje çdo lëvizje të gjeneralit dhe, nga eksperiencia e punës me të, ishte bindur se, në qoftë se do të mundte të zbatonte urdhërin e tij, ndëshkimi do të ishte i butë. Ky mendim e ngushëlloi dhe ai u ngrit, hapi kasafortën e nxori prej andej dokumentat për të punuar. Pastaj u kujtua për diçka dhe shtypi një sustë, që ndodhej përbri sirtarit të tavolinës. Nuk vonoi shumë dhe në derë u duk një mesoburrë tullac me sy të fryra.

— Kërko në kartotekë kartelën e zotit Vasil dhe më sill dosjen e tij, e urdhëroi major Zoi.

Tjetri, pa folur asnjë fjalë, u zhduk prapa derës dhe u kthye po aq shpejt me një dosje të kaltër, të hollë. Ai e vuri mbi tavolinë dhe doli nga zyra pa u ndier.

Major Zoi hapi dosjen dhe filloi të studjonte letrat e deshifruara, që i kishin ardhur Vasilit nga «Vjedhësi i kasafortave». Në një nga letrat, i njoftonte se «Skifteri» nuk i kishte dalë në takim. Majori e nënvizoi këtë fakt dhe vijoi studimin. Ai lexoi dy herë rrjesht me një kujdes të jashtëzakonshëm një informatë tjetër, e cila e alarmoi së tepërmi: në të thuhej se Sabri Lini dukej një njeri mjaft i lëkundshëm, i frikshëm dhe nuk kryente asnjë nga detyrat që i ishin vënë. Veç kësaj, herën e fundit ai nuk kishte ardhur në takimin e radhës. Majori e nënvizoi këtë fort. Ja, pra, kush mund të ishte strumbullari i një dështimi

Qetësinë e majorit e prishi tullaci, që hyri me një fletë letre në dorë.

— Kjo sapo na erdhi nga shërbimi ynë i deshifrimit dhe ka lidhje me dosjen që po studjoni, — tha ai duke ia vënë mbi tavolinë.

Majori e mori dhe iu fut studimit të saj. Ja pra, ajo që i duhej. Të dhëna të plota për zhvillimin e gjyqit. Ai u habit me përpikmërinë dhe stilin e përdorur në përpilimin e kësaj informate. Ai vuri buzën në gaz dhe dukej sikur po i kthehej përsëri ai optimizmi i tij i parë. Ja pra, ky «Vjedhësi i kasafortave» do të jetë një bazë e shëndoshë për të ardhmen. Më poshtë agjenti e hidhte përsëri fjalën rreth qëndrimeve të Sabri Linit dhe sugjeronte që mos ta merrte hëpërhë në lidhje, se mund të rrezikohej edhe vetë. Zoi e aprovoi këtë mendim të agjentit e, jo vetëm kaq, por ai do të ishte i mendimit që ky Sabri Lini të asgjësohej një herë e mirë. Ja. «Vjedhësi i kasafortave» fliste edhe për frikën e tij, por këtë e bënte me mjaft takt e jo si disa agjentë lepuj, sepse në plan të parë nxirrte punën.

Zoi e largoi pak mendimin nga Shqipëria dhe u kthye tek zoti Vasil. Drejtori e thirri atë ditë në zyrën e tij dhe i tha se të dhënat e tij ishin të vlefshme dhe të provuara. Këtë ja tha që ai të qetësohej. Por në të vërtetë Zoi kishte marrë urdhër që të verifikonte çdo lëvizje të tij pas kthimit nga Shqipëria. Shtëpia dhe zyra e zotit Vasil ishin gjithnjë nën kontroll. Veç kësaj, Zahoja i kishte dendësuar takimet me të, por hëpërhë zoti Vasil mbahet mjaft mirë. Një herë që Zoi i tha se nuk duhej t'u fliste aq shumë për Shqipërinë fëmijëve, zoti Vasil ia kishte mbyllur gojën: «A nuk më keni poro-

situr vetë që fëmijët dhe çdo njeri tjetër duhet ta dirë se udhëtimet e mia për në vendin e lindjes nuk janë veçse familjare?»

Vetëm natën vonë doli majori nga zyra, duke lënë pas një shishe të zbrazur dhe dhomën të mbushur tërë tym. Më në fund ai gjeti një farë zgjidhje dhe mendonte se grushti nuk qe dhe aq i fortë, sa ta linte të shtrirë pa ndjenja. Bile majori mendonte se ky grusht kishte pasur një efekt nxitës, për ta nxjerrë nga gjendja e apatisë ku kishte rënë. Por në të njëjtën kohë ai e kuptonte se planet vareshin edhe nga kundërshtarët e tij të sigurimit shqiptar, dhe ata, pavarësisht nga fjalët që pëshpëriteshin nëpër zyrat, e njihnin mjaft mirë zanatin e tyre. Majori nuk mund ta harronte këtë.

\*

\* \* \*

Në zyrën e kryetarit të degës ishte mbledhur grupi operativ. Gëzimi po raportonte për detyrat e planit. Pas gjyqit, ata e ndjenin veten më të qetë dhe më të shplodhur. Kryetari dëgjonte dhe mbante shënime në blokun e tij. Çdo gjë kishte shkuar mirë. Armiku kishte marrë një goditje të fortë, por ai e dinte që pikërisht tani duhej të mobilizoheshin më shumë. Kryetarit, si fshatar që ishte, i pëlqente ta krahasonte nganjëherë punën e tij me atë të bujkut. Edhe bujku e mbjell tokën, e prashit, e vjel dhe e fut prodhimin në hambar. Po puna e tij nuk mbaron me kaq. Po të vendoste që të mos punonte më, bujku nuk do të korrte. Po kështu edhe atyre, pas gjyqit, lidhur me këtë çështje, u kishin mbetur edhe

bishtra të tjera, të cilat hëpërhë nuk ishin për të.  
Armiku do të përpiqet t'i organizojë dhe t'i drejtojë  
përsëri, do të mundohet të përdorë forma të tjera  
edhe më të stërholluara. Pikërisht për këtë ata du-  
hej të përgatiteshin mirë.

\*

\* \*

Fshatarët ishin mbledhur në sheshin e fshatit.  
Kishin ardhur edhe kooperativistë të tjerë nga fshat-  
rat fqinjë. Njerëzit ishin të heshtur. Ata ishin mble-  
dhur grupe-grupe dhe diskutonin për gjyqin. Ku-  
reshtarët grumbulloheshin rreth atyre që kishin pa-  
sur mundësi të merrnin pjesë në gjyq. Urrejtja për  
tradhëtinë rritej gjithnjë e më tepër. Dikush bërtiti  
«erdhën» dhe të gjithë, si me komandë, zunë vend  
në dy anët e rrugës automobilistike. Tek kthesa, afër  
fshatit, u duk maqina, në të cilën dallohej një ngjy-  
rë e kuqe e fortë, dhe pas saj u dukën dy vetura e  
një autobuz.

Maqina e parë ndaloi. Njerëzit u grumbulluan  
dhe ngritën në duart e tyre arkivolin me eshtrat e  
Qazimit, për ta vendosur në vorrezat e dëshmorëve  
të fshatit. E shoqja e tij u afrua me sytë e mbushur  
me lot. Ajo qante. Po provonte në të njëjtën kohë dy  
ndjenja: atë të gëzimit të pakufishëm për zbulimin  
e së vërtetës për çështjen e të shoqit, dhe atë të  
keqardhjes së madhe për humbjen e tij.

Njerëzit ishin të heshtur. Ata kujtonin me res-  
pekt Qazimin, bashkëfshatarin e tyre, që kishte rënë  
në krye të detyrës, në luftën e ftohtë, për të ruajtur  
atdheun dhe pastërtinë e figurës së komunistit.

Atë ditë u derdhën dhe lot, por më tepër u  
shtrënguan radhët, u shtrënguan armët.

F u n d